



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 125

Tiranë – E premte, 6 gusht 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 85/2021, datë 1.7.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 24, datë 16.6.2021, “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet <i>Pfizer Overseas LLC</i> dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin”.....	12955
Ligj nr. 88/2021, datë 1.7.2021	Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore.....	12955
Ligj nr. 89/2021, datë 1.7.2021	Për krijimin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor.....	12962
Ligj nr. 90/2021, datë 1.7.2021	Për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a.....	12968
Ligj nr. 91/2021, datë 1.7.2021	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare.....	12972
Ligj nr. 94/2021, datë 7.7.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 27, datë 1.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”.....	12976
Ligj nr. 95/2021, datë 7.7.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 28, datë 6.7.2021, “Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet <i>Pfizer Overseas LLC</i> dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin”.....	12976
Ligj nr. 96/2021, datë 7.7.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.....	12977
Ligj nr. 97/2021, datë 7.7.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, të ndryshuar.....	12994

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 485, datë 30.7.2021	Për miratimin e kontratës së fazës së parë “Kontratë për shërbime teknike – projekti hidroenergjetik i Skavicës” ndërmjet KESH sh.a. dhe <i>Bechtel Limited</i>	13000
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 488, datë 30.7.2021	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, për pasuritë me numër 261/100 dhe 270/11, zona kadastrale 2704, dhe numër 524/8, zona kadastrale 2529, Bashkia Tiranë.....	13026
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 489, datë 30.7.2021	Për miratimin e listës së barnave, që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre.....	13055
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 21, datë 14.7.2021	Për operacionet e veçanta hidrokarbure dhe parashikimet financiare.....	13117
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 289, datë 29.7.2021	Për delegimin e kompetencave.....	13120
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 220, datë 4.8.2021	Për delegim të përkohshëm kompetencash.....	13120
Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 1215, datë 15.7.2021	Me objekt detyrimin e palës së paditur t’i njohë paditësit gradën “kryekomisar”.....	13120
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër nr. 316, datë 21.7.2021	Me objekt korrigjimin e gabimit material dhe plotësimin e vendimit datë 16.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me objekt fillimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k.....	13132
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Skender Kuca.....	13135
	Ndreqje gabimi material në ligjin nr. 80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, botuar në Fletoren Zyrtare 121/2021, datë 2.8.2021.....	13135

**LIGJ**
Nr. 85/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 24, DATË
16.6.2021, “PËR MIRATIMIN E TEKSTIT
TË MARRËVESHJES PËR PRODHIMIN
DHE FURNIZIMIN NGA DHE
NDËRMJET *PFIZER OVERSEAS LLC*
DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE TË
SHQIPËRISË, INSTITUTIT TË
SHËNDETIT PUBLIK DHE MINISTRI
TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të
Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.
24, datë 16.6.2021, “Për miratimin e tekstit të
marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin nga
dhe ndërmjet *Pfizer Overseas LLC* dhe Ministrisë së
Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë,
Institutit të Shëndetit Publik dhe ministrit të Shtetit
për Rindërtimin”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 1.7.2021.

LIGJ
Nr. 88/2021

**PËR KRIJIMIN E AUTORITETIT TË
SIGURISË HEKURUDHORE¹**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të
Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i Autoritetit të
Sigurisë Hekurudhore, në vijim “Autoriteti”.

Neni 2
Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave
për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit.

Neni 3
Fusha e veprimtarisë së Autoritetit

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është
garantimi i sigurisë dhe ndërveprimit hekurudhor,
në zbatim të Kodit Hekurudhor të Republikës së
Shqipërisë.

¹ Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

Direktivën (BE) 2016/798 të Parlamentit Evropian dhe
të Këshillit, datë 11 maj 2016, “Mbi sigurinë hekurudhore”,
e ndryshuar”. Numri CELEX 32016L0798, Fletorja
Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 138, datë
26.5.2016, f. 102–149.



KREU II STATUSI, FUNKSIONET DHE STRUKTURA E AUTORITETIT

Neni 4

Statusi i Autoritetit

1. Autoriteti është person juridik publik, me seli në Durrës, i cili organizohet dhe funksionon si agjenci autonome, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Organet drejtuese të autoritetit janë Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv.

Neni 5

Funksionet

Autoriteti kryen funksionet e tij të sigurisë dhe ndërveprimit në përputhje me Kodin Hekurudhor si më poshtë:

a) harton rregullore dhe udhëzime të nevojshme për të realizuar funksionet e sigurisë dhe ndërveprimit, të përcaktuara në Kodin Hekurudhor;

b) lëshon, rinovon, ndryshon dhe shfuqizon certifikata, autorizime, leje ose dokumente të tjera, kur këto kërkohen, për realizimin e funksioneve të sigurisë dhe ndërveprimit sipas specifikimeve të përcaktuara në Kodin Hekurudhor;

c) mbikëqyr në terren të gjitha çështjet e lidhura me sigurinë dhe ndërveprimin, si ato të personelit të sigurisë dhe ndërveprimit të sipërmarrësve hekurudhorë.

Neni 6

Struktura organizative e Autoritetit

Struktura e Autoritetit miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin.

Neni 7

Këshilli drejtues

1. Këshilli drejtues është organ vendimmarrës për çështjet strategjike, politike, administrative dhe financiare të Autoritetit.

2. Këshilli drejtues është organ kolegjal i përbërë nga një kryetar dhe katër anëtarë, nga të cilët:

- kryetari, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për transportin;

- një anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për transportin;

- një anëtar, përfaqësues nga Autoriteti i Konkurrencës;

- një anëtar, përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës;

- një anëtar, përfaqësues nga Kryeministria.

3. Institucionet përgjegjëse sipas pikës 2 të këtij neni caktojnë përfaqësuesit e tyre. Emërimi i kryetarit dhe anëtarëve bëhet nga ministri përgjegjës për transportin.

4. Mbledhja e këshillit drejtues zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën tre anëtarë dhe vendimet e tij janë të vlefshme kur votojnë pro të paktën tre anëtarë. Në votim nuk lejohet abstenimi.

5. Vendimet e këshillit drejtues publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit.

Neni 8

Kompetencat e këshillit drejtues

Këshilli drejtues i Autoritetit ka këto kompetenca:

a) miraton buxhetin e Autoritetit;

b) propozon te ministri strukturën organizative të Autoritetit dhe strukturën e pagave;

c) miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ;

ç) analizon dhe propozon për miratim te ministri programin financiar të Autoritetit, duke mbikëqyrur dhe kontrolluar periodikisht realizimin e tij.

Neni 9

Kriteret e emërimit të anëtarëve të këshillit drejtues

Për t'u emëruar anëtarë të Këshillit, personat duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të kenë shtetësi shqiptare;

b) të kenë arsim të lartë në fushën e inxhinierisë mekanike e të ndërtimit ose të shkencave juridike;

c) të kenë përvojë të paktën 7 vjet në administratën publike dhe shtetërore, sektori privat dhe/ose në institucionet shkencore arsimore;

ç) të jenë me integritet moral dhe profesional në përputhje me legjislacionin për garantimin e



integritetit të personave, të cilët zgjidhen ose kryejnë funksione publike

d) të jenë të paangazhuar në funksione drejtuese partiake;

dh) të mos jenë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra penale;

e) të mos kenë konflikt interesash me detyrën në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Lirimi dhe/ose shkarkimi i anëtarëve të këshillit drejtues

1. Lirimi dhe/ose shkarkimi nga detyra i kryetarit ose anëtarit të këshillit drejtues përpara përfundimit të mandatit bëhet kur:

a) jep dorëheqjen;

b) bëhet fizikisht dhe/ose mendërisht i paaftë për të përmbushur detyrën, për më shumë se 3 muaj;

c) mungon pa arsye në më shumë se tri mbledhje radhazi;

ç) dëmton për shkak të paaftësisë profesionale a të neglizhencës Autoritetin;

d) gjatë ushtrimit të funksioneve, vepron në kundërshtim me interesat e Autoritetit;

dh) dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale;

e) humbet ose lë shtetësinë shqiptare;

ë) mbush moshën për dalje në pension.

2. Propozimi për lirim ose shkarkimin nga detyra të kryetarit ose të anëtarit të këshillit drejtues i paraqitet ministrit nga vetë këshilli drejtues ose nga institucione të tjera publike, funksioni i të cilave është i lidhur me atë të Autoritetit, shoqëruar edhe me arsyet dhe provat për të cilat kërkohet ky lirim ose shkarkim.

3. Ministri, në zbatim të pikës 2 të këtij neni, mund të vendosë pezullimin e kryetarit ose të anëtarëve të këshillit drejtues nga funksioni deri në përfundimin e procesit të verifikimit dhe të marrjes së vendimit.

4. Kur ndonjëri prej kryetarit ose anëtarët e këshillit drejtues lirohen ose shkarkohen nga detyra përpara përfundimit të mandatit, kryetari ose anëtari tjetër emërohet sipas së njëjtës procedurë të parashikuar në pikën 3 të nenit 7 të këtij ligji për emërimin e kryetarit ose anëtarëve të këshillit drejtues.

Neni 11

Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues

1. Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Kur mandati i kryetarit ose i anëtarit përfundon, ata qëndrojnë në detyrë deri në çastin e emërimit të kryetarit ose të anëtarit të ri. Një muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtari të këshillit drejtues, Autoriteti lajmëron, me shkrim, ministrin, i cili fillon procedurat për emërimin e anëtarit të ri.

Neni 12

Drejtori ekzekutiv

1. Drejtori ekzekutiv është titullari i Autoritetit, i cili emërohet nga ministri në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për nëpunësin civil për emërimin e anëtarëve të TND-së.

2. Drejtori ekzekutiv emërohet brenda 6 muajve nga krijimi i Autoritetit.

3. Drejtori ekzekutiv nuk mund të jetë anëtar i këshillit drejtues.

4. Drejtori ekzekutiv i Autoritetit përzgjidhet dhe emërohet sipas kushteve të mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë përvojë të paktën 5 vjet në administratën publike, me eksperiencë drejtuese të paktën 5 vjet në fushën e sigurisë hekurudhore dhe të mos ketë konflikt interesi me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit;

c) të mos ketë qenë i përfshirë në shoqëri biznesi hekurudhore, ku ka pasur interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për 5 vitet e fundit, para emërimit drejtor i Autoritetit.

ç) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për një vepër penale;

Neni 13

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv është përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë administrative të Autoritetit dhe ka këto përgjegjësi e detyra:



a) ndërmerr të gjitha veprimet ligjore në emër të Autoritetit dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët;

b) lidh kontrata në emër të Autoritetit dhe miraton blerjet sipas rregullave të prokurimit publik;

c) i raporton një herë në vit ministrit përgjegjës për transportin dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për Hekurudhat për sigurinë hekurudhore.

ç) harton dhe paraqet për miratim në këshillin drejtues raportin vjetor të veprimtarisë administrative të Autoritetit;

d) organizon, menaxhon, mbikëqyr, planifikon, koordinon, vlerëson personelin dhe mban përgjegjësi për aktivitetet e tyre dhe përmbushjen e detyrave të caktuara;

dh) bashkëpunon me institucionet ndërkombëtare dhe organet e sigurisë në sektorin hekurudhor dhe në sektorë të tjerë;

e) bën propozime për ndryshimet e nevojshme në këtë ligj dhe çdo akt nënligjor që ka të bëjë me sektorin hekurudhor;

ë) propozon buxhetin e Autoritetit;

f) mban komunikimet me autoritetet rajonale të Bashkimit Evropian për çështjet e sigurisë dhe të ndërveprimit;

g) administron fondet në bazë të buxhetit të miratuar.

KREU III

ADMINISTRATA E AUTORITETIT TË SIGURISË HEKURUDHORE

Neni 14

Organizimi dhe detyrimet

Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e Autoritetit rregullohen në përputhje me legjislacionin për nëpunësin civil dhe për punonjësit mbështetës me Kodin e Punës.

Neni 15

Departamentet përbërëse të Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore

Autoriteti organizohet në departamentet mëposhtme:

1. Departamenti i Sigurisë.
2. Departamenti i Ndërveprimit.

3. Departamenti Juridik.

4. Departamenti i Financës dhe Administratës.

Neni 16

Departamenti i Sigurisë

1. Departamenti i Sigurisë krijohet në përbërje të Autoritetit në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Departamenti i Sigurisë është i ngarkuar për:

a) shqyrtimin e aplikimeve, lëshimin, heqjen, pezullimin, përditësimin dhe rinovimin e certifikatave të sigurisë hekurudhore për sipërmarrësit hekurudhorë;

b) shqyrtimin e aplikimeve, lëshimin, heqjen, pezullimin, përditësimin dhe rinovimin e autorizimeve të sigurisë për administruesit e infrastrukturës hekurudhore;

c) dhënien, rinovimin, tërheqjen dhe revokimin e licencave të drejtuesve të trenave;

ç) kontrollin e mbikëqyrjen për zbatimin e kërkesave të sigurisë hekurudhore nga subjektet hekurudhore të pajisura me certifikata apo me autorizime sigurie, si dhe të operatorëve të shërbimeve publike e të operatorëve të impianteve të shërbimeve ndihmëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin hekurudhor;

d) kontrollin e qendrave të trajnimit të drejtuesve të trenave dhe personelit tjetër hekurudhor;

dh) hartimin e rregulloreve për certifikatë dhe autorizim të sigurisë;

e) përgatitjen e formularëve për aplikim për certifikatë dhe autorizim të sigurisë;

ë) mbajtjen e Regjistrat të Certifikatave dhe Autorizimeve të Sigurisë;

f) autorizimin e futjes në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor;

g) mbikëqyrjen nëse përbërësit e ndërveprimit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për ndërveprim.

3. Departamenti i Sigurisë vendos për lëshimin, rinovimin, ndryshimin dhe revokimin e pjesëve relevante të certifikatave të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë. Për kryerjen e detyrave të tij ky departament ka të drejtë të kërkojë e të ketë akses te të gjitha dokumentacionet, informacionet lidhur me objektet, instalimet, pajisjet e procedurat e administruesit të infrastrukturës dhe sipër-



marrësve hekurudhorë, të pajisur përkatësisht me autorizime e certifikata sigurie.

Neni 17

Departamenti i Ndërveprimit

1. Departamenti i Ndërveprimit krijohet në përbërje të Autoritetit në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe është përgjegjës për kryerjen e procedurave të vlerësimit të pajtueshmërisë apo përshtatshmërisë në lidhje me përdorimin e përbërësve të ndërveprimit hekurudhor dhe për vlerësimin e procedurave për verifikimin e nënsistemeve.

2. Në detyrat kryesore të Departamentit të Ndërveprimit përfshihen:

a) mbikëqyrja e mbarëvajtjes së procesit progresiv të ndërveprimit të sistemit hekurudhor shqiptar nëpërmjet harmonizimit të specifikimeve teknike hekurudhore;

b) mbikëqyrja e plotësimi i kërkesave thelbësore lidhur me sigurinë, besueshmërinë, mbrojtjen e shëndetit të personelit, mbrojtjen e ambientit, përputhshmërinë teknike dhe shfrytëzuese të sistemit;

c) hartimi dhe mbikëqyrja e plotësimi të specifikimeve teknike të ndërveprimit, KTN të përshtatura për çdo nënsistem dhe pjesë të nënsistemit;

ç) mbikëqyrja e plotësimi të kushteve të kualifikimit profesional të personelit hekurudhor;

d) hartimi i standardeve për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të kontroll-komandës dhe sinjalizimit, SKK;

dh) konsultimi me të gjitha palët e interesuara, përfshirë administruesit e infrastrukturës, sipërmarrësit hekurudhorë, prodhuesit dhe ofruesit e mirëmbajtjes, gjatë procesit për hartimin e kuadrit rregullator kombëtar për sigurinë në hekurudhë;

e) bashkëpunimi me institucionet kombëtare e organizmat ndërkombëtarë që operojnë në fushën e sigurisë së transportit hekurudhor në drejtim të zbatimit të standardeve teknike të ndërveprimit;

ë) hartimi i rregulloreve për ndërveprimin në fushën e transportit hekurudhor.

Neni 18

Departamenti Juridik

Departamenti Juridik krijohet në përbërje të Autoritetit në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe është i ngarkuar për:

a) përgatitjen për miratim të rregulloreve të hartuara nga departamentet e Autoritetit, të cilat ia paraqet drejtorit ekzekutiv;

b) njoftimin zyrtar për rregulloret e zbatueshme për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore dhe sipërmarrësit hekurudhorë;

c) njoftimin zyrtar të Agjencisë së Bashkimit Evropian për Hekurudhat, për rregulloret e zbatueshme në sektorin e transportit hekurudhor dhe autorizimet për vënie në shërbim të nënsistemeve hekurudhore.

Neni 19

Departamenti i Financës, Administratës dhe Burimeve Njerëzore

Departamenti Financës dhe Administratës krijohet në përbërje të Autoritetit në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe është përgjegjës, për:

a) ofrimin me kohë dhe me saktësi të shërbimeve të përgjegjësisë financiare;

b) mbikëqyrjen dhe monitorimin e regjistrave të kontabilitetit;

c) hartimin në kohë të deklaratave financiare;

ç) përgatitjen e raporteve financiare;

d) nxjerrjen e raporteve, analizën dhe shqyrtimin e bilanceve;

dh) ndihmesën në planifikimin e buxhetit të Autoritetit;

e) korrespondencën hyrëse dhe dalëse, monitorim të statusit të korrespondencave që kërkojnë masa;

ë) mbajtjen e arkivit të Autoritetit;

f) administron burimet njerëzore të Autoritetit;

g) administron aktivitetet e burimeve njerëzore, si: rekrutimi, vendosja e shpalljeve për punë, trajnimet e stafit, administrimi i kohës dhe prezencës në punë, vlerësimet e punës së stafit të Autoritetit;

gj) mbikëqyr planifikimin e trajnimit të stafit sipas planit të punës të Autoritetit;

h) mbikëqyr identifikimin e nevojave teknologjike të zyrave dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave.



Neni 20

Buxheti i Autoritetit

1. Autoriteti financohet nga:
 - a) të ardhurat nga aplikimet dhe dhënia e autorizimeve të sigurisë, certifikatave të sigurisë, futja dhe heqja e mjeteve nga shërbimi, regjistrimi i mjeteve dhe heqja e mjeteve nga regjistri;
 - b) buxheti i shtetit;
 - c) të ardhura të tjera, që mund të krijohen sipas legjislacionit në fuqi dhe/ose donacione të ndryshme.
2. Pasqyra financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve hartohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
3. Jo më vonë se 3 muaj para fillimit të çdo viti fiskal, Autoriteti harton një fond të shpenzimeve operative të parashikuara dhe ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës për transportin.
4. Të gjitha të ardhurat e tepërta për shpenzimet e Autoritetit kalojnë në buxhetin e shtetit.
5. Autoriteti mban regjistrat kontabël në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
6. Autoriteti përgatit pasqyrat financiare vjetore të veprimtarisë së vet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe, pas certifikimit nga ekspertët auditues, i raporton ministrit përgjegjës për transportin rezultatin financiar.

Neni 21

Raportet vjetore të sigurisë hekurudhore

1. Autoriteti i paraqet ministrit përgjegjës për transportin raportin vjetor të sigurisë jo më vonë se data 30 shtator të çdo viti.
2. Administruesit e infrastrukturës dhe sipërmarrësit hekurudhorë dërgojnë pranë Autoritetit jo më vonë se data 30 qershor të çdo viti raportet e tyre të sigurisë.
3. Përmbajtja e raportit të sigurisë përcaktohet në Kodin Hekurudhor.
4. Autoriteti publikon raportin vjetor të sigurisë në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit, në gjuhën shqipe dhe në anglisht.

KREU IV

BASHKËPUNIMI I AUTORITETIT

Neni 22

Bashkëpunimi me organet e tjera hekurudhore

1. Autoriteti bashkëpunon me autoritetet homologe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, në veçanti me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Hekurudhat dhe me shtetet nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Transportit.
2. Autoriteti mund të lidhë marrëveshje me autoritetet e tjera homologe kombëtare dhe të huaja sipas parashikimeve në Kodin Hekurudhor.
3. Autoriteti ka të drejtë t'u paraqesë autoriteteve të sigurisë hekurudhore kombëtare dhe të huaja ose organeve të tjera rekomandimet e sigurisë për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë për hekurudhat dhe ndërveprimin, siç përcaktohet në Kodin Hekurudhor.
4. Autoriteti informon rregullisht Agjencinë e Bashkimit Evropian për Hekurudhat, siç përcaktohet në Kodin Hekurudhor.
5. Autoriteti ka të drejtë të kërkojë informacionin nga administruesi i infrastrukturës, aplikantët dhe palët e treta që janë aktivë në tregun hekurudhor.

Neni 23

Konfidencialiteti

- Të dhënat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe investigimin e aksidenteve/incidenteve janë konfidenciale dhe nuk bëhen publike, përveç rasteve kur ministri përgjegjës për transportin përcakton se është në interes të publikut publikimi i tyre. Konsiderohen konfidenciale të dhënat e mëposhtme:
- a) të gjitha dëshmitë dhe deklaratat e dëshmitarëve dhe shënimet e tjera të marra nga Autoriteti gjatë procesit të sigurisë;
 - b) të dhënat për identitetin e personave që kanë dhënë dëshmi për çështjet e sigurisë hekurudhore.



Neni 24
Konflikti i interesit

1. Personi i autorizuar i Autoritetit për sigurinë, sipas përcaktimeve të Kodit Hekurudhor, dhe anëtari i Këshillit Drejtues janë të pavarur në aktivitetet, vlerësimet dhe në vendimmarrje nga palët e interesit.

2. Një person i autorizuar nga Autoriteti dhe anëtari i Këshillit nuk mund të kryejnë aktivitete të tjera që mund të ndikojnë në paanshmërinë dhe pavarësinë e vendimeve të tij

3. Mospërbushja e detyrimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni nga personi i autorizuar nga Autoriteti dhe anëtari i Këshillit ndëshkohet sipas masave të parashikuara në legjislacionet përkatëse në fuqi.

4. Një person, rasti i të cilit është në shqyrtim, mund të kundërshtojë personin përkatës të autorizuar të Autoritetit dhe anëtarin e Këshillit nëse ky person ka një konflikt interesi për çështjen në fjalë.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 25
Përfundimi dhe transferimi i kompetencave

1. Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor (DIH) shkrihet.

2. Të gjitha mjetet, burimet e të ardhurave, arkivat, detyrimet dhe kompetencat e tjera të DIH-së, me shkrirjen e këtij institucioni, i kalojnë Autoritetit dhe Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve Hekurudhore dhe Detare.

3. Drejtori Ekzekutiv, sipas procedurave të miratuara nga Këshilli Drejtues, fillon punën për rekrutimin e nëpunësve dhe të punonjësve të Autoritetit, duke trajtuar me përparësi të punësuarit në Drejtorinë e Inspektimit Hekurudhor.

4. Punonjësve të Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor, që nuk rekrutohen nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, u zgjidhet kontrata e punës në përputhje me legjislacionin e Kodit të Punës dhe të shërbimit civil.

KREU VI
**KUNDËRVAJTJET DHE MASAT
ADMINISTRATIVE**

Neni 26
Kundërvajtjet dhe gjobat

1. Autoriteti vendos gjoba për kundërvajtjet administrative dhe i publikon ato në faqen zyrtare të internetit.

2. Kur nuk përbëjnë veprë penale, shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) shkeljet e parashikuara në pikat 10, 12, 16, 18, 19, 21, 26, 27, 22, 38, 39, 40, 41 dhe 42 të nenit 159 të Kodit Hekurudhor me gjobë nga 50.000-75.000 lekë;

b) shkeljet e parashikuara në pikat 9, 11, 14, 15, 28, 29, 30 dhe 35 të nenit 159 të Kodit Hekurudhor me gjobë nga 75.000 deri 100.000 lekë;

c) shkeljet e parashikuara në pikat 13, 17 dhe 36 të nenit 159 të Kodit Hekurudhor me gjobë nga 75.000 deri 100.000 lekë;

ç) shkeljet e parashikuara në pikat 23, 24, 25, 30, 31, 32, 33, 34 dhe 37 të nenit 159 të Kodit Hekurudhor me gjobë nga 100.000 deri 150.000 lekë.

3. Përveç gjobës, Autoriteti vendos edhe kufizime të tjera të lidhura me profesionet për sektorin e transportit hekurudhor.

4. Të ardhurat nga gjobat derdhen në buxhetin e shtetit.

5. Kundër vendimeve për vendosje gjobe mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente administrative brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli Drejtues që brenda dy muajve nga emërimi i tij të hartojë dhe të miratojë rregulloren e brendshme të funksionimit të Autoritetit.



Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 1.7.2021.

LIGJ
Nr. 89/2021

PËR KRIJIMIN E AUTORITETIT
RREGULLATOR HEKURUDHOR²

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOS I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i Autoritetit Rregullator Hekurudhor, në vijim “Autoriteti”.

Neni 2
Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit dhe përfaqësimin e tij.

Neni 3
Objektivat e Autoritetit

Në kryerjen e veprimtarisë së tij, Autoriteti bazohet në objektivat e mëposhtme:

- a) mbrojtja e interesave të investitorëve në sistemin hekurudhor shqiptar;
- b) nxitja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregut hekurudhor;
- c) garantimi i ekuilibrave ekonomikë të sipërmarrjeve hekurudhore dhe/ose administruesve të infrastrukturës, si dhe kontrollin e thjeshtëzuar të kostove, që linden si rezultat i drejtpërdrejtë i shërbimeve hekurudhore;
- c) garantimi i konkurrencës së lirë përmes monitorimit në mënyrë të drejtë dhe efektive në tregun hekurudhor të Shqipërisë.

KREU II
STATUSI, STRUKTURA DHE
ADMINISTRIMI I AUTORITETIT

Neni 4
Statusi i Autoritetit

1. Autoriteti është person juridik publik, me seli në Tiranë, i cili organizohet dhe funksionon si agjenci autonome, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Organet drejtuese të Autoritetit janë këshilli drejtues dhe drejtori ekzekutiv.

Neni 5
Këshilli Drejtues

1. Këshilli drejtues është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të Autoritetit.

2. Këshilli drejtues është organ kolegial i përbërë nga kryetari dhe katër anëtarë, që emërohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin.

Neni 6
Kompetencat e këshillit drejtues

1. Këshilli drejtues ka këto kompetenca:

a) miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet specifike dhe përgjegjësitë e njësive organizative të Autoritetit,

² Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

- Direktivën 2012/34/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 nëntor 2012, “Për krijimin e një zone të vetme hekurudhore evropiane”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32012L0034, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 343, datë 14.12.2012, f. 32–77.



sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për nëpunësin civil;

b) harton dhe miraton parimet bazë të veprimtarisë së tij;

c) merr vendime për lidhjen e memorandumeve të bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacionit me autoritete brenda dhe jashtë vendit, në funksion të veprimtarisë së Autoritetit dhe në përputhje me sa është parashikuar në Kod;

ç) diskuton periodikisht raportet për veprimtarinë e njësisë organizative kryesore të Autoritetit;

d) miraton buxhetin dhe raportin vjetor të Autoritetit;

dh) i propozon ministrit strukturën dhe organikën e Autoritetit, e cila respekton parimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore;

e) i propozon ministrit kategoritë e pagave të nëpunësve dhe punonjësve të administratës së Autoritetit, duke respektuar legjislacionin në fuqi për pagat e nëpunësve civilë dhe të punonjësve mbështetës;

ë) miraton brenda muajit qershor të çdo viti raportin për sistemin hekurudhor për gjendjen dhe perspektivën e tregut, të inspektuar nga Autoriteti;

f) miraton në rregulloret për procedurat e brendshme administrative afatet për paraqitjen e çështjeve për shqyrtim;

g) miraton manualët e inspektimit;

gj) kompetenca të tjera të lidhura me hartimin dhe propozimin për miratim të akteve nënligjore për zbatimin e legjislacionit në fuqi.

2. Vendimet e marra nga këshilli drejtues janë objekt ankimimi në gjykatë, i cili mund të ketë efekt pezullues për vendimin e këshillit drejtues vetëm kur efekti i menjëhershëm i vendimit të tij mund të shkaktojë dëme të pariparueshme ose dukshëm të tepërta për ankuesin.

Neni 7

Kriteret e emërimit të kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues

1. Për t'u emëruar kryetar ose anëtar i këshillit drejtues, personat duhet të plotësojnë këto kriterë:

a) të kenë shtetësi shqiptare;

b) të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë;

c) të jenë me integritet moral e profesional sipas legjislacionit për garantimin e integritetit të personave të cilët zgjidhen ose kryejnë funksione publike;

ç) të jenë të paangazhuar në funksione drejtuese partiake;

d) të mos jenë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale;

dh) ndaj tyre të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) të mos kenë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

2. Kryetari i këshillit drejtues duhet të jetë me profesion jurist ose ekonomist dhe të ketë të paktën 10 (dhjetë) vjet eksperiencë në administratën publike, sektorin privat ose në institucione arsimore.

3. Anëtarët e këshillit drejtues duhet të jenë me profesion inxhinier, të specializuar në fushën e transportit, juristë dhe ekonomistë dhe të kenë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë në administratën publike, sektorin privat ose në institucione arsimore.

Neni 8

Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues

1. Mandati i kryetarit dhe i anëtarëve të këshillit drejtues është 4 (katër) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Një muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtarit të këshillit drejtues, Autoriteti lajmëron, me shkrim, ministrin, i cili fillon praktikën për emërimin e anëtarit të ri.

3. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues të Autoritetit mund të jenë të punësuar me kohë të plotë në detyra të tjera, por nuk mund të jenë anëtarë të një këshilli drejtues tjetër ose të një organi vendimmarrës të ndonjë autoriteti tjetër mbikëqyrës.

Neni 9

Shpërblimet e këshillit drejtues

Kryetari dhe anëtarit i këshillit drejtues shpërblehen në masën dhe sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave,



me propozim të ministrit përgjegjës për transportin.

Neni 10

Lirimi/shkarkimi nga detyra i kryetarit ose anëtarit të këshillit drejtues

1. Lirimi/shkarkimi nga detyra i kryetarit ose i anëtarit të këshillit drejtues përpara përfundimit të mandatit bëhet kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) bëhet fizikisht dhe/ose mendërisht i paafte për të përmbushur detyrën për të cilën është emëruar për më shumë se 3 (tre) muaj;
- c) mungon pa arsye në më shumë se 3 (tri) mbledhje radhazi;
- ç) i shkakton, për shkak të paaftësisë profesionale a të neglizhencës, dëm Autoritetit apo imazhit të këtij Autoriteti;
- d) vepron gjatë ushtrimit të funksioneve në kundërshtim me interesat e Autoritetit;
- dh) dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale;
- e) humbet ose lë shtetësinë shqiptare.
- ë) del në pension.

2. Propozimi për lirim nga detyra të kryetarit ose anëtarit të këshillit drejtues i paraqitet ministrit nga vetë këshilli, shoqëruar edhe me arsyet e provat për të cilat kërkohet ky lirim.

3. Ministri, në zbatim të pikës 2 të këtij neni, mund të vendosë pezullimin e kryetarit ose anëtarit nga funksioni deri në përfundimin e procesit të verifikimit e të marrjes së vendimit.

4. Në rast të krijimit të vakancës për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit, anëtari tjetër emërohet sipas përcaktimeve të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 11

Mbledhjet e këshillit drejtues

1. Mbledhjet e këshillit thirren me nismën e kryetarit, me kërkesën e secilit prej anëtarëve ose me kërkesë të drejtorit ekzekutiv të Autoritetit. Këshilli drejtues mbledhet të paktën 1 (një) herë në 2 (dy) muaj.

2. Mbledhjet e këshillit drejtohen nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve, i autorizuar prej tij.

3. Këshilli në mbledhjen e parë miraton rregulloren për organizimin e punës.

4. Mbledhja e këshillit drejtues zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 3 (tre) anëtarë dhe vendimet e tij janë të vlefshme kur votojnë pro të paktën 3 (tre) anëtarë. Në votim nuk lejohet abstenimi.

5. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm, ndërsa vendimet e këshillit nënshkruhen nga kryetari.

Neni 12

Transparenca në veprimtarinë e Autoritetit

1. Këshilli drejtues miraton rregulloren për procedurat e vënies në dispozicion të publikut të dokumentacionit që disponon, si dhe afatet e kushtet për mbajtjen e kopjeve të njësuara të këtij dokumentacioni në përputhje me legjislacionin në fuqi për informimin publik.

2. Çdo vendim i këshillit publikohet në faqen e Autoritetit në internet.

Neni 13

Drejtori ekzekutiv

1. Drejtori ekzekutiv është titullari i Autoritetit, i cili emërohet nga ministri në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për nëpunësin civil për emërimin e anëtarëve të TND-së.

2. Drejtori ekzekutiv nuk mund të jetë anëtar i këshillit drejtues.

3. Drejtori ekzekutiv merr pjesë në mbledhjet e këshillit pa të drejtë vote.

Neni 14

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv ka këto përgjegjësi e detyra:

a) është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së Autoritetit;

b) paraqet për miratim në këshillin drejtues rregulloren e brendshme të funksionimit të Autoritetit;

c) paraqet për miratim në këshillin drejtues buxhetin dhe programin përkatës të punës përpara fillimit të çdo veprimtarie;



ç) paraqet për miratim në këshillin drejtues programin ekonomik-financiar të Autoritetit, si dhe vlerat e tarifave që do të zbatohen për të gjitha shërbimet që lëshon ky Autoritet;

d) përfaqëson Autoritetin në marrëdhëniet me të tretët;

dh) ushtron të gjitha të drejtat dhe detyrat për të siguruar plotësimin e detyrimeve që i janë ngarkuar Autoritetit në zbatim të Kodit Hekurudhor.

e) nënshkruan dhe bën njoftimin e masave administrative për shkelje të nenit 22 të këtij ligji.

KREU III ADMINISTRATA E AUTORITETIT

Neni 15 Organizimi dhe detyrimet

1. Veprimtaria e Autoritetit mbështetet nga administrata, që funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet e punës, organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore dhe rregulloren e brendshme të Autoritetit, të miratuar nga këshilli drejtues sipas propozimit të drejtorit ekzekutiv.

2. Marrëdhëniet e punës së drejtorit ekzekutiv dhe të nëpunësve të administratës së Autoritetit rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve mbështetës rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

3. Struktura dhe organika e Autoritetit miratohen me urdhrë të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin.

Neni 16 Inspektimi

1. Inspektimi ushtrohet nga inspektorët e Autoritetit, sipas përcaktimit të bërë në urdhrin e nënshkruar nga drejtori ekzekutiv. Inspektimi bëhet me ose pa lajmërim.

2. Inspektorët e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të këtij neni, inspektojnë për respektimin e dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e transportit hekurudhor në territorin shqiptar.

3. Subjekti i inspektuar është i detyruar t'u sigurojë inspektorëve të Autoritetit kushte normale

pune, si dhe t'u ofrojë dokumentacion ose çdo të dhënë tjetër të shkruar në gjuhën shqipe.

4. Inspektorët e administratës së Autoritetit, para fillimit të procedurave të inspektimit, janë të detyruar të paraqesin urdhrin e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

5. Subjekti i inspektuar është i detyruar t'u ofrojë Autoritetit dhe administratës së tij:

a) mjetet e nevojshme për inspektim, nëse i kërkohet kjo, si dhe t'u përgjigjet pyetjeve në mjediset e Autoritetit;

b) personat e kontaktit nga radhët e të punësuarve, për të ndihmuar në kryerjen e inspektimit;

c) hyrje pa limit në mjediset e zyrave të subjekteve;

ç) të gjitha llogaritë, dokumentacionin tregtar dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, për të përcaktuar faktet dhe rrethanat në lidhje me çështjet për të cilat kryhet inspektimi;

d) pas një kërkesë paraprake, fotokopjet e llogarive dhe të dokumenteve të tjera, ku të shënohet me shkronja shtypi "E njëjtë me origjinalin", si dhe data dhe nënshkrimi i personit të autorizuar nga subjekti i inspektuar.

6. Raporti për çdo inspektim përgatitet në 2 (dy) kopje dhe nënshkruhet nga nëpunësi i Autoritetit që kryen inspektimin, si dhe i paraqitet për kundërfirmë personit që përfaqëson subjektin e inspektuar.

KREU IV KODI ETIK, PROFESIONALIZMI DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 17 Kodi etik dhe profesionalizmi

1. Anëtarët e këshillit drejtues, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, zbatojnë kodin e etikës dhe standardet profesionale, të miratuara nga këshilli drejtues sipas propozimit të drejtorit ekzekutiv.

2. Kur vërehen shkelje të kodit të etikës, merren masa disiplinore sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.



Neni 18

Konfidencialiteti

1. Të dhënat që i vihen në dispozicion Autoritetit për veprimtarinë e subjektit të inspektuar, klasifikohen si “informacion konfidencial” nëse përhapja e tyre cenon interesat tregtare ose emrin e mirë të subjektit.

2. Nuk janë informacione konfidenciale të dhënat tregtare të siguruara nga subjekti i inspektuar, detyrimi për botimin e të cilave është parashikuar nga ky ligj ose nga ligje të tjera. Klasifikimi i informacionit bëhet me rregullore të brendshme, të miratuar nga këshilli drejtues.

3. Kryetari e anëtarët e këshillit drejtues, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit janë të detyruar t'i ruajnë dhe të mos i shpërndajnë informacionet konfidenciale.

4. Informacioni i klasifikuar konfidencial nuk trajtohet më si i tillë me kalimin e 3 (tre) vjetëve nga çasti kur i është dorëzuar Autoritetit. Ky afat mund të zgjatet me vendim të këshillit drejtues.

KREU V

**FINANCIMI DHE BUXHETI I
AUTORITETIT**

Neni 19

Financimi dhe buxheti

1. Autoriteti financohet nga të ardhurat e realizuara nga vetë ai nga mbledhja e tarifave, si dhe nga buxheti i shtetit.

2. Të ardhurat në buxhetin e Autoritetit krijohen nga:

a) tarifat që mbledh Autoriteti sipas pikës 6 të këtij neni;

b) të ardhurat nga projektet dhe programet në të cilat është përfshirë, në zbatim të legjislacionit në fuqi për fushën e transportit hekurudhor dhe të ngjashme;

c) financimet nga buxheti i shtetit;

ç) çdo e ardhur tjetër e krijuar sipas legjislacionit në fuqi.

3. Pasqyrat financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve hartohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

4. Autoriteti, për përdorimin e fondeve të veta, u nënshtrohet dispozitave ligjore për prokurimet publike.

5. Të gjitha të ardhurat e tepërta në mbyllje të vitit fiskal për shpenzimet e Autoritetit kalojnë në buxhetin e shtetit.

6. Autoriteti mbledh tarifa për:

a) mbikëqyrjet e shkeljeve të pretenduara nga ankimuesit;

b) konsulenca të kërkuara nga sipërmarrës hekurudhorë;

c) konsultimet ndaj administruesve të infrastrukturës hekurudhore dhe operatorëve të impianteve të shërbimit.

Neni 20

Konflikti i interesit

1. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues të Autoritetit, si dhe nëpunësit e Autoritetit veprojnë në mënyrë të pavarur nga çdo interes tregu i lidhur me sektorin hekurudhor, dhe për rrjedhojë nuk mund të kenë asnjë interes ose marrëdhënie biznesi me sipërmarrjet ose subjektet hekurudhore të mbikëqyrura.

2. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues të Autoritetit, si dhe nëpunësit e Autoritetit bëjnë deklarin e mungesës së konfliktit të interesit përpara fillimit të ushtrimit të detyrës dhe në vijim çdo vit, sipas dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me deklarin e mungesës së konfliktit të interesit. Në deklaratën e mungesës së konfliktit të interesit, këta persona, duhet të tregojnë çdo interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që mund të konsiderohet se cenon pavarësinë e tyre dhe që mund të ndikojë në përmbushjen e funksioneve të tyre ligjore.

3. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues të Autoritetit nuk marrin pjesë në procedurat e diskutimit dhe vendimmarrjes nëse kanë interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për çështjen, interes i cili cenon paanësinë e tyre në vendimet që do të merren, si dhe me qëndrimet zyrtare. Nëpunësi i Autoritetit nuk merr pjesë në inspektime ndaj subjekteve të mbikëqyrura nëse ka interesa të drejtpërdrejta ose të tërthorta për çështjen për të cilën kryhet inspektimi, interes i cili cenon paanësinë e tyre.

4. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues të Autoritetit, si dhe nëpunësit e Autoritetit, nëse



vërejnë se ndodhen përpara rasteve të konfliktit të interesit të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, bëjnë deklaratat me shkrim për këtë fakt dhe tërhiqen nga shqyrtimi i çështjes.

5. Pas përfundimi të mandatit të kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit, ata nuk mund të punësohen ose të përfshihen në shërbime me pagesë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga subjektet e mbikëqyrura nga Autoriteti për një periudhë dyvjeçare.

KREU VI REGJISTRAT E AUTORITETIT

Neni 21 Regjistrat

1. Autoriteti krijon dhe mban regjistra elektronikë dhe fizikë të hapur për publikun, për:

a) shoqëritë që ushtrojnë veprimtari hekurudhore si veprimtari dytësore primare ose bazë;

b) shoqëritë që ushtrojnë veprimtari hekurudhore si institute ose studio private.

2. Këshilli drejtues, me propozimin e drejtorit ekzekutiv, miraton regjistra të tjerë dhe procedura për regjistrimin fillestar, mbajtjen dhe ruajtjet e regjistrave, si dhe procedurat që sigurojnë mirëfunksionimin e regjistrat si një sistem informativ i plotë.

KREU VII KUNDËRVAJTJET DHE MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 22 Kundërvajtjet administrative

1. Konsiderohen kundërvajtje administrative, nëse nuk përbëjnë vepër penale, veprimet dhe mosveprimet në rastet e mëposhtme:

a) kur administruesit e infrastrukturës, sipërmarrësit hekurudhorë apo cilado palë tjetër nuk i ofron Autoritetit Rregullator Hekurudhor të Tregut informacionin e kërkuar;

b) kur administruesit e infrastrukturës nuk publikojnë “Deklaratën e rrjetit” sipas kriterëve të përcaktuara në dispozitat e Kodit Hekurudhor;

c) kur administruesit e infrastrukturës nuk e njoftojnë Autoritetin Rregullator Hekurudhor për zbritjen e tarifës së qasjes në infrastrukturë;

ç) kur administruesit e infrastrukturës bëjnë rezervime të kapaciteteve të infrastrukturës pa respektuar procedurat e përcaktuara në këtë ligj dhe akteve ligjore dhe nënligjore që miratohen në zbatim të tij;

d) kur të ardhurat financiare, të krijuara nga qasja në infrastrukturën hekurudhore, nuk regjistrohen nga administruesi i infrastrukturës, si dhe nuk bëhen publike;

dh) kur evidentohen rastet që grafiku i shpërndarjes së kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore nga administruesi i infrastrukturës është hartuar në mënyrë diskriminuese, në kundërshtim me dispozitat e Kodit Hekurudhor;

e) kur infrastruktura hekurudhore është deklaruar e mbingarkuar nga administruesi i infrastrukturës dhe nuk analizohen kapacitetet në afatin e caktuar;

ë) kur nuk është propozuar plani për rritjen e kapaciteteve të infrastrukturës nga administruesi i infrastrukturës, në rastet kur infrastruktura është deklaruar e mbingarkuar, si dhe është përfunduar analiza e kapacitetit infrastrukturor;

f) kur administruesi i infrastrukturës nuk përgatit planin e kërkuar të biznesit dhe dokumentet që lidhen me to.

2. Kundërvajtjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë deri në 125 000 (njëqind e njëzet e pesëmijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje të shkeljes, nga 130 000 (njëqind e tridhjetëmijë) lekë deri në 150 000 (njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë. Në përllogaritjen e gjobës merren parasysh pasojat e shkaktuara nga shkelja, kohëzgjatja dhe rëndësia e tyre.

3. Cilido person që pengon Autoritetin, strukturat e tij ose nëpunësit e autorizuar të administratës së tij në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara nga ky ligj ose nga çdo akt tjetër, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 75 000 (shtatëdhjetë e pesëmijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje të shkeljes, nga 80 000 (tetëdhjetëmijë) lekë deri në 100 000 (njëqindmijë) lekë.

4. Për dëme të shkaktuara nga subjektet e kontrolluara (administruesi i infrastrukturës/sipërmarrës hekurudhor) ndaj palës që ankimohet tek Autoriteti, ky i fundit ka të drejtë të vendosë gjoba në vlerën deri në 10 për qind të xhiros vjetore për vitin e kaluar financiar.



5. Në rastin e kundërvajtjeve administrative, përveç gjobës mund të vendosen edhe kufizime të tjera të lidhura me profesionet për sektorin e transportit hekurudhor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Ndaj sanksioneve administrative, të vendosura sipas këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative.

7. Të ardhurat nga gjobat derdhen në buxhetin e shtetit.

8. Autoriteti publikon në faqen e tij zyrtare të internetit masat e marra në zbatim të pikës 1 të këtij neni.

Neni 23

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 9 të këtij ligji.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 1.7.2021.

LIGJ Nr. 90/2021

PËR NDARJEN E SHOQËRISË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA³

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

³ Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:

Direktivën 2012/34/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 21 nëntor 2012, “Për krijimin e një zone të vetme hekurudhore evropiane”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32012L0034, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 343, datë 14.12.2012, f. 32–77.

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ndarja e shoqërisë hekurudhore shtetërore

1. Shoqëria “Hekurudha shqiptare” sh.a. (HSH), ndahet në katër shoqëri pritëse si më poshtë:

a) Shoqëria Aksionare për Infrastrukturën Hekurudhore, në vijim Administruesi i Infrastrukturës;

b) Shoqëria Aksionare Hekurudhore për Transportin e Udhëtarëve, në vijim Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve;

c) Shoqëria Aksionare Hekurudhore për Transportin e Mallrave, në vijim Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallit;

ç) Shoqëria Aksionare Hekurudhore për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse në vijim Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore.

2. E drejta e pronarit të shoqërive të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni ushtrohet nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

3. Regjistrimi i shoqërive pritëse bëhet në përputhje me Kodin Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përgjegjësitë e Administruesit të Infrastrukturës

1. Administruesi i Infrastrukturës është shoqëria aksionare përgjegjëse për funksionimin, mirëmbajtjen, rindërtimin dhe rinovimin e infrastrukturës në rrjetet e transportit.

2. Administruesi i Infrastrukturës administron, menaxhon dhe kryen kontrollin e brendshëm të infrastrukturës në kuadër të politikës së zhvillimit dhe financimit të infrastrukturës hekurudhore kryesore.

3. Administruesi i Infrastrukturës ndan kapacitetet, mbledh tarifa dhe propozon për rishikimin e tyre dhe ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për:

a) zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore nëpërmjet planifikimit të rrjetit, me plan financiar



për investime në ndërtim dhe përmirësim të infrastrukturës;

b) funksionimin e infrastrukturës hekurudhore për ndarjen e rrugëve të kalimit të trenave, menaxhimin e trafikut dhe tarifimin e përdorimit të infrastrukturës;

c) mirëmbajtjen rutinë, parandaluese dhe atë korrigjuese të infrastrukturës hekurudhore nëpërmjet punimeve që synojnë të mirëmbajnë gjendjen dhe aftësinë e infrastrukturës ekzistuese;

ç) rinovimin e infrastrukturës hekurudhore nëpërmjet punimeve kryesore të zëvendësimit të infrastrukturës ekzistuese, të cilat nuk ndryshojnë performancën e saj të përgjithshme;

d) modernizimin e infrastrukturës hekurudhore nëpërmjet punimeve të mëdha modifikuese në infrastrukturë, që përmirësojnë performancën e përgjithshme të saj;

dh) funksionet thelbësore të menaxhimit të infrastrukturës, që nënkupton vendimmarrjen në lidhje me ndarjen e rrugëve të kalimit të trenit, duke përfshirë edhe përkufizimin dhe vlerësimin e disponueshmërisë dhe dhënien apo alokimin e rrugëve të trenave individuale, dhe vendimmarrjen në lidhje me tarifimin e infrastrukturës, përfshirë përcaktimin dhe mbledhjen e tarifave në përputhje me kornizën e tarifimit dhe kornizën e ndarjes së kapaciteteve në konformitet me Kodin Hekurudhor;

e) ofrimin e impianteve të shërbimit në mënyrë jodiskriminuese, të barabartë dhe transparente për të gjithë sipërmarrësit e licencuar hekurudhorë, në përputhje me pikat 1 dhe 4 të nenit 15 të Kodit Hekurudhor;

ë) jetësimin dhe zbatimin e projekteve hekurudhore kombëtare dhe rajonale në rrjetet transeuropiane (TEN-T).

2. Për menaxhimin e aseteve të infrastrukturës hekurudhore lidhet kontratë me autoritetin kompetent, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e administruesit të infrastrukturës për një afat kohor prej të paktën katër vjetësh.

3. Administruesi i infrastrukturës është përgjegjës për garantimin e specifikimeve teknike për ndërveprimin hekurudhor.

4. Administruesi i Infrastrukturës mat, përmirëson dhe monitoron performancën e funksionimit të kapaciteteve infrastrukturore dhe kulturës së sigurisë hekurudhore.

5. Administruesi i Infrastrukturës garanton miradministrimin e sistemeve të planit të menaxhimit të aseteve të pasurive infrastrukturore.

6. Administruesi i Infrastrukturës me ministrin përgjegjës për infrastrukturën lidhin kontratë shumëvjeçare të parametrave teknikë infrastrukturorë hekurudhorë.

Neni 3

Përgjegjësitë e Sipërmarrësit Hekurudhor të Transportit të Udhëtarëve

1. Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve është përgjegjës për administrimin, funksionimin e shërbimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të transportit hekurudhor të udhëtarëve, nëpërmjet lokomotivave dhe vagonëve të udhëtarëve, të blera ose të marra me qira, duke garantuar:

a) performancën e lartë të këtij lloji transporti;

b) miradministrimin e aseteve të mjeteve lëvizëse.

2. Ministri përgjegjës për infrastrukturën dhe Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve lidhin kontratën e shërbimit publik për të garantuar që ky shërbim me interes të përgjithshëm të ofrohet me kapacitet sa më të lartë, të jetë sa më i sigurt, sa më cilësor ose i ofruar me çmime më të ulëta sesa ato të tregut të hapur.

3. Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve mund të jetë përfituesi i të drejtës ekskluzive për të ofruar shërbimin publik për transportin e udhëtarëve me hekurudhë.

4. Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve është përgjegjës për mirëmbajtjen e regjistrit të mjeteve ku është shënuar edhe sipërmarrësi përgjegjës për mirëmbajtjen e mjeteve të tij.

Neni 4

Përgjegjësitë e Sipërmarrësit Hekurudhor të Transportit të Mallrave

Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallrave është përgjegjës për administrimin, funksionimin e shërbimeve kombëtare dhe ndërkombëtare hekurudhore të transportit të mallrave dhe mjeteve të kombinuara të transportit, në kuptimin e transportit multimodal, nëpërmjet



lokomotivave dhe vagonëve, të blerë ose të marrë me qira, duke garantuar:

- a) kryerjen e transportit të mallrave;
- b) rregullimin ligjor të transportit hekurudhor të mallrave;
- c) miradministrimin e regjistrave të mjeteve dhe planit të aseteve të mjeteve tërheqëse dhe lëvizëse.

Neni 5

Përgjegjësitë e Sipërmarrësit të Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore

1. Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore është përgjegjës për modernizimin, riparimin, përmirësimin, rinovimin dhe rindërtimin e elementeve përbërës të ndërveprimit të mjeteve hekurudhore tërheqëse dhe lëvizëse, të rënda dhe të lehta.

2. Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore është përgjegjës për mirëmbajtjen e asaj infrastrukture që i përket planit të aseteve të administruar prej tij, si dhe të objekteve të destinuara për ofrimin e shërbimeve hekurudhore dhe shërbimeve të tjera nëpërmjet:

a) realizimit të ndërveprimit si aftësi e sistemit hekurudhor për të lejuar përdorim të sigurt dhe të pandërprerë të mjetit hekurudhor, që përmbushin nivelet e kërkuara të performancës për ato linja;

b) garantimit të standardeve europiane dhe ndërkombëtare të harmonizuar në atë shqiptare për zbatimet hekurudhore, pas rindërtimit të mjetit hekurudhor, i cili do të pajiset me autorizim për futjen në shërbim të mjetit;

c) lëshimin e faturave për shërbimet për të tretët dhe mbledhjen e tarifave të këtyre shërbimeve nga subjekti përgjegjës i certifikuar për mirëmbajtjen e mjetit hekurudhor.

Neni 6

Procedura e krijimit të shoqërive aksionare hekurudhore

1. Ministria përgjegjëse për ekonominë realizon ndarjen e shoqërisë jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

2. Me kryerjen e kësaj procedure aktivitetet dhe pasivet e shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a., transferohen te shoqëritë pritëse.

3. Procesi i ndarjes bëhet në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

4. Shoqëria “Hekurudha shqiptare” sh.a., vlerësohet e prishur dhe çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit pa kryerjen e likuidimit.

5. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit pasohet me:

a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim pasqyrohet edhe në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve të shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a, në aksionarë të shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes.

6. Në ditën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, shoqëria e infrastrukturës hekurudhore, shoqëria e transportit të pasagjerëve, shoqëria e transportit të mallrave dhe shoqëria e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse bëhen administruar të aseteve që i janë alokuar secilës prej tyre në veçanti.

7. Pasuritë e shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a., ndahen dhe i alokohen si pronësi në administrim të katër shoqërive të reja, që krijohen përmes akteve të veçanta dhe të drejtpërdrejta të transferimit të pronësisë, midis ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në emër të Republikës së Shqipërisë, dhe përkatësisht, shoqërisë së infrastrukturës, shoqërisë së transportit të pasagjerëve, shoqërisë së transportit të mallrave dhe shoqërisë së mirëmbajtjes.

8. Përjashtim nga dispozitat e përmendura në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, do të ketë për ndërtesat e biznesit, në veçanti stacionet e pasagjerëve dhe terminallet e mallrave dhe ndërtesat e tjera, pasuritë e të cilave shfrytëzohen kryesisht për interes publik. Ato i ngarkohen për menaxhim Administruesit të Infrastrukturës, me qëllim nxitjen e konkurrencës midis sipërmarrjeve hekurudhore dhe zhvillimit të transportit multimodal të udhëtarëve dhe mallrave dhe sigurimit të aksesit të drejtë dhe jodiskriminues nga palët e treta.

9. Të gjitha pasuritë e tjera që nuk lidhen me veprimtaritë e biznesit të katër shoqërive i atribuohen Administruesit të Infrastrukturës, që i menaxhon sipas parimeve të biznesit.



10. Organet drejtuese të shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a., në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe ministrinë përgjegjëse për financat, hartojnë planin social që përcakton rregullat se cilët nga punonjësit e shoqërisë do të jenë:

- a) të punësuar;
- b) të liruar nga puna për shkak riorganizimi të shoqërive.

11. Plani social përcakton edhe ndarjen e përfitimeve sociale sipas legjislacionit në fuqi midis shoqërive pritëse.

Neni 7

Statusi i shoqërive pritëse dhe menaxhimi i tyre

1. Shoqëritë pritëse do të administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

2. Shoqëritë pritëse ushtrojnë aktivitetet e tyre në treg duke synuar ofrimin e shërbimeve efikase dhe të përshtatshme me koston më të ulët të mundshme për cilësinë e shërbimit të kërkuar.

3. Shoqëritë pritëse përditësojnë planet e masave të mitigimit të risqeve dhe regjistrat.

4. Shoqëritë pritëse përcaktojnë planet e tyre të biznesit, përfshirë programet e tyre të investimit dhe të financimit. Planet hartohen për të arritur ekuilibrin financiar të shoqërisë dhe objektivat e tjerë teknikë, tregtarë dhe të menaxhimit financiar, duke treguar mënyrat e arritjes së këtyre objektive.

5. Në përputhje me planet dhe kontratat kombëtare, duke përfshirë planet e investimeve dhe të financimit, shoqëritë pritëse, veçanërisht, janë të lira të:

- a) krijojnë organizimin e tyre të brendshëm;
- b) kontrollojnë furnizimin dhe tregtimin e shërbimeve dhe rregullojnë çmimin e tyre;
- c) marrin vendime për personelin, asetet dhe prokurimet e veta;
- ç) zgjerojnë pjesën e tyre të tregut, zhvillojnë teknologji të reja dhe shërbime të reja dhe adoptojnë çdo teknikë inovative të menaxhimit;
- d) krijojnë aktivitete të reja në fushat që lidhen me biznesin hekurudhor.

6. Pavarësisht nga parashikimi i pikës 4 të këtij neni, aksionarët e sipërmarrjeve hekurudhore në pronësi publike ose të kontrolluara kërkojnë

miratimin e tyre paraprak për vendimet kryesore të administrimit të biznesit në të njëjtën mënyrë si aksionarët e shoqërive aksionare private, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin tregtar.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e aksionarit të shoqërive

Në bazë të përcaktimeve të neneve 6 dhe 7 të këtij ligji, ministri përgjegjës për ekonominë përcakton të drejtat dhe detyrimet që ka si aksionar i shoqërive pritëse dhe, në veçanti, për sa i përket:

a) kuadrit politik të të katër shoqërive aksionare si aktorë të rinj në sektorin hekurudhor të ristrukturuar;

b) mekanizmat për reduktimin e borxheve të katër kompanive aksionare në një nivel që nuk pengon menaxhimin e shëndoshë financiar dhe që përmirëson situatën e ardhshme financiare, siç parashikohet në Kodin Hekurudhor në fuqi;

c) aksionarët dhe përgjegjësitë e financimit për katër shoqëritë aksionare, me qëllim mbulimin e humbjeve të ardhshme që mund të lindin nga kryerja e përgjegjësisë të përcaktuara në nenet 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji;

ç) përzgjedhjen e këshillave mbikëqyrës të katër shoqërive aksionare, duke siguruar që të njëjtët individë nuk mund të emërohen në këto raste:

i. si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të një Administruesi të Infrastrukturës dhe si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të një sipërmarrjeje hekurudhore;

ii. si persona përgjegjës për marrjen e vendimeve për funksionet thelbësore dhe si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të një sipërmarrjeje hekurudhore;

iii. kur ekziston një këshill mbikëqyrës, si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të një Administruesi të Infrastrukturës dhe si anëtarët e këshillit mbikëqyrës të një sipërmarrjeje hekurudhore;

iv. si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të një sipërmarrjeje, e cila është pjesë e një sipërmarrjeje të integruar vertikalisht dhe ushtron kontroll si për një sipërmarrje hekurudhore, ashtu edhe për një menaxher të infrastrukturës dhe si anëtarë të këshillit mbikëqyrës ose organeve drejtuese të atij Administruesi të Infrastrukturës.

d) përzgjedhjen e Komitetit të Auditimit.



Neni 9
Dispozita të fundit

1. Shoqëria “Hekurudha shqiptare” sh.a., çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit jo më vonë se gjashtë muaj pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të katër shoqërive pritëse.

2. Shoqëritë pritëse janë pasardhëset ligjore të shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a., për sa i përket transferimit të pasurive dhe të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të tjera.

3. Deri në ditën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të katër shoqërive pritëse, shoqëria “Hekurudha shqiptare” sh.a., mban të gjitha përgjegjësitë për administrimin e infrastrukturës hekurudhore dhe shërbimeve të transportit hekurudhor.

4. Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve, Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Mallrave dhe Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore aplikojnë për licencat përkatëse, certifikatat dhe lejet e tjera në përputhje me përcaktimet në Kodin Hekurudhor në fuqi, jo më vonë se 180 ditë nga dita e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5. Administruesi i Infrastrukturës aplikon për licencë dhe autorizim të sigurisë hekurudhore sipas Kodit Hekurudhor.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 1.7.2021.

LIGJ
Nr. 91/2021

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT
KOMBËTAR TË INVESTIGIMIT TË
AKSIDENTEVE DHE INCIDENTEVE
HEKURUDHORE DHE DETARE**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është krijimi, organizimi dhe funksionimi i Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare, në vijim AKIAIHD.

**Neni 2
Objekti i ligjit**

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e AKIAIHD-së, si dhe marrëdhëniet e tij me autoritetet e tjera hekurudhore dhe detare.

**Neni 3
Fusha e veprimtarisë së AKIAIHD-së**

1. Fusha e veprimtarisë së AKIAIHD-së është parandalimi dhe investigimi i aksidenteve dhe i incidenteve hekurudhore dhe detare në Republikën e Shqipërisë.

2. Metodologjia, rregullat, procedurat, standardet dhe praktikat për kryerjen e investigimit të aksidenteve dhe të incidenteve hekurudhore e detare përcaktohen me rregullore, të miratuar nga ministri përgjegjës për transportet.



KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AKIAIHD-SË

Neni 4 Statusi i AKIAIHD-së

1. AKIAIHD-ja është person juridik, publik, me seli në Tiranë. AKIAIHD-ja është një strukturë e pavarur në organizimin, strukturën ligjore dhe vendimmarrjen e tij. Veprimtaria e AKIAIHD-së mbikëqyret nga ministri përgjegjës për transportin.

2. AKIAIHD-ja organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi në fushën e transportit hekurudhor dhe atij detar.

Neni 5 Funksionet e AKIAIHD-së

AKIAIHD-ja kryen funksionet e investigimit të aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore e detare në përputhje me Kodin Hekurudhor dhe Kodin Detar. AKIAIHD-ja kryen funksionet e mëposhtme:

a) harton rregullore dhe udhëzime të nevojshme për të realizuar funksionet e investigimit të aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore e detare të përcaktuara në Kodin Hekurudhor dhe Kodin Detar;

b) kur e shih të arsyeshme, lëshon rekomandime për administruesit e infrastrukturës, sipërmarrësit dhe autoritetet e sigurisë;

c) mbikëqyr dhe monitoron në terren të gjitha çështjet e lidhura me rekomandimet e lëshuara nga ai vetë.

Neni 6 Organizimi

1. AKIAIHD-ja organizohet në nivel qendror dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. AKIAIHD-ja drejtohet nga kryetari i AKIAIHD-së, që është investuesi kryesor.

3. Struktura dhe organika e AKIAIHD-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për transportet sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës

shtetërore. Njësitë organizative përgjegjëse për investigimin në përbërje të AKIAIHD-së kanë të paktën, 6 (gjashtë) investigues.

4. Kryetari i AKIAIHD-së emërohet dhe lirohet nga Kryeministri, me propozim të ministrit përgjegjës për transportet, për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë riemërimi vetëm një herë. Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e AKIAIHD-së rregullohen në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve mbështetës rregullohen sipas Kodit të Punës.

Neni 7 Kriteret për emërimin dhe lirimimin e kryetarit të AKIAIHD-së

1. Kryetari i AKIAIHD-së zgjidhet midis profesionistëve më të mirë, me eksperiencë në çështjet e investigimit të aksidenteve dhe incidenteve në transportin hekurudhor dhe/ose detar, me eksperiencë në mbikëqyrje, investigim dhe çështjet e sigurisë.

2. Kryetari i AKIAIHD-së duhet të ketë një eksperiencë të gjerë në fushën e sigurisë hekurudhore apo detare për të paktën 10 (dhjetë) vjet.

3. Kryetari i AKIAIHD-së nuk duhet të ketë qenë i përfshirë në biznese në sektorin e transportit hekurudhor dhe detar dhe as nuk duhet të ketë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në këto biznese në 3 vjetët e fundit përpara emërimit në AKIAIHD, dhe nuk duhet të ketë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në furnitorët e këtij sektori.

4. Kryetari i AKIAIHD-së lirohet nga detyra kur:

a) plotëson moshën për pension të plotë pleqërie;

b) jep dorëheqjen;

c) është në paaftësi fizike ose mendore për ushtrimin e detyrës për një periudhë mbi 6 muaj;

ç) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;

d) nuk ushtron detyrën në përputhje me legjislacionin në fuqi;

dh) kryen akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij.



Neni 8

Të drejtat dhe detyrat e kryetarit të AKIAIHD-së

Kryetari i AKIAIHD-së ka këto të drejta dhe detyra:

a) ndërmerr të gjitha veprimet ligjore në emër të AKIAIHD-së dhe e përfaqëson atë në të gjitha procedurat ndaj palëve të treta;

b) lidh kontrata në emër të AKIAIHD-së;

c) merr vendimin për investigimin e një aksidenti dhe incidenti hekurudhor e detar;

ç) në mënyrë periodike i raporton ministrit përgjegjës për transportin për veprimtarinë e tij, si dhe i paraqet ministrit në çdo kohë, me kërkesë të tij, çdo të dhënë ose informacion në lidhje me veprimtarinë e tij;

d) kryen detyra të tjera të përcaktuara në Kodin Hekurudhor dhe Kodin Detar, aktet ligjore e nënligjore në këta sektorë, dhe në çdo traktat ose marrëveshje kombëtare, ndërkombëtare;

dh) autorizon ekspertë jashtë AKIAIHD-së për detyra të veçanta, të cilat nuk mund të kryhen nga personeli i AKIAIHD-së;

e) miraton rregulloren për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit, jo më vonë se 2 (dy) muaj pas krijimit të AKIAIHD-së;

ë) merr masa në përputhje me nevojat e AKIAIHD-së;

f) komunikon me autoritetet rajonale të Bashkimit Evropian për çështjet e sigurisë;

g) merr çdo vendim që e vlerëson të nevojshëm, brenda kompetencave të tij, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

gj) organizon, menaxhon, mbikëqyr, planifikon, koordinon, vlerëson personelin dhe mban përgjegjësi për aktivitetet e tyre dhe përmbushjen nga ana e tyre të detyrave të caktuara;

h) përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e personelit, vendimarrjen e brendshme dhe rregullat që lidhen me aktivitetet financiare apo administrative.

Neni 9

Financimi i AKIAIHD-së

1. AKIAIHD-ja është institucion buxhetor dhe financohet nga buxheti i shtetit, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.

2. Në rastin e ngjarjeve të caktuara, Këshilli i Ministrave akordon fondet përkatëse, të mjaftueshme për të realizuar procesin e plotë të investigimit.

Neni 10

Konfidencialiteti

Të dhënat e mbledhura gjatë investigimit janë konfidenciale dhe nuk duhet t'u vihen në dispozicion personave që nuk janë të përfshirë në investigimin e aksidentit dhe incidentit hekurudhor dhe detar, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin se këto të dhëna përbëjnë interes publik madhor. Të dhëna konfidenciale janë:

a) dëshmitë dhe deklaratat e dëshmitarëve dhe regjistrimet e marra nga investiguesit gjatë procesit të investigimit;

b) të dhënat që zbulojnë identitetin e personave që kanë dhënë dëshmi gjatë investigimit;

c) informacionet në lidhje me personat e përfshirë në një aksident dhe incident hekurudhor dhe detar, që konsiderohet i një natyre të ndjeshme dhe private, sidomos informacioneve që kanë të bëjnë me shëndetin e tyre.

Neni 11

Konflikti i interesit

1. Investiguesi, si personi i autorizuar nga AKIAIHD-ja, është i pavarur nga palët e interesuara gjatë aktivitetit të tij profesional, vlerësimeve dhe vendimarrjes.

2. Investiguesit, si personi i autorizuar nga AKIAIHD-ja, nuk i lejohet të kryejë aktivitete të tjera që mund të ndikojnë në paanshmërinë dhe pavarësinë e vendimeve të tij.

3. Mospërmbushja nga ana e investiguesit, si personi i autorizuar nga AKIAIHD-ja, e këtyre detyrimeve, të sanksionuara në pikën 2 të këtij neni, e bëjnë atë ligjërisht përgjegjës sipas akteve ligjore përkatëse.

4. Personi, rasti i të cilit është në shqyrtim, mund të kundërshtojë investiguesin, si personin e autorizuar nga AKIAIHD-ja, nëse ky i fundit ka interesa personale për çështjen në fjalë.



KREU III
BASHKËPUNIMI, INFORMACIONI DHE
RAPORTIMI

Neni 12
**Bashkëpunimi me autoritetet e tjera
hekurudhore dhe detare**

1. AKIAIHD-ja bashkëpunon me autoritetet homologe të shteteve të huaja.

2. AKIAIHD-ja mund të lidhë marrëveshje me autoritetet e tjera homologe, kombëtare dhe të huaja, siç përcaktohet në aktet ligjore të Republikës së Shqipërisë.

3. AKIAIHD-ja ka të drejtë t'u paraqesë autoriteteve të sigurisë, kombëtare dhe të huaja, ose organeve të tjera rekomandime për çështje që kanë të bëjnë me sigurinë dhe ndërveprimin, siç përcaktohet në Kodin Hekurudhor dhe Kodin Detar.

4. AKIAIHD-ja informon rregullisht agjencitë ose zyrat respektive të Bashkimit Evropian për çështjet përkatëse hekurudhore dhe detare, siç është përcaktuar në Kodin Hekurudhor dhe Kodin Detar.

Neni 13
Marrja e informacionit

1. Kur ndodh një aksident dhe incident hekurudhor apo detar, sipërmarrësit hekurudhorë, administruesit e infrastrukturës, sipas rastit Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore dhe sipërmarrësit detarë, janë të detyruar të njoftojnë menjëherë AKIAIHD-në.

2. AKIAIHD-ja ka të drejtë të kërkojë informacione, që i vlerëson të nevojshme, nga subjektet publike dhe private, administruesi i infrastrukturës, sipërmarrësit në veprimtaritë hekurudhore dhe detare, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore dhe palët e treta që janë aktive në tregun përkatës.

3. Në rast se AKIAIHD-ja pengohet në marrjen e informacionit nga subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, raporton menjëherë të gjitha autoritetet e përfshira në procesin e informimit dhe ndjek procedurat ligjore në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit.

Neni 14
Raportimi dhe publikimi

1. AKIAIHD-ja i paraqet ministrit përgjegjës për transportin raportin vjetor të vitit paraardhës brenda datës 31 mars të çdo viti.

2. Raporti vjetor do të përmbajë:

a) përmbledhje të aktiviteteve dhe të vendimeve të marra nga AKIAIHD-ja;

b) analizë dhe përshkrim të shkallës së integritetit të AKIAIHD-së në sistemin evropian të investigimit hekurudhor dhe detar;

c) propozime për ndryshime ligjore dhe institucionale.

3. AKIAIHD-ja e publikon raportin vjetor në faqen zyrtare të saj, në gjuhën shqipe dhe të paktën në një gjuhë zyrtare të Bashkimit Evropian

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 15
Përfundimi dhe transferimi i kompetencave

Informacioni i nevojshëm për proceset e investigimit të aksidenteve dhe incidenteve të sistemit hekurudhor dhe detar nga strukturat përgjegjëse transferohet pranë AKIAIHD-së me krijimin e tij.

Neni 16
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet ministri përgjegjës për transportin që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë rregullore në zbatim të nenit 3, pika 2, të tij.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 1.7.2021.

**LIGJ**
Nr. 94/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 27, DATË
1.7.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË NË
LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008, ‘PËR
PROCEDURAT TATIMORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të
Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.
27, datë 1.7.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për një
shitesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, ‘Për
procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, të
ndryshuar”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 7.7.2021.

LIGJ
Nr. 95/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 28, DATË
6.7.2021, “PËR MIRATIMIN E
MARRËVESHJES SË NËNSHKRUAR
PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN
NGA DHE NDËRMJET *PFIZER*
OVERSEAS LLC DHE MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE TË SHQIPËRISË, INSTITUTIT
TË SHËNDETIT PUBLIK DHE
MINISTRIT TË SHETIT
PËR RINDËRTIMIN”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të
Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.
28, datë 6.7.2021, “Për miratimin e marrëveshjes së
nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin nga dhe
ndërmjet *Pfizer Overseas LLC* dhe Ministrisë së
Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë,
Institutit të Shëndetit Publik dhe ministrit të Shtetit
për Rindërtimin”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 7.7.2021.



LIGJ
Nr. 96/2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 9947, DATË 7.7.2008,
“PËR PRONËSINË INDUSTRIALE”,
TË NDRYSHUAR⁴

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 1, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Objekt i këtij ligji është rregullimi i sistemit të dhënies dhe mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, si dhe rregullimi i sistemit të mbrojtjes së sekretit tregtar kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme.

Pronësia industriale ka si objekt të saj:

- a) disenjot industriale;
- b) emërtimet e origjinës;
- c) markat tregtare;
- d) modelet e përdorimit;
- d) patentat për shpikje;
- dh) treguesit gjeografikë.”.

Neni 2

Në nenin 4, pas pikës 24 shtohen pikat 25 deri në 34 me këtë përmbajtje:

⁴ Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

- Direktivën (BE) 2016/943 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 8 qershor 2016, “Mbi mbrojtjen e njohurive teknike dhe informacionit tregtar të fshehtë (sekretit tregtar), kundër përvetësimit, përdorimit e bërjes publike në mënyrë të paligjshme të tyre”. Numri CELEX 32016L0943, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 157, datë 15.6.2016, f. 1–18.

“25. “Akti i Gjenevës” është Akti i Gjenevës i Marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë, i datës 20.5.2015, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

26. “Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut” është organi përgjegjës i ngarkuar me ligj për procedurat e inspektimit në Republikën e Shqipërisë, i cili vepron në përputhje me kërkesat ligjore specifike të përcaktuara në këtë ligj lidhur me mallrat e falsifikuara, mallrat pirate ose mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale.

27. “Kërkesë-ankesë për inspektim” është kërkesa që paraqitet pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut për të ndërmarrë veprime lidhur me mallrat e falsifikuara, mallrat pirate ose mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale.

28. “Kërkues i kërkesë-ankesës për inspektim” është pronari ose mbajtësi i të drejtave të pronësisë industriale dhe/ose përfaqësuesi i autorizuar i tij, në emër të të cilit paraqitet një kërkesë-ankesë për inspektim sipas këtij ligji.

29. “Mallra të falsifikuara” nënkuptojnë:

i. mallra, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel një markë tregtare dhe, pa lejen e mbajtësit të së drejtës, mbajnë një shenjë identike me markën tregtare të regjistruar rregullisht për të njëjtat lloje mallrash ose që në thelb është e padallueshme nga kjo markë;

ii. mallra, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel një tregues gjeografik/emërtim origjine dhe mbajnë ose janë të përshkruara me një emër ose term të mbrojtur lidhur me atë tregues gjeografik/emërtim origjine;

iii. çdo paketim, etiketë, ngjitës, broshurë, udhëzues përdorimi, dokument garancie ose artikull tjetër i ngjashëm, edhe nëse paraqitet veçmas, që është objekt i një veprimi që shkel një markë tregtare ose një tregues gjeografik/emërtim origjine, që përfshin një shenjë, emër ose term që është identik me një markë tregtare të regjistruar rregullisht ose tregues gjeografik/emërtim origjine të mbrojtur, ose që në thelb është e padallueshme nga një markë tregtare apo tregues gjeografik/emërtim origjine i tillë dhe që mund të përdoret për të njëjtin lloj mallrash si ai për të cilin është regjistruar marka tregtare ose treguesi gjeografik/emërtim origjine.



30. “Mallra pirate” janë mallra të cilat janë objekt i një veprimi që shkel të drejtat e një disenoje industriale në Republikën e Shqipërisë dhe janë/ose përmbajnë kopje të bëra pa pëlqimin e mbajtësit të të drejtave të lidhur me disenjon industriale apo të një personi të autorizuar prej mbajtësit në vendin e prodhimit.

31. “Mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale” janë mallrat e identifikuar në Republikën e Shqipërisë, të cilat, në pamje të parë, kanë tregues të arsyeshëm se:

i. janë objekt i një veprimi që shkel një të drejtë të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë;

ii. kanë pajisje, produkte apo komponentë që janë projektuar, prodhuar ose përshtatur, kryesisht me qëllim për të mundësuar apo lehtësuar shmangien nga çdo teknologji, pajisje apo komponent, që në rrjedhën normale të operacionit të tij parandalon ose kufizon veprime lidhur me vepra të paaautorizuara nga mbajtësi i të drejtave të pronësisë industriale dhe që lidhet me një veprim që shkel këto të drejta në Republikën e Shqipërisë;

iii. kanë çdo format apo matricë të disenuar apo të përshtatur specifikisht për prodhimin e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë industriale, nëse këto formate apo matrica lidhen me një veprim që shkel të drejtën e pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë.

32. “Marrëveshja e Lisbonës” është marrëveshja për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar, e datës 3.10.1958, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

33. “Mbajtës/tregtar i mallrave” është personi që ka në posedim ose në pronësi dhe/ose tregton mallra të falsifikuara, mallra pirate ose mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale apo që ka të drejta të ngjashme për tjetërsimin/shkatërrimin ose kontrollin fizik të këtyre mallrave, me përjashtim të mallrave të mëposhtme:

a) mallra të natyrës jo tregtare, që ndodhen në posedimin dhe/ose pronësinë e një individi;

b) mallra të cilat janë prodhuar nga një person me pëlqimin e mbajtësit të së drejtës apo mallra që janë prodhuar nga një person i autorizuar ligjërisht nga mbajtësi i së drejtës për prodhimin e një sasie të caktuar të mallrave, në tejkallim të sasive për të cilat është rënë dakord ndërmjet personit në fjalë dhe mbajtësit të së drejtës.

34. “Shkatërrim” është shkatërrimi fizik, riciklimi ose asgjësimi i mallrave jashtë kanaleve tregtare në një mënyrë të tillë që të parandalojë dëmtimet ndaj pronarit ose mbajtësit të të drejtave të pronësisë industriale, proces i cili kryhet pas heqjes së mallrave nga tregu dhe vendosjes së tyre në një vend të caktuar.”.

Neni 3

Në nenin 19, pika 4, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) pasi patenta është dhënë dhe pavarësisht nga shfuqizimi ose anulimi i saj, te të gjithë që e kanë kërkuar atë.”.

Neni 4

Në nenin 28, në pikën 3 fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Kundër vendimit të Bordit të Apelimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Bordit të Apelimit.”.

Neni 5

Në nenin 33, pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Çdo palë, kundër vendimit të Bordit të Apelimit, mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Bordit të Apelimit.”.

Neni 6

Në nenin 101 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Objekti i mbrojtjes dhe efektet e një certifikate të mbrojtjes shtesë zgjaten vetëm te produkti për të cilin është lëshuar autorizimi i parë për hedhjen e produktit në treg dhe për çdo përdorim të autorizuar të këtij produkti.”.

Neni 7

Pas pjesës II shtohet pjesa II/a me këtë përmbajtje:



“PJESA II/a
SEKRETET TREGTARE

Neni 111/a
Përkufizime

1. “Sekreti tregtar” është informacioni që përmbush kërkesat e mëposhtme:

a) është sekret në kuptimin që në tërësinë e tij ose për sa i përket konfigurimit të saktë dhe kombinimit të pjesëve përbërëse të tij, nuk është gjerësisht i njohur ose lehtësisht i aksesueshëm për personat që përgjithësisht merren me llojin e informacionit në fjalë;

b) ka vlerë tregtare, sepse është sekret;

c) u është nënshtruar hapave të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit, sipas rrethanave, nga personi që zotëron në mënyrë të ligjshme informacionin për të mbajtur sekretin të fshehtë.

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, me informacion dhe hapa të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit do të kuptojmë:

a) informacioni i referuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni përfshin, ndër të tjera, njohuritë teknike, informacionet për shoqërinë tregtare dhe informacionet teknologjike;

b) informacioni i referuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni ka vlerë tregtare, ndër të tjera, në ato raste kur përvetësimi, përdorimi ose bërja publike e paligjshme e sekretit tregtar ka mundësi të dëmtojë interesat e personit që kontrollon në mënyrë të ligjshme këtë sekret tregtar, duke cenuar potencialin e tij shkencor dhe teknik, interesat financiare të shoqërisë tregtare, pozicionet strategjike ose mundësinë për të konkurruar;

c) hapat e arsyeshëm të referuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni mund të përfshijnë përgatitjen e një akti të brendshëm për administrimin e një sekretit tregtar dhe grupin përkatës të personave, që është përgjegjës për administrimin e tij apo masat për mbrojtjen fizike ose virtuale në aksesin e administrimin e sekretit tregtar.

3. “Mbajtës i sekretit tregtar” është çdo person fizik ose juridik që zotëron në mënyrë të ligjshme një sekret tregtar.

4. “Shkelës” është çdo person fizik ose juridik që ka përvetësuar, përdorur ose ka bërë publik në mënyrë të kundërligjshme një sekret tregtar.

5. “Mallra në shkelje” janë mallrat, disenjimi, karakteristikat, funksionimi, procesi i prodhimit ose tregtimi i të cilave sjell në mënyrë të dukshme përfitime nga sekretet tregtare e të përvetësuara, të përdorura ose të bëra publike në mënyrë paligjshme.

“Neni 111/b

Objekti i mbrojtjes dhe fusha e zbatimit të sekretit tregtar

1. Objekt i pjesës II/a të këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar.

2. Rregullat e përcaktuara në pjesën II/a të këtij ligji kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar nuk cenojnë:

a) ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit, duke përfshirë respektimin e lirisë dhe të pluralizmit të medias, sipas legjislacionit në fuqi;

b) zbatimin e rregullave që u kërkojnë mbajtësve të sekretit tregtar që të bëjnë publike, për arsye të interesit publik, informacione, përfshirë sekretet tregtare, për publikun ose autoritetet administrative apo gjyqësore gjatë kryerjes së detyrave të tyre;

c) zbatimin e rregullave që u kërkojnë ose u lejojnë institucioneve dhe organeve apo autoriteteve publike kombëtare të bëjnë publik informacionin e paraqitur nga shoqëritë tregtare, të cilin këto institucione, organe ose autoritete publike kombëtare mbajnë në përputhje me të drejtat e detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

3. Asnjë dispozitë e pjesës II/a të këtij ligji nuk përbën arsye për kufizimin e lëvizjes së lirë të punonjësve. Në mënyrë të posaçme, në lidhje me ushtrimin e së drejtës për lëvizjen e lirë të punonjësve, pjesa II/a e këtij ligji nuk paraqet asnjë arsye për:

a) kufizimin e përdorimit të informacionit nga punonjësit, i cili nuk përbën sekret tregtar sipas pikës 1 të nenit 111/a;

b) kufizimin e përdorimit të eksperiencës dhe të njohurive teknike të përfutuara në mënyrë të ndershme nga punonjësit gjatë veprimtarisë së zakonshme të punësimit të tyre;



c) vendosjen e ndonjë kufizimi shtesë ndaj punonjësve në kontratat e tyre të punës, përveç kufizimeve të vendosura në përputhje me ligjin.

Neni 111/c

Përvetësimi, përdorimi dhe bërja publike në mënyrë të ligjshme e sekretit tregtar

1. Përvetësimi i sekretit tregtar do të konsiderohet i ligjshëm në rast se sekreti tregtar është siguruar në njërin prej mënyrave të mëposhtme:

a) një zbulim ose krijim i pavarur;

b) vëzhgimi, studimi, çmontimi ose testimi i një produkti ose objekti që është bërë i disponueshëm për publikun ose që është në mënyrë të ligjshme në posedimin e përfituesit të informacionit, i cili është i lirë nga çdo detyrim ligjor i vlefshëm që vendos kufizime për përvetësimin e sekretit tregtar;

c) ushtrimi i së drejtës së punonjësve ose i përfaqësuesve të punonjësve për informim, këshillim dhe pjesëmarrje në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) çdo praktikë tjetër, e cila, sipas rrethanave, është në përputhje me praktikën e ndershme tregtare.

2. Përvetësimi, përdorimi ose bërja publike e sekretit tregtar konsiderohen të ligjshme deri në atë masë që ky përvetësim, përdorim ose bërje publike e sekretit tregtar kërkohet ose lejohet nga ligje të tjera të posaçme.

Neni 111/ç

Përvetësimi, përdorimi dhe bërja publike në mënyrë të paligjshme e sekretit tregtar

1. Mbajtësi i sekretit tregtar ka të drejtë të kërkojë zbatimin e masave, të procedurave dhe të mjeteve mbrojtëse të parashikuara në këtë ligj, me qëllim parandalimin ose shpërblimin e dëmit në rastin e përvetësimit, përdorimit ose bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar.

2. Përvetësimi i sekretit tregtar pa miratimin e mbajtësit të sekretit tregtar do të konsiderohet i paligjshëm në çdo rast që ai kryhet nëpërmjet:

a) aksesit të paautorizuar, përvetësimit ose kopjimit të çdo dokumenti, objekti, materiali, substance ose dosjeje elektronike që ndodhet në mënyrë të ligjshme në zotërim të mbajtësit të

sekretit tregtar dhe përmban sekretin tregtar ose prej nga mund të nxirret sekreti tregtar;

b) çdo lloj sjelljeje tjetër që sipas rrethanave do të konsiderohet në kundërshtim me praktikën e ndershme tregtare.

3. Përdorimi ose bërja publike e sekretit tregtar do të konsiderohet e paligjshme në të gjitha ato raste që kryhet pa miratimin e mbajtësit të sekretit tregtar nga një person, i cili rezulton se plotëson një nga kushtet e mëposhtme:

a) ka përvetësuar në mënyrë të paligjshme sekretin tregtar sipas pikës 2 të këtij neni;

b) është në shkelje të marrëveshjes së konfidencialitetit ose të çdo detyrimi tjetër për të mos bërë publik sekretin tregtar;

c) është në shkelje të një detyrimi kontraktual ose çdo detyrimi tjetër që përcakton kufizimin për përdorimin e sekretit tregtar.

4. Përvetësimi, përdorimi ose bërja publike e sekretit tregtar do të konsiderohen gjithashtu të paligjshme në çdo rast që një person në kohën e përvetësimit, përdorimit ose bërjes publike të sekretit tregtar ishte në dijeni ose, sipas rrethanave, duhet të ishte në dijeni të faktit që sekretin tregtar është përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte nga një person tjetër, i cili ishte duke përdorur apo duke bërë publik sekretin tregtar në mënyrë të paligjshme, sipas kuptimit të pikës 3 të këtij neni.

5. Prodhimi, ofrimi, vendosja në treg e mallrave në shkelje ose importimi, eksportimi ose magazinimi i mallrave në shkelje për këto qëllime konsiderohen gjithashtu një përdorim i paligjshëm i sekretit tregtar, kur personi që kryen veprimtarinë të tilla e dinte ose, sipas rrethanave, duhet të ishte në dijeni që sekretin tregtar ishte përdorur në mënyrë të paligjshme, sipas kuptimit të pikës 3 të këtij neni.

Neni 111/d

Përfshirjet nga zbatimi i masave, i procedurave dhe i mjeteve juridike për mbrojtjen e sekretit tregtar

Kërkesa për zbatimin e masave, të procedurave dhe të mjeteve juridike të parashikuara në këtë ligj refuzohet kur përvetësimi, përdorimi ose bërja publike e supozuar e sekretit tregtar kryhet në njërin prej rasteve të mëposhtme:

a) për ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit, siç përcaktohet në nenin 111/b të



këtij ligji, përfshirë respektimin e lirisë dhe pluralizmin e medias sipas legjislacionit në fuqi;

b) për zbulimin e një sjelljeje joprofesionale, shkeljeje ose veprimtarie të paligjshme, me kusht që i padituri të ketë vepruar me qëllimin e mbrojtjes së interesit të përgjithshëm publik;

c) bërja publike e sekretit tregtar nga punonjësit në favor të përfaqësuesve të tyre në kuadër të ushtrimit të ligjshëm të funksioneve të përfaqësuesve, në përputhje me legjislacion në fuqi, me kusht që bërja publike e sekretit tregtar të jetë e nevojshme për ushtrimin e këtyre funksioneve;

ç) për qëllim të mbrojtjes së një interesi të ligjshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 111/dh

Parashikime të përgjithshme

Në këtë ligj përcaktohen masat, procedurat e mjetet juridike, që zbatohen për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të sekretit tregtar dhe mundësinë e kompensimit civil kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar.

Neni 111/e

Veprimet që përbëjnë shkelje të të drejtave të sekretit tregtar dhe abuzimi me të drejtën për të ngritur padi

1. Veprimet e kryera nga çdo person lidhur me përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar, sipas pikës 111/ç të këtij ligji, përbëjnë shkelje të të drejtave të sekretit tregtar.

2. E drejta për të ngritur padi në gjykatë për shkelje të të drejtave të sekretit tregtar, sipas këtij ligji, i përket mbajtësit të sekretit tregtar.

3. Gjykata kompetente për gjykimin e çështjeve dhe të mosmarrëveshjeve të lidhura me sekretin tregtar është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Me kërkesë të të paditurit, gjykata mund të marrë masa dhe të vendosë dënimin e paditësit që abuzon me të drejtën për të ngritur padi në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile. Konsiderohet se paditësi abuzon me të drejtën për të ngritur padi kur padia e paraqitur prej tij lidhur me përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar është haptazi e pambështetur dhe është konstatuar

se paditësi ka filluar procedurat ligjore në mënyrë abuzive ose në keqbesim.

5. Sipas rastit, masa të tilla mund të përfshijnë dënimin me gjobë të paditësit deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, shpërblimin e dëmit ndaj të paditurit dhe detyrimin për publikimin e vendimit gjyqësor në përputhje me nenin 111/k të ligjit.

Neni 111/ë

Afati për ngritjen e padisë

Padia kundër përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar depozitohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 3 (tre) vjetëve nga data kur paditësi merr dijeni për shkeljen e shkelësin.

Neni 111/f

Ruajtja e konfidencialitetit të sekretit tregtar gjatë procesit gjyqësor

1. Palët, avokatët e tyre ose përfaqësuesit e tjerë, personeli gjyqësor, dëshmitarët, ekspertët dhe çdo person tjetër që merr pjesë në procese gjyqësore, që lidhen me përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar, ose që kanë akses në dokumente, të cilat janë pjesë e këtyre proceseve gjyqësore, nuk duhet të përdorin ose të bëjnë publik sekretin tregtar apo sekretin tregtar të supozuar, të cilin gjykata, në përgjigje të një kërkesë të arsyetuar nga një palë e interesuar, e ka identifikuar si informacion konfidencial dhe për të cilin ka marrë dijeni si rezultat i pjesëmarrjes ose i aksesit në të.

2. Masa për ruajtjen e konfidencialitetit të sekretit tregtar mund të merret nga gjykata edhe me vetë iniciativën e saj.

3. Detyrimi i referuar në pikën 1 të këtij neni do të mbetet në fuqi edhe pas përfundimit të procesit gjyqësor.

Pavarësisht për sa më sipër, ky detyrim pushon së ekzistuari në njërin prej rasteve të mëposhtme:

a) kur sekreti tregtar i supozuar ka rezultuar me një vendim të formës së prerë se nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 111/a; ose

b) kur me kalimin e kohës, informacioni në fjalë bëhet gjerësisht i njohur ose lehtësisht i aksesueshëm për personat që përgjithësisht merren me llojin e informacionit në fjalë.



4. Gjykata, bazuar në një kërkesë të arsyetuar nga secila prej palëve, mund të marrë masa specifike për të ruajtur konfidencialitetin e sekretit tregtar ose të sekretit tregtar të supozuar që është përdorur ose referuar gjatë proceseve gjyqësore që lidhen me përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar.

5. Masat specifike të referuara në pikën 2 të këtij neni, mund të merren edhe me iniciativë të vetë gjykatës, duke përfshirë secilën prej mundësive të mëposhtme:

a) kufizimin e aksesit mbi çdo dokument që përmban sekrete tregtare ose sekrete tregtare të supozuara nga palët ose palë të treta, tërësisht ose pjesërisht, për një numër të kufizuar personash;

b) kufizimin e aksesit në seanca dëgjimore, ku sekretet tregtare ose sekretet tregtare të supozuara mund të bëhen publike, dhe kufizimin e regjistrimeve ose të transkriptimeve përkatëse të këtyre seancave dëgjimore për një numër të kufizuar personash;

c) vënien në dispozicion për çdo person të interesuar, i cili nuk përfshihet në numrin e kufizuar të personave të referuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, të një versioni jokonfidencial të vendimit për çdo vendim gjyqësor, në të cilin pjesët që përmbajnë sekrete tregtare janë hequr ose redaktuar.

6. Numri i personave i referuar në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 5 të këtij neni, nuk duhet të jetë më i madh se sa është e nevojshme, për të garantuar përputhshmërinë me të drejtën e palëve për të pasur mjete juridike të efektshme dhe të drejtën e palëve për një proces të rregullt gjyqësor, dhe ky numër do të përfshijë të paktën një person fizik nga secila palë dhe avokatët përkatës ose përfaqësuesit e tjerë të këtyre palëve në proces gjyqësor.

7. Kur vendos për masat e përmendura në pikën 2 të këtij neni dhe vlerëson proporcionalitetin e tyre, gjykata merr parasysh nevojën për të siguruar të drejtën e palëve për të pasur mjete juridike të efektshme dhe të drejtën e tyre për një proces të rregullt gjyqësor, interesat legjitime të palëve dhe, kur është e përshtatshme, interesat legjitime të palëve të treta, si dhe çdo dëm të mundshëm që pranimi ose refuzimi i këtyre masave ka shkakuar për secilën palë dhe kur është e përshtatshme për palët e treta.

8. Përpunimi i të dhënave personale në përputhje me pikat e mësipërme të këtij neni, do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 111/g

Masat e përkohshme

1. Gjykata, me kërkesën e mbajtësit të sekretit tregtar, urdhëron vendosjen e masave të përkohshme, me qëllimin e përfundimit ose të ndërprerjes së veprimeve të përvetësimit, përdorimit ose të bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar, duke përfshirë ndër të tjera:

a) ndalimin e prodhimit, ofrimit, hedhjes në treg ose përdorimit të mallrave cenuese, si dhe ndalimin e importimit, të eksportimit apo të ruajtjes së mallrave cenuese për këto qëllime;

b) konfiskimin ose vënien nën kontroll të mallrave të dyshuara si cenuese deri në përfundim të procesit gjyqësor, duke përfshirë mallrat e importuara, në mënyrë që të ndalohej hyrja ose qarkullimi i tyre në treg;

c) ndalimin e ofrimit ose të sigurimit të shërbimeve që përdorin sekretin tregtar;

ç) ruajtjen e provave të rëndësishme për shkeljen e pretenduar, me kusht që të mbrohet informacioni konfidencial;

d) konfiskimin ose vënien nën kontroll të mjeteve të përdorura për prodhimin e mallrave të dyshuara si cenuese deri në përfundim të procesit gjyqësor;

dh) urdhëron, në rastin e një shkeljeje të kryer në shkallë tregtare dhe, nëse pala e dëmtuar demonstroi rrethana të tilla, që mund të rrezikojnë riparimin e dëmeve, bllokimin e përkohshëm të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të shkelësit të pretenduar, përfshirë edhe bllokimin e llogarive të tij bankare dhe të aseteve të tjera. Për këtë qëllim gjykata mund të urdhërojë paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose tregtare, ose shfrytëzimin e mundësive të tjera të përshtatshme për të zotëruar informacionin përkatës.

2. Gjykata vendos për marrjen e masave të përkohshme pa dëgjuar palën tjetër, veçanërisht kur vonesa mund t'i shkaktojë dëme të pariparueshme mbajtësit të sekretit tregtar ose kur provat mund të shkatërrohen.



Pala, kundër së cilës është vendosur masa, njoftohet menjëherë për masat e marra, por jo më vonë se menjëherë pas ekzekutimit të tyre.

Rishikimi, përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar, bëhet me kërkesë të palës kundër së cilës është vendosur masa, për të vendosur brenda një kohe të arsyeshme pas njoftimit të marrjes së masave nëse këto masa duhet të ndryshohen, të revokohen ose të konfirmohen.

3. Kur vendos për marrjen e masave të përkohshme, gjykata cakton një afat, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, brenda të cilit personi që ka kërkuar këto masa duhet të ngrejë padi në gjykatë për shkelje të të drejtave të sekretit tregtar.

4. Masat e përkohshme, duke përfshirë masat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, mund të jepen kundër shkelësit të pretenduar të sekretit tregtar, si dhe në kushte të njëjta kundër ndërmjetësit, shërbimet e të cilit janë përdorur nga pala e tretë për të cenuar këtë të drejtë.

Neni 111/gj

Kushtet dhe kriteret për marrjen e masave të përkohshme

1. Gjkata, lidhur me masat e përmendura në nenin 111/g, ka të drejtë t'i kërkojë paditësit që të paraqesë prova se:

- a) sekreti tregtar ekziston;
- b) paditësi është mbajtës i sekretit tregtar;
“d) shteti kërkues jep garanci që nuk do të japë një dënim më të rëndë sesa dënimi me të cilin ai është dënuar, apo dënim me vdekje ose, nëse e ka dhënë një dënim të tillë, nuk do ta ekzekutojë atë.”.

Neni 13

Në nenin 36, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Me kërkesë të Prokurorisë së Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë kryen përkthimin e akteve të kërkuara brenda 24 orëve. Komunikimet ndërmjet institucioneve të përfshira mund të kryhen edhe në rrugë elektronike.”.

Neni 14

Në nenin 38 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Zyra Qendrore Kombëtare e Interpolit, me marrjen e një urdhri ndërkombëtar arresti nga një shtet i huaj për një shtetas shqiptar, në të cilin deklarohet qëllimi i shtetit kërkues për ekstradim, ia përcjell sa më parë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Njëkohësisht, Zyra Qendrore Kombëtare e Interpolit, përmes strukturave të Policisë së Shtetit, fillon verifikimet për identifikimin e saktë të gjeneraliteteve dhe vendndodhjes së tij. Verifikimet e kryera i dërgohen Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë.”.

2. Në pikën 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjalja e parë ndryshohet si më poshtë:

“4. Prokurori i Përgjithshëm pas marrjes së urdhrit ndërkombëtar të arrestit.”.

b) Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) administron dhe vlerëson verifikimet e kryera nga Policia e Shtetit ose Zyra Qendrore Kombëtare e Interpolit për identitetin, vendndodhjen dhe shtetësinë e personit që kërkohet.”.

3. Pikat 2, 3, 7, 8 dhe 9, si dhe shkronja “b” e pikës 4 shfuqizohen.

Neni 15

Në nenin 39, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Vendimi gjyqësor i dhënë sipas këtij neni depozitohet në sekretarinë gjyqësore brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij. Me marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor, sekretaria gjyqësore njofton menjëherë prokurorinë kompetente me juridiksion të përgjithshëm dhe Prokurorinë e Përgjithshme.”.



Neni 16

Në nenin 42, pika 1, shkronjat “c” dhe “ç” shfuqizohen.

Neni 17

Në nenin 48, pikat 3, 4 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:

“3. Urdhri i kërimit ndërkombëtar hartohet në gjuhën shqipe dhe përmban:

a) emrin e prokurorit që ka lëshuar urdhrin e kërimit;

b) gjeneralitetet e personit që kërkohet dhe çdo të dhënë tjetër të vlefshme për identifikimin e tij;

c) gjykatën dhe të dhëna për vendimin gjyqësor që ka caktuar masën e sigurimit ose ka dhënë vendimin penal të dënimit;

ç) informacion për masën e sigurimit dhe maksimumin e dënimit me burgim, që parashikohet për veprën penale përkatëse, ose pjesën e mbetur të masës së dënimit të dhënë me vendim gjyqësor të formës së prerë.

4. Prokurori pranë prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm ose prokurori pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nëpërmjet drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ia dërgon menjëherë urdhrin e kërimit ndërkombëtar Zyres Qendrore Kombëtare të Interpolit, e cila kryen menjëherë përkthimin në gjuhën angleze ose në një nga gjuhët e tjera zyrtare të Interpolit.

5. Prokurori i Përgjithshëm, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe ministri i Brendshëm, me udhëzim të përbashkët, përcaktojnë procedurat e nxjerrjes së urdhrin të kërimit ndërkombëtar, si dhe rregulla të detajuara për afatet e mënyrat e shkëmbimit të informacionit për nxjerrjen dhe komunikimin e tij.”.

Neni 18

Në nenin 49, në pikën 1, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “ose drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme”.

Neni 19

Në nenin 57, pikat 5 dhe 6 ndryshohen si më poshtë:

“5. Vendimi mund të ankimohet në një gjykatë të një niveli më të lartë nga prokurori, i dënuari ose mbrojtësi i tij brenda 10 ditëve nga shpallja ose njoftimi i tij.

6. Me marrjen formë të prerë të vendimit për njohjen e vendimit penal të huaj, sekretaria gjyqësore e gjykatës njofton menjëherë prokurorinë kompetente me juridiksion të përgjithshëm dhe Prokurorinë e Përgjithshme.”.

Neni 20

Pas nenit 59 shtohet neni 59/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 59/1

Marrëveshja për dorëzim ose ndarje të pasurisë së konfiskuar

1. Dorëzimi ose ndarja e pasurisë së konfiskuar kryhet nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe për dorëzimin e pasurisë së konfiskuar mes shtetit kërkues dhe shtetit të kërkuar në zbatim të vendimit të gjykatës së huaj, të njohur dhe të ekzekutueshëm sipas legjislacionit në fuqi për njohjen e vendimeve penale të huaja.

2. Marrëveshja për dorëzimin ose ndarjen e pasurisë së konfiskuar lidhet ndërmjet autoritetit kompetent të shtetit të huaj dhe autoritetit kompetent shtetëror në Republikën e Shqipërisë për administrimin e pasurive të konfiskuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara dhe legjislacionin në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare. Marrëveshja për dorëzimin ose ndarjen e pasurisë së sekuestruar mund të lidhet vetëm me autoritetet e atyre shteteve, të cilat, në të njëjtat rrethana, do të vendosnin dorëzimin ose ndarjen e pasurisë me shtetin shqiptar.

3. Marrëveshja për dorëzimin ose ndarjen e pasurisë së konfiskuar ndërmjet autoritetit kompetent të shtetit të huaj dhe autoritetit kompetent shtetëror në Republikën e Shqipërisë, si rregull, duhet të reflektojë një ndarje proporcionale të pasurisë së konfiskuar në përputhje me vendin



ku është kryer vepra penale që ka prodhuar të ardhura, si edhe rolin e punën hetimore të secilit vend, përveç rasteve kur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara parashikojnë ndryshe.”.

Neni 21

Në nenin 69, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Organi që ka disponuar mbi transferimin e procedimit penal sipas pikës 1 të nenit 68 të këtij ligji, i përcjell Ministrisë së Drejtësisë vendimin e transferimit së bashku me fashikullin.

2. Ministria e Drejtësisë, brenda 30 ditëve nga marrja e akteve prej organit që ka disponuar mbi transferimin e procedimit penal, ia përcjell ato shtetit të kërkuar dhe i kërkon të njoftohet për pranimin ose jo të transferimit të procedimit penal.”.

Neni 22

Pas kreut V, shtohet kreu V/1 me këtë përmbajtje:

“KREU V/1 SKUADRAT E PËRBASHKËTA HETIMORE

Neni 75/1

E drejta për të kërkuar krijimin e skuadrës së përbashkët hetimore

1. Me propozim të prokurorit, drejtuesi i prokurorisë përkatëse nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm ose drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të kërkojnë krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore në rastet kur:

a) hetimet për një vepër penale kërkojnë kryerjen e veprimeve veçanërisht komplekse ose të vështira dhe që kanë lidhje edhe me një shtet tjetër; ose

b) një ose disa shtete të tjera janë duke kryer hetime për vepra penale për të cilat rrethanat e çështjes kërkojnë kryerjen e veprimeve hetimore të bashkërenduara ose të përbashkëta në të gjitha vendet e tjera.

2. Drejtuesi i prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm, nëpërmjet Prokurorit të

Përgjithshëm, ose, kur është rasti, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ua përcjell kërkesën për krijimin e skuadrës së përbashkët hetimore autoriteteve të huaja nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.

3. Kërkesa për krijimin e skuadrës së përbashkët hetimore, përveç informacioneve të përcaktuara në nenin 14 të Konventës së Këshillit të Evropës për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale, duhet të përmbajë edhe propozimin për përbërjen e skuadrës hetimore, si dhe kohëzgjatjen e saj.

Neni 75/2

Kërkesa e një autoriteti të huaj për krijimin e skuadrës së përbashkët hetimore

1. Ministria e Drejtësisë vendos që t'i jepet rrugë kërkesës së një autoriteti të huaj për krijimin e skuadrës së përbashkët hetimore, përveçse kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sovranitetin, sigurimin ose interesa të rëndësishme të shtetit. Në rastet kur autoriteti i huaj i drejtohet drejtpërdrejt Prokurorit të Përgjithshëm ose kur është rasti drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, këta njoftojnë pa vonesë ministrin e Drejtësisë.

2. Ministria e Drejtësisë nuk i jep rrugë kërkesës kur del e qartë se veprimet e kërkuara janë të ndaluara shprehimisht nga ligji ose kur vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Në këtë rast ministria njofton pa vonesë autoritetin e huaj.

3. Ministria e Drejtësisë, pas dhënies rrugë, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm ia përcjell kërkesën drejtuesit të prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm në kompetencën tokësore të të cilit është hetimi i veprës penale për të cilën kërkohet ngritja e skuadrës hetimore, ose kur është rasti drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 75/3

Marrëveshja për krijimin e skuadrës së përbashkët hetimore

1. Krijimi i skuadrës së përbashkët hetimore bëhet me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet drejtuesit të prokurorisë përkatëse, si dhe autoritetit ose autoriteteve kompetente të huaja.

2. Marrëveshja duhet të përmbajë:

a) përbërjen e skuadrës hetimore, përkatësisht përfaqësuesit e prokurorisë, si dhe anëtarët e



caktuar nga autoriteti kompetent i huaj. Përfaqësuesit e prokurorisë mund të jenë prokurorë, oficerë të Policisë Gjyqësore, hetues ose punonjës të tjerë të Policisë së Shtetit. Anëtarët e autoritetit kompetent të huaj caktohen në përputhje me rregullat e shtetit ose shteteve të origjinës;

b) drejtuesin e skuadrës hetimore, i cili zgjidhet një ndër anëtarët e saj. Në rastin kur pjesë e skuadrës është një ose disa prokurorë, drejtuesi i skuadrës zgjidhet ndërmjet tyre;

c) objektin dhe qëllimin e skuadrës së përbashkët hetimore;

ç) afatin brenda të cilit duhen përmbyllur veprimet hetimore.

3. Marrëveshjes i bashkëlidhet edhe plani i veprimeve hetimore, i cili përmban edhe masat organizative, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

4. Kur është e nevojshme për kryerjen e veprimeve hetimore, drejtuesi i prokurorisë përkatëse, si dhe autoriteti kompetent i huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen, sipas pikës 1 të këtij neni, me marrëveshje me shkrim mund të ndryshojnë objektin dhe qëllimin e skuadrës së përbashkët hetimore, si dhe mund të zgjasin afatin brenda të cilit duhen përmbyllur veprimet hetimore. Kur këto raste i përkasin juridiksionit të përgjithshëm, drejtuesi i prokurorisë përkatëse njofton Prokurorin e Përgjithshëm, i cili njofton Ministrinë e Drejtësisë, ndërsa, kur i përkasin juridiksionit të posaçëm, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton Ministrinë e Drejtësisë.

5. Kur ekzistojnë shkaqe të përligjura, palët, sipas rregullave të caktuara në pikën 4, mund të ndryshojnë edhe përbërjen e skuadrës së përbashkët hetimore nëpërmjet zëvendësimit të një ose disa anëtarëve, ose shtimit të anëtarëve të rinj.

6. Veprimtaria e skuadrës së përbashkët hetimore, që ushtron veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në çdo rast, sipas parashikimeve të nenit 304 të Kodit të Procedurës Penale, drejtohet nga prokurori.

Neni 75/4

Përgjegjësia penale e anëtarëve të autoritetit kompetent të huaj

1. Anëtarët e autoritetit kompetent të huaj të një skuadre të përbashkët hetimore, që ushtron veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kuptim të përgjegjësisë së tyre

penale, marrin cilësimin e personit që ushtron funksione publike dhe i ushtron këto funksione në përmbushje të detyrave dhe veprimeve procedurale që i janë caktuar me cilësinë e agjentit të Policisë Gjyqësore.

2. Prokurori, me vendim të arsyetuar, mund të disponojë që anëtarët e autoritetit kompetent të huaj të mos marrin pjesë në kryerjen e veprimeve hetimore të caktuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 75/5

Përdorimi i provave të marra

1. Skuadra e përbashkët hetimore e ushtron veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi.

2. Në fashikullin e dosjes së gjykimit, sipas përcaktimit të nenit 332/ë të Kodit të Procedurës Penale, bëjnë pjesë edhe procesverbalet e veprimeve të papërsëritshme të kryera nga skuadra e përbashkët hetimore.

3. Në përputhje me parashikimet e këtij kreu, veprimet hetimore të kryera nga skuadra e përbashkët hetimore jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kanë të njëjtën vlerë provuese si edhe veprimet hetimore të njëjta të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të përdoren në shqyrtimin gjyqësor në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar.

4. Çdo informacion që është marrë në mënyrë të ligjshme nga anëtarët e skuadrës hetimore dhe që nuk mund të vihet në dispozicion të autoritetit kompetent të huaj në ndonjë formë tjetër, mund të përdoret në rastet e mëposhtme:

a) për të përmbushur qëllimin për të cilin është ngritur skuadra e përbashkët hetimore;

b) me pëlqimin paraprak të shtetit në të cilin është marrë informacioni për zbulimin, hetimin dhe procedimin e veprave të tjera penale. Pëlqimi i shtetit mund të mos jepet vetëm në rastet kur përdorimi i këtij informacioni do të dëmtonte hetimet në këtë vend, ose kur në një rast të ngjashëm ky vend do t'i jepte rrugë letërporosisë;

c) për të parandaluar një rrezik të menjëhershëm dhe serioz për rendin publik dhe, përveç sa është parashikuar në shkronjën “b” të kësaj pike, në rast se fillon ndjekja penale;



ç) për çdo qëllim tjetër që shtetet që kanë krijuar skuadrën e përbashkët hetimore kanë rënë dakord.

5. Drejtuesi i prokurorisë që ka lidhur marrëveshjen për krijimin e skuadrës së përbashkët hetimore mund t'i kërkojë autoritetit kompetent të huaj që për shkak të nevojave të hetimit ose të gjykimet, të ndryshme nga ato që janë përcaktuar në marrëveshjen për krijimin e skuadrës së përbashkët hetimore, të vonojë përdorimin e informacionit që është marrë nga anëtarët e skuadrës hetimore dhe që nuk mund të vihet në dispozicion në ndonjë formë tjetër, në rast se ky lloj informacioni mund të dëmtojë hetime ose procedime penale që po kryhen në vend, për një kohë prej jo më shumë se 6 muaj.

6. Prokurori, jo më gjatë se afati i caktuar në pikën 5 të këtij neni, kujdeset për të zbatuar kushtet e caktuara nga autoritetet kompetente të huaja, për përdorimin e informacionit, sipas të njëjtave kushte të përcaktuara në paragrafin e mësipërm.

Neni 75/6

Përgjegjësia civile e shtetit për dëmet e shkaktuara nga skuadra e përbashkët hetimore

1. Shteti shqiptar është përgjegjës për shpërblimin e çdo dëmi që shkaktohet nga përfaqësuesit e prokurorisë për shkak të ushtrimit të funksionit si pjesë e skuadrës së përbashkët hetimore në territorin e shtetit tjetër, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të shtetit tjetër.

2. Në rast se shteti tjetër në të cilin është shkaktuar dëmi sipas parashikimit të pikës 1 të këtij neni, shpërblen dëmin e shkaktuar me të njëjtat kushte sikur të ishte shkaktuar nga anëtarët e skuadrës së përbashkët hetimore të caktuar nga autoriteti i tij kompetent, shteti shqiptar është i detyruar t'i shpërblejë shtetit tjetër shumën e plotë të dëmshpërblimit që ka paguar për palën e dëmtuar dhe çdo person tjetër që ka të drejtë të përfitojë një dëmshpërblim.

3. Shteti shqiptar shpërblen dëmin e shkaktuar palëve të treta në territorin e Republikës së Shqipërisë nga anëtarët e skuadrës së përbashkët hetimore, por në çdo rast ka të drejtë të kërkojë pagimin e çdo shume nga shteti që përfaqëson anëtarin e skuadrës së përbashkët hetimore që ka shkaktuar dëmin.”.

Neni 23

Dispozita të fundit

Parashikimet e bëra në nenin 22 të këtij ligji nuk zbatohen për marrëveshjet në fuqi për krijimin ose veprimtarinë e skuadrave të përbashkëta hetimore të lidhura nga Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Krimeve të Rënda ose Prokuroria e Posaçme përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 24

Aktet nënligjore

1. Ngarkohen ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme që brenda 6 muajve nga miratimi i këtij ligji të miratojnë rregullat e përcaktuara në nenin 4, pika 2, të ligjit.

2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme që brenda 6 muajve nga miratimi i këtij ligji, të miratojnë rregullat në zbatim të nenit 17 të ligjit.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga miratimi i këtij ligji, të miratojnë rregullat e përcaktuara në nenin 10, pika 5, të ligjit.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 7.7.2021.

VENDIM

Nr. 485, datë 30.7.2021

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË FAZËS SË PARË “KONTRATË PËR SHËRBIME TEKNIKE - PROJEKTI HIDROENERGJETIK I SKAVICËS” NDËRMJET KESH SHA DHE BECHTEL LIMITED

Në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 38/2021, “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë “Bechtel



International INC.”, për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së fazës së parë “Kontratë për shërbime teknike - projekti hidroenergetik i Skavicës”, të negociuar e të nënshkruar ndërmjet autoritetit kontraktues Korporata Elektroenergetike Shqiptare sh.a. dhe shoqërisë *Bechtel Limited*, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet për mbulimin e kësaj kontrate përballohen nga fondet e Korporatës Elektroenergetike Shqiptare sh.a.

3. Ngarkohet Korporata Elektroenergetike Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

KONTRATË PËR SHËRBIME TEKNIKE PROJEKTI HIDROENERGETIK I SKAVICËS

KORPORATA ELEKTROENERGETIKE
SHQIPTARE SHA DHE
BECHTEL LIMITED – DEGA NË SHQIPËRI

Kjo Kontratë lidhet sot në datë _____
2021 nga dhe ndërmjet:

1. KORPORATA ELEKTROENERGETIKE SHQIPTARE SHA, një shoqëri aksionare shqiptare me pronësi publike, e themeluar dhe që vepron në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), me numër unik identifikimi të shoqërisë – NUIS J61817005F, e përfaqësuar rregullisht në këtë Kontratë nga z. Ergys Verdho në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm/administratorit (“**Klienti**”); dhe

2. *Bechtel Limited* e përfaqësuar përmes degës në Shqipëri, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit të Shqipërisë, me numër unik identifikimi të shoqërisë M11811033B, dhe me adresë të regjistruar: *Key Tower*, kati 5, suita 2, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar rregullisht në këtë Kontratë nga z. Andrew Patterson bazuar në prokurën e datës 9 qershor 2021 (“**Bechtel**”).

Në këtë Kontratë Klienti dhe *Bechtel* referohen individualisht si “**Pala**” dhe bashkërisht si “**Palët**”.

MEQENËSE:

A. Klienti është një shoqëri aksionare shqiptare me pronësi publike e themeluar sipas aktit të themelimit datë 17 tetor 1995, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, me vendimin nr. 12728, datë 6 nëntor 1995, e cila ka përgjegjësi për prodhimin, transformimin, shitjen dhe blerjen e çdo lloji të energjisë elektrike.

B. *Bechtel*-i është një shoqëri amerikane globale që projektin, ndërton dhe menaxhon projekte infrastrukture, e regjistruar sipas ligjeve të Shqipërisë. *Bechtel*-i dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit në datën 3 tetor 2020 për të bashkëpunuar për projektimin dhe ndërtimin e Projektit.

C. Klienti është autoritet kontraktues dhe dëshiron të emërojë *Bechtel*-in për të realizuar Projektin (siç përshkruhet në mënyrë më të detajuar në nenin 1).

D. Qeveria e Shqipërisë miratoi ligjin nr. 38/2021, datë 23 mars 2021, “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë ‘*Bechtel International INC.*’, për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës” (“ligji nr. 38/2021”).

E. *Bechtel*-i, duke shfrytëzuar kapacitetet, ekspertizën dhe përvojën e vet, është e gatshme të ndërmarrë Projektin, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.

PALËT BIEN DAKORD SI MË POSHTË

1. Përkufizimet dhe interpretimi

1.1 Secili nga termat e mëposhtëm ka kuptimin që i jepet më poshtë, përveçse kur i jepet shprehimisht një kuptim tjetër në këtë Kontratë.



Pagesa paradhënie	Është shuma prej tre milion euro (3 000 000,00 euro) që do të paguhet në përputhje me shtojcën 2.
Ndryshimi i ligjit	Është, në çdo moment pas datës së nënshkrimit: i. miratimi, vendosja, shpallja, hyrja në fuqi, modifikimi, ndryshimi ose shfuqizimi; i ii. një ndryshim në interpretimin ose zbatimin e; ose iii. çdo ndryshim në parametrat ose standardet teknike, në lidhje me një ligj, rregullore, rregull, normë, taksë ose tarifë të aplikueshme në Shqipëri, duke përfshirë me anë të një interpretimi zyrtar gjyqësor ose qeveritar, që prek <i>Bechtel</i> -in në realizimin e detyrimeve sipas kësaj Kontrate.
Autoriteti kompetent	Është parlamenti ose qeveria e Shqipërisë ose çdo ministër, ministri ose autoritet qendror apo vendor i Shqipërisë.
Miratime	Janë të gjitha pëlqimet, licencat, autorizimet, lejet dhe miratimet e autoritetit kompetent për realizimin e shërbimeve ose në lidhje me to.
Informacioni Konfidencial	Është informacioni i përfutur gjatë realizimit të shërbimeve, duke përfshirë produktin e punës, të cilin pala dhënëse e informacionit e cilëson si të tillë me shkrim. Kufizimet në përdorimin ose nxjerrjen e informacionit konfidencial nuk zbatohen për informacionin: i. që merret në mënyrë të ligjshme nga një burim tjetër pa kufizime apo detyrime konfidencialiteti ose u jepet këshilltarëve profesionistë; ii. që është ose bëhet i disponueshëm për publikun e gjerë pa shkelur këtë Kontratë; iii. që në momentin e dhënies, ka qenë i njohur për palën marrëse pa kufizime ose detyrime konfidencialiteti, siç dëshmohet nga dokumentacioni që pala marrëse disponon; iv. në lidhje me të cilin, pala dhënëse e informacionit njofton palën marrëse me shkrim, se për këtë informacion nuk ka kufizime apo detyrime për ruajtjen e konfidencialitetit; ose v. që duhet t'i jepet një personi të veçantë në bazë të ligjit të zbatueshëm.
Palë e tretë	Është çdo person i përfshirë në ofrimin e shërbimit të projektimit, të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social ose të shërbimeve të tjera, sipas shtojcës 1, aneksi 1, “Menaxhimi i të tretëve”.
Shërbimet e menaxhimit të të tretëve	Janë shërbimet që do të menaxhohen nga <i>Bechtel</i> -i, të përcaktuara specifikisht në shtojcën 1 aneksi 1 “Menaxhimi i të tretëve” dhe çdo shërbim tjetër i dakordësuar mes Palëve me shkrim herë pas here.
Tarifa e menaxhimit të të tretëve	Është tarifa që i paguhet <i>Bechtel</i> -it për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të të tretëve në përputhje me shtojcën 2.
Dokumentet	Janë llogaritjet, grafikët, programet kompjuterike dhe softuerë të tjerë, informacioni për projektin, skicat, listat, manualët, metodat, modelet, procedurat, raportet, specifikimet dhe sistemet e përdorura në nenin 8.
Data efektive	Është data më e vonë midis: i. datës në të cilën kjo Kontratë hyn në fuqi dhe zbatim pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave i Shqipërisë dhe pas publikimit në Fletoren Zyrtare; dhe ii. datës kur <i>Bechtel</i> -i merr pagesën në përputhje me nenin 2.1 të shtojcës 2.
Shumat e preventuara për etapën	Janë vlerat treguese të parashikuara, pa TVSH, për çdo etapë të përshkruar në shtojcën 2, të cilat të marra së bashku përbëjnë totalin e kostove, i cili nuk do të ndryshojë, përveçse me marrëveshje të përbashkët mes Palëve, në përputhje me nenin 5.2.
Totali i kostos	Është buxheti i caktuar, pa TVSH, për Shërbimet e përcaktuara në shtojcën 1, i cili nuk do të tejkalohet, përveçse me miratimin e Këshillit të Ministrave, në përputhje me nenin 5.2.
Forca madhore	Ka kuptimin që i jepet në nenin 7.
Grupi	Është <i>Bechtel</i> -i, filialet e <i>Bechtel</i> -it dhe drejtorët, nëpunësit e lartë dhe punëmarrësit e <i>Bechtel</i> -it dhe të filialeve të tij, si dhe pasardhësit ose cesionarët e tij.
Të drejtat e pronësisë intelektuale	Janë patentat, modelet utilitare, të drejtat e shpikjes, të drejtat e autorit dhe të drejta të lidhura me to, markat tregtare, emrat tregtarë dhe emrat e domeneve, të drejtat e paraqitjes së produktit, emri i mirë dhe të drejtat për të ngritur padi për shkelje të markës tregtare, të drejtat e disenjës, të drejtat në softuerët kompjuterik, të drejtat e bazës së të dhënave, të drejtat e përdorimit dhe të mbrojtjes së konfidencialitetit të informacionit konfidencial, duke përfshirë <i>know-how</i> dhe të gjitha të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale, në çdo rast pavarësisht nëse janë të regjistruara apo të paregjistruara dhe duke përfshirë të gjitha aplikimet dhe të drejtat për të aplikuar dhe për të përfutur, rinovuar apo zgjatur të drejtat për të pretenduar përparësi nga këto të drejta dhe format e mbrojtjes të ngjashme ose të barasvlershme me to, që ekzistojnë ose do të ekzistojnë tani ose në të ardhmen në çdo pjesë të botës.
Etapë/at	Janë aktivitetet që do të realizohen të përshkruara më konkretisht në “Planin e pagesës së parashikuar” të etapave në shtojcën 2, e ndryshuar me marrëveshje të përbashkët mes Palëve .



Pandemi	Ka kuptimin që i jepet në nenin 6.2.
Projekti	Është shërbimi i detajuar dhe të gjitha studimet e lidhura me të, që do të ndërmerren nga <i>Bechtel-i</i> për llogari të Klientit për projektimin dhe ndërtimin e propozuar të projektit hidroenergjetik të Skavicës, të përshkruar më tej në shtojcën 1.
Programi i Projektit	Është programi i detajuar i aktiviteteve dhe etapave për kryerjen e shërbimeve të përgatitur dhe i dorëzuar nga <i>Bechtel-i</i> , për të cilin Klienti ka dhënë miratimin me shkrim, miratim i cili nuk duhet të mohohet apo të vonohet pa arsye.
Vendi i Projektit	Janë vendet e vendosura në dispozicion nga Klienti, në të cilat <i>Bechtel-i</i> kërkon akses për të kryer disa nga shërbimet e specifikuar në shtojcën 1 dhe çdo vend tjetër që mund të përcaktohet nga <i>Bechtel-i</i> dhe/ose nga Klienti.
Përfaqësuesit	Në lidhje me nenin 9, janë filialet e Palës marrëse dhe nëpunësit e lartë, drejtorët, punëmarrësit, agjentët, konsulentët dhe këshilltarët e tyre.
Data e nënshkrimit	Është data e lidhjes së kësaj Kontrate e shkruar në fillim të saj.
Shërbimet	Janë detyrat e përcaktuara në shtojcën 1 të kësaj Kontrate, me ndryshimet e tyre me marrëveshje të përbashkët mes Palëve, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
Produkti i punës	Është produkti i punës të krijuara specifikuara nga <i>Bechtel-i</i> (jo nga të tretët) dhe të përfunduara dhe dorëzuara te Klienti, në përputhje me shtojcën 1, të prodhuara me qëllimin për të ndihmuar Klientin gjatë vlerësimit të Projektit, të cilat nuk mund të nxirren te të tretët pa miratimin paraprak me shkrim të <i>Bechtel-it</i> dhe të cilat do të përmbajnë një deklaratë në lidhje me përdorimin dhe nxjerrjen e produktit të punës.

1.2 Gjuha rregulluese e kësaj Kontrate dhe gjuha e mbajtjes së komunikimit për këtë Kontratë është anglishtja.

1.3 Referencat në fjalët “përfshijnë”, “përfshin” ose “përfshirë” konsiderohen se ndiqen nga fjalët “pa kufizim”.

2. Objekti i shërbimeve

2.1 Përkundrejt pagesave që Klienti i bën *Bechtel-it*, të përcaktuara në këtë Kontratë, *Bechtel-i* realizon shërbimet në përputhje me Programin e Projektit të miratuar paraprakisht dhe ndihmon Klientin, në lidhje me emërimin dhe menaxhimin e të tretëve, në zbatim të kushteve të kësaj Kontrate.

2.2 *Bechtel-i* i kryen shërbimet, duke ushtruar atë shkallë kujdesi, aftësish dhe vigjilence që pritet normalisht nga një konsulent i kualifikuar dhe kompetent, me përvojë në realizimin e shërbimeve me natyrë të ngjashme me shërbimet. *Bechtel-i* konfirmon se do të respektojë të gjitha aktet ligjore, nënligjore dhe normative shqiptare, si dhe qëllimet e tyre të zbatueshme për shërbimet e *Bechtel-it*.

2.3 Pas përfundimit të çdo pjese apo porcioni të shërbimeve ose pas dorëzimit të Produktit të Punës, *Bechtel-i* njofton Klientin me shkrim për datën e përfundimit të asaj pjese apo porcioni dhe kërkon konfirmimin e tyre nga Klienti. Nëse Klienti nuk i kundërshton shërbimet duke i dhënë njoftim *Bechtel-it* brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, atëherë shërbimet do të konsiderohen të përfunduara dhe të pranuar. Pas përfundimit të shërbimeve në përputhje me këtë nen 2.3, fillon

periudha 12-mujore (dymbëdhjetëmujore) e përcaktuar në nenin 12.1c.

2.4 Klienti është përgjegjës, për: i. projektimin e Projektit dhe sigurohet që ai të jetë në përputhje me këtë Kontratë dhe të mos përmbajë pasaktësi apo mangësi (përveç atyre me natyrë të papërfillshme); dhe ii. për shërbimet e kryera nga të tretët është pronari dhe shfrytëzuesi i Projektit të përfunduar. *Bechtel-i* emëron dhe menaxhon të tretët, në përputhje me dhe në zbatim të shtojcës 1, aneksi 1 “Menaxhimi i të tretëve” dhe me këtë Kontratë. Palët bien dakord dhe pranojnë, që: i. përmbushja e këtyre detyrimeve nga *Bechtel-i* nuk krijon marrëdhënie partneriteti, agjencie apo sipërmarrjeje të përbashkët mes Palëve; dhe ii. *Bechtel-i* ka të drejtë të transferojë te Klienti të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë, që lindin nga kontratat e lidhura me të tretët dhe Klienti bie dakord me këtë transferim, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e transferimit që jepet në shtojcën 1, aneksi 1, “Menaxhimi i të tretëve” ose sipas kushteve thelbësish të ngjashme me to, dhe bie dakord që transferimi të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të marrëveshjes së transferimit mes *Bechtel-it* dhe të tretëve. Pavarësisht faktit se transferimi hyn në fuqi, siç përshkruhet më sipër, Klienti, nëse i kërkohet nga *Bechtel-i*, do të nënshkruajë marrëveshjen e transferimit.

2.5 Klienti deklaron dhe garanton se ka tagër të plotë për të lidhur këtë Kontratë dhe se ka kryer të gjitha procedurat e brendshme për këtë qëllim dhe ka marrë të gjitha lejet dhe miratimet që



konfirmojnë se Kontrata është në përputhje me ligjet shqiptare. Më tej, Klienti konfirmon se në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate, janë ndërmarrë dhe janë në fuqi të gjitha masat financiare që do t'i mundësojnë Klientit të kryejë pagesat ndaj *Bechtel*-it, në përputhje me këtë Kontratë.

3. Mbështetja e Klientit

3.1 *Bechtel*-i gëzon të drejtën të mbështetet në saktësinë dhe në plotësinë e të gjithë informacionit shkresor të përcaktuar në shtojcën 1, që do t'i jepet *Bechtel*-it nga Klienti brenda afateve të përcaktuara po aty, gjatë realizimit të shërbimeve. Gjithashtu, Klienti do t'i japë *Bechtel*-it çdo informacion dhe mbështetje tjetër që mund të kërkohej nga *Bechtel*-i me shkrim dhe që disponohet nga Klienti, me qëllim që *Bechtel*-i të realizojë shërbimet. *Bechtel*-i nuk mban përgjegjësi për pasaktësi apo mangësi në informacion, por gjithsesi *Bechtel*-i duhet ta shqyrtojë informacionin, si pjesë e Shërbimit, dhe të njoftojë Klientin për çdo pasaktësi, mangësi, gabim, dykuptimësi, mospërputhje ose inkonsistencë të konstatuar prej tij, dhe që mund të konstatohet lehtësisht pa kryer vlerësime apo verifikime të hollësishme. Mosrespektimi i afateve për dhënien e informacionit dhe mbështetjes, siç përcaktohet në shtojcën 1, i jep të drejtën *Bechtel*-it të kërkojë pezullim të programit për të gjithë kohëzgjatjen e vonesës në dhënien e këtij informacioni, përveçse kur ky informacion do të cenonte ecurinë kritike të programit dhe, në këtë rast *Bechtel*-i ka të drejtë të kërkojë pezullim të programit për një kohëzgjatje të rënë dakord bashkërisht mes palëve, duke përfshirë edhe ndryshimin e Programit të Projektit, ndryshimin e planit të pagesës së parashikuar të etapave në shtojcën 2, dhe ka të drejtën të faturojë orët reale të punës dhe të marrë pagesën për atë pjesë të detyrave që janë përfunduar, në përputhje me shtojcën 2.

3.2 *Bechtel*-i do të marrë, mbajë në fuqi dhe rinovojë në kohën e duhur, të gjitha miratimet, pëlqimet dhe lejet që kërkohej, sipas ligjit shqiptar për realizimin e shërbimeve dhe Klienti do të ofrojë mbështetjen e tij që mund t'i nevojitet *Bechtel*-it në këtë drejtim. Në rast se Klienti nuk e ofron mbështetjen në kohë, atëherë gjen zbatim neni 6.1.

3.3 Klienti, në çdo moment gjatë realizimit të shërbimeve, i jep *Bechtel*-it dhe përfaqësuesve të tij

të drejta hyrjeje dhe përdorimi në vendin e Projektit deri në masën që mund të kërkohej nga *Bechtel*-i, për qëllime të realizimit të shërbimeve. Në rast se vendi i Projektit nuk vendoset në dispozicion, atëherë gjen zbatim neni 6.1.

4. Financimi i Projektit

4.1 Palët pranojnë se përgjegjësia e financimit i takon Klientit dhe *Bechtel*-it do të bëjë përpjekjet e arsyeshme për të ndihmuar Klientin të sigurojë mbështetjen financiare për Projektin.

5. Shpërblimi dhe pagesa

5.1 Klienti do t'i paguajë *Bechtel*-it shpërblim për realizimin e shërbimeve në përputhje me shtojcën 2 ("Shpërblimi").

5.2 *Bechtel*-i do të realizojë shërbimet deri sa shpërblimi total i paguar ose i pagueshëm nga Klienti për realizimin e shërbimeve të arrijë nivelin maksimal të totalit të kostove, që përshkruhet në shtojcën 2. *Bechtel*-i dhe Klienti mbajnë vazhdimisht në monitorim vlerën e shërbimeve dhe të etapave të përfunduara dhe të planifikuara dhe *Bechtel* i jep Klientit njoftim me shkrim të paktën 30 (tridhjetë) ditë para, nëse vlerëson se po arrihet limiti i shumës së preventuar të etapës. Nëse *Bechtel*-i e jep këtë njoftim dhe Klienti e udhëzon *Bechtel*-in me shkrim të vijojë më tej me realizimin e shërbimeve, duke bërë rialokim të fondeve për etapën e ndryshme të përcaktuar në planin e pagesës së parashikuar të etapave, *Bechtel*-i do të shpërblehet për të gjitha shërbimet e kryera, duke respektuar kufirin e shpenzimeve, sipas këtij udhëzimi, nëse do të ketë. Nëse *Bechtel*-i e jep një njoftim të tillë dhe Klienti nuk e udhëzon *Bechtel*-in me shkrim që të vijojë më tej me shërbimet, atëherë *Bechtel*-i do të pezullojë shërbimet, sapo të arrijë vlerën e totalit të kostove dhe në këtë rast *Bechtel* dhe Klienti do të nisin diskutimet për mënyrë se si do të procedohet, në zbatim të të drejtës së secilës Palë për të zgjidhur Kontratën, sipas gjykimit të vet, pasi të jetë arritur tavani i totalit të kostove, në përputhje me këtë nen 5.2. Gjatë pezullimit të shërbimeve, *Bechtel*-i do të paguhet në përputhje me nenin 11.6. *Bechtel*-i do të realizojë produktet e punës dhe etapën e përcaktuar në shtojcën 1, në raport me nivelin e punës të kryer brenda totalit të kostos.

Klienti ka të drejtë të bëjë rialokime (lëvizje fondesh) brenda etapave të ndryshme të përcaktuara në planin e pagesës së parashikuar të etapave në shtojcën 2, nëse *Bechtel*-i jep njoftim me shkrim 30 (tridhjetë) ditë para, kur vlerëson se po



arrihet limiti i vlerës së preventuar të etapës, pa ndryshuar totalin e kostos, që përbën buxhetin fiks të përcaktuar në shtojcën 1, i cili nuk tejkalohet.

Totali i kostos përbën buxhetin fiks që nuk tejkalohet për produktet e punës të përcaktuara në objektin e shërbimeve më poshtë në shtojcën 1. Në rast se mund të nevojiten punë shtesë për të përfunduar shërbimet dhe vetëm nëse Klienti ka shteruar mundësitë e rialokimit të fondeve brenda etapave të ndryshme në planin e pagesës së parashikuar të etapave në shtojcën 2, dhe nëse është arritur totali i kostos, atëherë Klienti dhe *Bechtel*-i do të hyjnë në diskutime për ndryshimin e Kontratës, me qëllim përfundimin e realizimit të shërbimeve, ndryshim ky i cili do të kalojë për miratim në Këshillin e Ministrave.

5.3 Nëse pagesa e shumës që duhet t'i paguhet *Bechtel*-it, sipas kësaj Kontrate vonohet përtej periudhës 25-ditore (njëzetepesëditore) të përmendur në shtojcën 2, atëherë *Bechtel*-i gëzon të drejtën: i. të ngarkojë interes, në bazë mujore, mbi vlerën e papaguar, duke filluar nga e nesërmja e periudhës 25-ditore (njëzetepesëditore), të llogaritur sipas një norme vjetore interesi prej 5%. Për të ushtruar të drejtën e ngarkimit të interesit nuk është e nevojshme që *Bechtel*-i të japë njoftim zyrtar, dhe kjo e drejtë nuk cenon të drejtat apo kompensimet e tjera sipas kësaj Kontrate; ii. me koston e Klientit, të pezullojë Shërbimet duke dhënë njoftim me shkrim, nëse pagesa vonohet me më shumë se 7 (shtatë) ditë; dhe iii. ta përdorë parapagesën për të paguar kostot e nënkontraktorit, kostot e çmobilizimit dhe kosto të tjera përkatëse, duke përfshirë pagesën e plotë të shërbimeve të kryera. *Bechtel*-i do të rifillojë shërbimet, pasi të jenë paguar të gjitha shumatat e prapambetura. Pavarësisht nëse parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, *Bechtel*-i ka të drejtë të ndërpresë shërbimet në rast se Klienti nuk paguan shumë e plotë që i detyrohet *Bechtel*-it për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh ose më shumë, pa qenë nevoja të pajiset me vendim gjyqësor ose me vendim arbitrazhi apo pa qenë nevoja të nisë procedura gjyqësore.

6. Ndryshimet

6.1 *Bechtel*-i ka të drejtë të kërkojë rregullimin e kostove dhe/ose të programit, duke përfshirë përshtatjen e planit të pagesës së parashikuar të etapave të përcaktuar në shtojcën 2, si pasojë e ndikimeve negative të secilit prej rasteve të mëposhtme: i. vonesa të shkaktuara nga Klienti

(duke përfshirë vonesat e shkaktuara nga Autoriteti Kompetent), duke përfshirë vonesat për t'i dhënë *Bechtel*-it informacionin e përcaktuar në shtojcën 1, të nevojshëm për realizimin e shërbimeve, vonesat në hyrjen në vendin e projektit dhe vonesa të tjera nga Klienti për të përmbushur në kohë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe vonesat nga Autoriteti Kompetent për të dhënë miratimet e nevojshme; ii. ndryshime të objektit të udhëzuara nga Klienti (duke përfshirë ndryshimet në informacionin e dhënë nga Klienti) dhe *Bechtel*-i bie dakord me këto ndryshime të objektit; iii. informacion i pasaktë i dhënë nga Klienti dhe i përdorur nga *Bechtel*-i; v. në rast se çdo ndryshim i ligjit ndikon në kostot, programin dhe/ose realizimin e shërbimeve; vi. pezullimi të shërbimeve; dhe vii. në rast pandemie, sipas përkufizimit në nenin 6.2; dhe viii. ngjarje të forcës madhore sipas nenit 7. Në rast se secila prej ngjarjeve në pikat i. deri në viii. të nenit 6.1 i shkaktonte *Bechtel*-it vonesa në përfundimin e shërbimeve, në përputhje me Programin e Projektit, atëherë *Bechtel*-i do të ketë të drejtë të faturojë orët faktike dhe të marrë pagesën për atë pjesë të detyrave që janë realizuar në përputhje me shtojcën 2.

6.2 Në këtë Kontratë termi “Pandemi” nënkupton sëmundjen e Coronavirus 2019 (COVID-19) dhe mutacionet e COVID-19, si dhe çdo epidemi ose pandemi që mund të prekë shërbimet (kudo që kryhen) dhe/ose Projektin.

6.3 Nëse *Bechtel*-i (ose nënkontraktorët e tij) vonohen ose pengohen në realizimin e shërbimeve; ose Klienti vonohet ose pengohet në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate (me përjashtim të detyrimeve të pagesës), si rezultat i apo në lidhje me një Pandemi ose ngjarje, masë ose kufizim lidhur me Pandeminë, duke përfshirë ligjet ose udhëzimet në lidhje me të (“Ngjarje pandemie”), Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër për ngjarjen e pandemisë. Pasi të japë një njoftim të tillë, Pala e prekur shfaqësohet nga mospërmbushja e detyrimeve në kohë, sipas rastit, për sa kohë që të ekzistojnë rrethanat që kanë shkaktuar vonesën ose privimin për përmbushjen e detyrimeve.

6.4 Në rast se *Bechtel*-i vlerëson në mënyrë të arsyeshme se Pandemia përbën një kërcënim ndaj shëndetit ose sigurisë së personelit të *Bechtel*-it të angazhuar në realizimin e shërbimeve, *Bechtel*-i do të ketë të drejtë, pasi të konsultohet drejtpërdrejt me



Klientin, të evakuojë personelin e tij nga vendi i Projektit për sa kohë që *Bechtel-i*, sipas gjykimit të vet, e konsideron të nevojshme dhe deri sa të përfundojë rreziku i lidhur me këtë kërcënim, sipas gjykimit të *Bechtel-i* (“Evakuimi në rast pandemie”). Në rast se kryhet evakuimi në rast pandemie, *Bechtel-i* ka të drejtë të zgjasë programin, si rezultat i vonesave që lidhen me evakuimin në rast pandemie.

7. Forca madhore

7.1 Asnjëra nga Palët nuk konsiderohet se nuk ka përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate (përveç detyrimeve të pagesës për shërbimet e kryera tashmë nga *Bechtel-i* përpara ngjarjes së forcës madhore), nëse përmbushja e këtyre detyrimeve pengohet ose vonohet (përveçse kur kjo ndodh për vaj apo pakujdesja të Palës së prekur), nga një shkak që: i. është i paparashikueshëm ose i pakontrollueshëm (dhe që ajo Palë nuk është në gjendje ta tejkalojë edhe pasi ka ushtruar të gjithë kujdesin e duhur); dhe ii. e vendos atë Palë në kushtet e pamundësisë për të realizuar detyrimet kontraktuale të prekura prej saj. Ngjarjet e forcës madhore mund të përfshijnë për shembull, luftërat, grevat, trazirat civile, kryengritjet, tërmetet, zjarret, shpërthimet, stuhitë, pandemitë, epidemitë, përmytjet ose kushte të tjera të pafavorshme të motit ose konfiskimin. Në këtë rast, Programi i Projektit do të përshtatet/rregullohet përkatësisht.

7.2 Pala, detyrimet e së cilës janë pezulluar, sipas nenit 7.1, e rifillon përmbushjen e atyre detyrimeve sapo të jetë e mundur pas largimit të shkakut dhe njofton menjëherë për këtë Palën tjetër.

7.3 Nëse ngjarja e forcës madhore vazhdon për një periudhë kohore më të gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, secila Palë ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë, duke i dhënë Palës tjetër njoftim me shkrim të paktën 30 (tridhjetë) ditë para. Në rastin e një zgjidhjeje të tillë, Klienti i paguan *Bechtel-it* shumat e pakundërshtuara për shërbimet e kryera deri në datën e zgjidhjes, plus kostot reale të çmobilizimit.

7.4 Pala e prekur do të njoftojë me shkrim Palën tjetër, sapo të jetë e mundur, për shfaqjen e ngjarjes së forcës madhore, duke dhënë detaje për forcën madhore. Pala e prekur nga forca madhore koordinon me Palën tjetër dhe i jep Palës tjetër rregullisht raportime mbi progresin e masave

korrigjuese dhe çdo informacion tjetër që Pala tjetër mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

8. Pronësia intelektuale

8.1 Çdo Palë mban të drejtat e pronësisë intelektuale paraekzistuese. Të drejtat e pronësisë intelektuale në dokumentet e krijuara specifikisht, si pjesë e shërbimeve gjatë realizimit të kësaj Kontrate i takojnë klientit. Klienti i jep *Bechtel-it* lejen joekskluzive, pa pagesë, të parevokueshme dhe të pakushtëzuar për të kopjuar, përdorur dhe riprodhuar ato për qëllime të realizimit të shërbimeve, gjithmonë në zbatim të detyrimeve të *Bechtel-it* sipas nenit 9. Kjo licencë përmban, duke iu nënshtuar miratimit paraprak nga Klienti, të drejtë për t'u dhënë me nënlicencim, por nuk mund të transferohet.

9. Konfidencialiteti

9.1 Përveçse me miratimin paraprak me shkrim të Palës dhënëse të informacionit, asnjëra nga Palët nuk mundet në asnjë moment të komunikojë tek asnjë person apo subjekt asnjë informacion konfidencial që ka marrë në lidhje me këtë Kontratë, përveçse kur nxjerrja e tij të përfaqësohet e asaj Pale është e domosdoshme me qëllim që Pala të përmbushë detyrimet e saj, sipas kësaj Kontrate (dhe kjo Palë mbetet përgjegjëse për veprimet e këtij përfaqësuesi njësoj sikur të ishin veprime të kryera nga vet ajo Palë).

9.2 Asgjë në këtë Kontratë nuk detyron asnjë nga Palët që të japë informacion ligjor të privilegjuar, informacione për të cilat secila Palë ka detyrime për ruajtjen e konfidencialiteti ndaj një pale të tretë, të dhëna personale në lidhje me secilën Palë ose me personelin e filialeve të saj ose informacione sensitive tregtare të brendshme të secilës Palë.

9.3 Klienti njofton *Bechtel-in* brenda 7 (shtatë) ditëve në rastin e një kërkesë për publikim apo nxjerrje të informacionit konfidencial, në mënyrë që të dyja Palët të kenë mundësinë e arsyeshme për të mbrojtur konfidencialitetin e këtij informacioni. Çdo publikim apo nxjerrje e informacionit të kërkuar sipas ligjit, kufizohet në atë sasi të informacionit që kërkohet të publikohet ose të nxirret dhe kur është e mundur i nënshtrohet marrjes së një urdhri apo garancie tjetër të nevojshme që ky informacion do të trajtohet në mënyrë konfidenciale.



10. Praktikë e etikës së biznesit

10.1 Palët pranojnë të zbatojnë angazhimet e përcaktuara në shtojcën 3 të kësaj Kontrate.

10.2 Asgjë në këtë Kontratë nuk detyron asnjërin nga Palët të ndërmarrë apo të hezitojë të ndërmarrë veprime që do të shkaktonin, ose që secila Palë mendon se do të shkaktonin shkelje prej saj apo penalizim të saj sipas ligjeve të zbatueshme.

11. Hyrja në fuqi, pezullimi dhe zgjidhja

11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, që miraton këtë Kontratë. Të drejtat dhe detyrimet e palëve për të përmbushur detyrimet e tyre, sipas kësaj Kontrate fillojnë të zbatohen nga data efektive.

11.2 Kjo Kontratë zgjidhet në rast se ndodh secila prej ngjarjeve të mëposhtme:

11.2.1 njëra nga Palët kryen shkelje të konsiderueshme të detyrimeve të saj materiale, sipas kësaj Kontrate dhe nuk e riparon këtë shkelje brenda 30 (tridhjetë) ditësh (ose brenda një periudhe të arsyeshme, nëse shkelja nuk është e mundur të riparohet brenda 30 (tridhjetë) ditësh) pas njoftimit me shkrim nga Pala tjetër drejtuar Palës që ka kryer shkeljen, ku e njofton këtë të fundit për këtë shkelje, i kërkon ta riparojë shkeljen, dhe e njofton për qëllimin e saj për të zgjidhur Kontratën, duke i dhënë *Bechtel*-it njoftim me shkrim 14 (katërmëdhjetë) ditë para për zgjidhjen e Kontratës; ose

11.2.2 Pala që nuk ka kryer shkelje i dërgon njoftim me shkrim për zgjidhje të Kontratës Palës që ka kryer shkelje, sipas nenit 10; ose

11.2.3 secila nga Palët prishet ose falimenton.

11.3 Klienti ka të drejtë të ndërpresë shërbimet e *Bechtel*-it ose çdo pjesë të tyre, duke dërguar njoftim me shkrim 30 (tridhjetë) ditë para.

11.4 Pas zgjidhjes së Kontratës sipas këtij neni 11:

11.4.1 *Bechtel*-i i dorëzon Klientit të gjithë punën në proces që është pjesë e shërbimeve të kryera përpara datës së zgjidhjes.

11.4.2 në rastin e zgjidhjes për arsye që nuk i atribuohen *Bechtel*-it, Klienti i paguan *Bechtel*-it të gjitha shumat e pakundërshtuara për shërbimet e kryera deri në datën e zgjidhjes, plus kostot reale të çmobilizimit.

11.4.3 në rastin e zgjidhjes për arsye që i atribuohen *Bechtel*-it, Klienti nuk është i detyruar t'i paguajë asnjë shumë *Bechtel*-it, përveç shumave të

pakundërshtuara të faturuara më parë dhe të miratuara nga Klienti për t'u paguar përpara datës së zgjidhjes.

11.4.4 nëse nuk ka asnjë shumë të prapambetur që Klienti i detyrohet *Bechtel*-it për shërbimet që janë kryer, *Bechtel*-i do t'i kthejë Klientit balancën e shumës së parapaguar.

11.5 Përgjegjësia e *Bechtel*-it ndaj Klientit që lind nga ose në lidhje me realizimin e shërbimeve pushon së ekzistuari, përveç detyrimeve përkatëse të secilës Palë, sipas neneve 2, 8, 9, 12 dhe 18 që i mbijetojnë zgjidhjes së kësaj Kontrate.

11.6 Klienti ka të drejtë të pezullojë shërbimet ose çdo pjesë të tyre. Kostot ekstra të nevojshme të kryera nga *Bechtel*-i mbulohen dhe paguhen nga Klienti (përveçse kur ky pezullim është shkaktuar nga *Bechtel*-i), duke përfshirë pa kufizim: i. të gjitha kostot e arsyeshme të kryera për çmobilizimin dhe rimobilizimin; dhe ii. kostot e kryera për nënkontraktorët, për shkak të pezullimit. Në rastin e forcës madhore zbatohen dispozitat e nenit 7. Me përjashtim të pezullimit për mospërmbushje nga ana e *Bechtel*-it, Klienti dhe *Bechtel*-i bien dakord brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas datës së urdhrat për të rifilluar shërbimet, për çdo zgjatje të afatit për përfundimin e Shërbimeve.

12. Përgjegjësia

12.1 Në masën maksimale të lejuar nga legjislacioni i zbatueshëm:

a) Me përjashtim të detyrimit të Klientit për të paguar shpërblimin, pavarësisht ndonjë dispozite tjetër në këtë Kontratë dhe në masën maksimale të lejuar nga legjislacioni i zbatueshëm, asnjëra nga Palët nuk ka detyrime ndaj tjetrës (apo ndaj palëve të lidhura me të), për: i. dëmet ndëshkimore, ekzemplare ose për shkelje të rënda; ii. për humbjen e fitimit, humbjen e të ardhurave, humbjen e financimit, humbjen e emrit të mirë, humbjen e përdorimit, humbjen e mundësisë, kostot e kohës pa punë ose kostot e kapitalit dhe kostot e marrjes dhe të mbajtjes së financimit (në të gjitha rastet, qofshin të drejtpërdrejta, të tërthorta apo shkakësore); ose iii. për dëmet indirekte ose shkakësore, kostot, humbjet ose shpenzimet e çfarëdolloj, të shkaktuara në lidhje me këtë Kontratë, Projektin dhe/ose shërbimet, dhe secila Palë e çliron Palën tjetër nga çdo përgjegjësi e tillë.

b) Në rast gabimi, mospërputhjeje apo mangësie në shërbimet e ofruara nga *Bechtel*-i dhe në rast se nuk përmbushet standardi i kujdesit të duhur i



përcaktuar në nenin 2.2 dhe Klienti njofton *Bechtel*-in me shkrim për këtë defekt brenda 3 (tre) muajve nga njoftimi i përfundimit të shërbimeve, atëherë *Bechtel*-i do të rikryejë shërbimet me shpenzimet e veta dhe kjo rikryerje e shërbimeve do të jetë përgjegjësi e vetme dhe ekskluzive e *Bechtel*-it dhe kompensimi i vetëm dhe ekskluziv i Klientit, qoftë sipas kontratës, ligjit apo tjetër, për çdo mangësi në realizimin e shërbimeve ose në produktin e punës.

c) Në masën maksimale të lejuar nga ligji i zbatueshëm, detyrimi total i *Bechtel*-it ndaj Klientit, që lind nga apo në lidhje me këtë Kontratë, Projektin dhe shërbimet, kufizohet në masën 20% (njëzet për qind) të shumave të marra nga *Bechtel*-i për pagesën në përputhje me shtojcën 2, në datën kur konstatohet ky detyrim dhe në asnjë rast nuk tejkalon shumën prej 3 000 000,00 eurosh (tre milionë eurosh) në totalin e tij (“Tavani i detyrimit total”). Klienti e çliron *Bechtel*-in nga çdo detyrim përtej këtij limiti. Në çdo rast, detyrimi i *Bechtel*-it për çfarëdo arsye lidhur me realizimin e shërbimeve pushon së ekzistuari pas përfundimit të periudhës 12-mujore (dymbëdhjetëmuajore) nga përfundimi i shërbimeve ose pas ndërprerjes së parakohshme të shërbimeve të *Bechtel*-it, sipas kësaj Kontrate, në zbatim të nenit 11.

d) *Bechtel*-i nuk ka asnjë detyrim për humbjen ose dëmtimin e pasurisë së Klientit ose të çdo pasurie, përveçse kur kjo është shkaktuar nga pakujdesia e *Bechtel*-it dhe në këtë rast detyrimi nuk tejkalon vlerën më të vogël nga sa më poshtë: i. të ardhurat faktike të arkëtuara përmes sigurimit të blerë nga *Bechtel*-i posaçërisht në lidhje me këtë Kontratë; ose ii. shumën prej 500 000,00 euro (pesëqind mijë euro) për ngjarje, pa tejkaluar shumën kumulative totale prej 1 000 000,00 euro (një milion euro), dhe Klienti e çliron *Bechtel*-in nga çdo detyrim përtej këtij limiti.

e) Klienti njeh dhe pranon se *Bechtel*-i nuk ka asnjë detyrim ndaj të tretëve, në lidhje me shërbimet ose Projektin dhe Klienti dëmshpërblen dhe mban të padëmtuar *Bechtel*-in, në lidhje me këto detyrime apo pretendime të të tretëve ndaj *Bechtel*-it, si rezultat i realizimit të kësaj Kontrate nga *Bechtel*-i.

f) Mjetet ligjore të përcaktuara në këtë Kontratë janë mjetet ligjore të vetme dhe ekskluzive të *Bechtel*-it ndaj Klientit, në lidhje me këtë Kontratë dhe me realizimin e shërbimeve.

13. Pavlefshmëria e pjesshme

13.1 Në rast se një dispozitë e kësaj Kontrate, shpallet tërësisht apo pjesërisht e pavlefshme ose e pazbatueshme, Klienti dhe *Bechtel*-i do të negociojnë për të bërë një përshtatje të drejtë të dispozitave të kësaj Kontrate, duke synuar realizimin e qëllimit të kësaj Kontrate dhe kjo pavlefshmëri e pjesshme nuk do të ndikojë në vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e dispozitave të tjera apo të pjesës së vlefshme të asaj dispozite.

14. Përfaqësuesit dhe njoftimet

14.1 Në zbatim të nenit 14.2, përfaqësuesit e Palëve për komunikimin e përditshëm do të jenë personat e mëposhtëm (ose çdo person tjetër që mund të njoftohet herë pas here me shkrim nga njëra Palë te Pala tjetër):

Përfaqësuesi i klientit:

Ergys Verdhho

Email: ergys.verdho@kesh.al

Adresa: Rruga “Viktor Eftimiu”, blloku “Vasil Shanto”, Tërana, Albania

Përfaqësuesi i *Bechtel*-it:

Hugh Morrison

Email: hjmorris@Bechtel.com

Adresa: Sky Tower, kati 5, suita 2, Tërënë, Shqipëri

14.2 Çdo njoftim dhe komunikim tjetër zyrtar që kërkohet apo lejohet sipas kësaj Kontrate do të mbahet në formë shkresore dhe do të konsiderohet si i dërguar, nëse dërgohet me postë të mirënjohur ndërkombëtare në adresat e mëposhtme:

Klienti:

Besian Kadiu

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.

Rruga “Viktor Eftimiu”, blloku “Vasil Shanto” Tërana, Albania

Për dijëni: kadiub@kesh.al

Bechtel:

Martyn Daw

Drejtor i Departamentit Ligjor, Infrastrukturës *Bechtel* Limited

c/o 2 Lakeside Dr, London NW10 7FQ

Për dijëni: mndaw@Bechtel.com



15. Transferimi dhe nënkontraktimi

15.1 Kjo Kontratë nuk mund të transferohet nga asnjë prej palëve pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

15.2 *Bechtel*-i nuk mund të nënkontrakttojë të gjithë Shërbimet pa marrë miratimin paraprak të Klientit (miratim i cili nuk mund të mohohet apo vonohet pa arsye). Për të shmangur çdo dyshim, me termin të Tretë nënkuptohen nënkontraktorët. Klienti njeh dhe pranon se kufizimet e përgjegjësisë së *Bechtel*-it të përcaktuara në këtë Kontratë përbëjnë kufirin total të përgjegjësisë së *Bechtel*-it dhe të Grupit të tij ndaj Klientit.

16. Marrëveshja e plotë

16.1 Sipas qëllimit të shprehur të Palëve kushtet e përgjithshme të kësaj Kontrate përbëjnë të gjithë marrëveshjen mes Palëve dhe, përveç dispozitave detyruese të ligjit shqiptar, rregullojnë të gjithë marrëdhënien kontraktuale mes Palëve dhe mjetet ligjore që *Bechtel*-i i njeh shprehimisht Klientit janë mjetet ligjore të vetme dhe ekskluzive që Klienti ka në dispozicion, në lidhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e *Bechtel*-it, që lindin nga ose në lidhje me shërbimet dhe me këtë Kontratë.

17. Kopjet dhe gjuha

17.1 Palët mund ta nënshkruajnë këtë Kontratë në disa kopje në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, ku secila prej tyre konsiderohet kopje origjinale dhe të gjitha bashkë përbëjnë një dhe të njëjtën Kontratë. Në rast mospërputhjeje mes versionit në anglisht dhe atij në shqip, versioni anglisht merr përparësi. Kjo Kontratë mund të livrohet elektronikisht dhe kopjet elektronike të faqeve të nënshkruara janë detyruese njësoj sikur të jenë origjinale.

18. Ligji rregullues dhe mosmarrëveshjet

18.1 Shërbimet realizohen në përputhje me ligjin shqiptar. Në lidhje me interpretimin, kuptimin, të drejtat dhe detyrimet, përgjegjësitë dhe çdo gjë tjetër, kjo Kontratë rregullohet nga ligjet e Anglisë dhe të Uellsit. Kjo Kontratë nuk është në dobi dhe përfitim të të tretëve në bazë të ligjit për kontratat të vitit 1999 (Të drejtat e të tretëve).

18.2 Çdo mosmarrëveshje ose divergjencë që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë (“Mosmarrëveshja”), konvergencë, kundërshti apo ankesë që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë ose me shkeljen e kësaj Kontrate, do të zgjidhet nga arbitrazhi. Përpara fillimit të arbitrazhit, secila Palë do të bëjë përpjekjet maksimale për ta zgjidhur

Mosmarrëveshjen me negociim sipas procedurës së mëposhtme:

18.2.1 Pala që e ngre mosmarrëveshjen i jep palës tjetër njoftim me shkrim ku përcakton detajet e arsyeshme të natyrës së mosmarrëveshjes.

18.2.2 Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dhënies së njoftimit, pala tjetër kthen një përgjigje të detajuar me shkrim të pala që ka dhënë njoftimin e mosmarrëveshjes. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dhënies së njoftimit, përfaqësuesit e palëve ose çdo person tjetër me tagër për të zgjidhur mosmarrëveshjen, do të takohen në një vend dhe orë të dakordësuar bashkërisht, në përpjekje për të zgjidhur Mosmarrëveshjen.

18.2.3 Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve nga njoftimi fillestar me shkrim ose brenda një periudhe më të gjatë të dakordësuar mes Palëve, atëherë secila palë mund t'i drejtohet arbitrazhit në përputhje me dispozitat e mëposhtme.

18.3 Në zbatim të nenit 18.2, Mosmarrëveshjet zgjidhen me vendim të formës së prerë nga arbitrazhi ndërkombëtar, në përputhje me Rregullat e Pajtimt dhe të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Numri i arbitrave do të jetë tre. Secila Palë cakton nga një arbitër, dhe më pas këta arbitra bien dakord për të caktuar arbitrin e tretë. Kur arbitrat e caktuar nga Palët nuk mund të bien dakord për arbitrin e tretë, atëherë arbitri i tretë zgjidhet nga Presidenti i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Procedura e arbitrazhit bazohet në ligjin material të Anglisë dhe Uellsit. Gjuha e përdorur për procesin e arbitrazhit është gjuha angleze. Vendi i arbitrazhit është Londra, Angli.

NË DËSHMI TË SA MË LART, Palët e kësaj Kontrate e nënshkruajnë këtë Kontratë në ditën, muajin dhe vitin e shënuar më sipër.

Nënshkruar nga

**KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE
SHQIPTARE SHA**

Nënshkrimi i dëshmitarit:

Emri i dëshmitarit:

Adresa: Rruga “Viktor Eftimi”, blloku “Vail Shanto”, Tiranë, Shqipëri



Nënshkruar nga

BECHTEL LIMITED

Nënshkrimi i dëshmitarit:

Emri i dëshmitarit:

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Sky Tower,
Floor 5, Suite 2, Tiranë, Shqipëri

SHTOJCA 1
OBJEKTI I SHËRBIMEVE

Projekti Hidroenergjetik i Skavicës (HEC Skavica) do të ndërtohet në rrjedhën e sipërme të kaskadës së tri digave ekzistuese që janë në pronësi dhe shfrytëzim të Klientit. HEC Skavica ka për qëllim të ofrojë prodhim shtesë të energjisë elektrike, të parandalojë përmbytjet në rrjedhën e poshtme dhe të optimizojë kaskadën duke qenë digë kontrolluese.

Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, shërbimet përfshijnë detyrat e përshkruara në këtë shtojcë 1, me ndryshimet e herë pas herëshme të kryera me marrëveshje mes Palëve. Pas përfundimit të detyrës 1, *Bechtel*-i do t'i paraqesë Klientit për miratim programin e projektit për detyrat e mbetura. Në përputhje me ligjin nr. 38/2021, qëllimi i Kontratës së fazës së parë konsiston në kryerjen e aktiviteteve paraprake të punës. Për sa më lart, detyrat e parashikuara në këtë shtojcë 1 do të jenë në funksion të përmbytjes së kërkesave të ligjit të zbatueshëm për sa i përket miratimit të projektit të digës (përfshirë projekt idenë dhe projekt zbatimin), por miratimet përfundimtare të projekt idesë dhe projektzbatimit, sipas ligjit të zbatueshëm për miratimin e projektit të digave, mund të mos finalizohen deri në fazën e dytë, siç përshkruhet në ligjin nr. 38/2021.

DETYRA 1: VLERËSIMI PARAPRAK, MBLEDHJA FILLESTARE E TË DHËNAVE DHE FINALIZIMI I RAKORDIMIT TË OBJEKTIT

Klienti do të organizojë takime me konsulentët vendës, me agjencitë qeveritare, me Ministrinë dhe me grupet e interesit, dhe do të asistojë në përgatitjen e dokumentacionit të disponueshëm. Mundësia për të përfunduar detyrën 1 dhe për të finalizuar detyrat kushtëzohet, ndër të tjera, nga

mbështetja e Klientit dhe organizimi në kohë i këtyre takime. Informacioni i kërkuar për Detyrën 1 është kritik për arritjen e Programit dhe Kalendarit të Projektit për fazën 1 dhe çdo vonesë në marrjen e të dhënave në përputhje me Programin dhe Kalendarin e Projektit mund të vonojë gjithë realizimin e fazës 1.

Si pjesë e vlerësimit paraprak, Palët do të shqyrtojnë detyrat e përshkruara në këtë shtojcë 1 dhe planin e pagesës së parashikuar të etapave të përshkruar në shtojcën 2 dhe do të punojnë bashkërisht për të rakorduar dhe bërë planin për 90 ditët e para të Projektit. Palët, gjithashtu, do të shqyrtojnë ligjin e zbatueshëm për sa i përket miratimit të projektit të digave për të konfirmuar nëse nevojiten shërbime shtesë dhe për të dakordësuar planin për finalizimin e dokumentacionit të nevojshëm, me qëllim paraqitjen e projektit pranë Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha. *Bechtel*-i nuk mban asnjë përgjegjësi apo detyrim për rezultatin e shqyrtimit/vendimin e marrë nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha.

Palët do të shqyrtojnë të gjitha të dhënat, raportet dhe dokumentet e disponueshme dhe do të marrin informacionin që do të jepet nga Klienti, përfshirë:

- a) informacionin Gjeografik (DTM);
- b) të dhënat Gjeoteknike;
- c) të dhënat Mjedisore;
- d) të dhënat Gjeologjike;
- e) të dhënat Hidraulike dhe Hidrologjike;
- f) të dhënat Socio-ekonomike;
- g) të dhënat e Përmbytjeve;
- h) matjet topografike;
- i) llogaritjet për matjen e sedimenteve;
- j) normat ditore të rrjedhjes në dalje;
- k) propozimi i linjës së lidhjes me rrjetin;
- l) të dhënat sizmike.

DETYRA 2: STUDIMI, PËRZGJEDHJA E VENDIT DHE KONCEPTET

a) Palët e treta kryejnë vlerësimin e thelluar të vendit të Projektit, ku përfshihet:

1. Aksesimi i tokës;
2. Kufizimet aerohapësinore;
3. Përdorimi i tokës përreth;
4. Plani i strehimit;

b) inspektimi i topografisë/kushtet gjeoteknike dhe të tokës;

- c) vlerësimi mjedisor dhe kufizimet;



d) për VNMS-në duhet të përmbushen Standardet e Performancës të IFC-së dhe Udhëzimet e tjera të Grupit të Bankës Botërore, Parimet e Ekuatorit dhe të çdo institucioni tjetër financiar që mund t'i ofrojë mbështetje financiare Klientit dhe/ose Shtetit Shqiptar sipas nevojave të projektit;

e) shqyrtimi dhe inputi në Planet e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Planet e Risistemimit (të Klientit dhe të bashkive).

DETYRA 3: STUDIMET/RILEVIMET

Palët e treta kryejnë punimet studimore që mbulojnë pa kufizim sa më poshtë:

a) Rilevimi topografik (LIDAR):

1. Konfirmimi i pikave/hartës së kontrollit të fluturimit;

2. Fluturimi LIDAR;

b) Studimi batimetrik;

1. Sondimi dhe mbledhja e të dhënave hidrometeorologjike;

2. Dopler profili 1 dhe mbledhja e të dhënave hidrometeorologjike.

Rilevimi topografik (LIDAR) do të kryhet me teknikën me rreze lazer infra të kuqe, për të matur distancat në tokë. Studimi hidrologjik do të sigurojë të dhëna të ndikimit hidrologjik të ujërave nëntokësore në HEC-in e Skavicës.

Palët e treta do të kryejnë fotografimin nga hapësira, LIDAR-in dhe hartën topografike që mbulon digën, rezervuarin, rrugët dhe zonat e transmetimit. Do të kryhen matje topografike shtesë sipas nevojës për të mbështetur aktivitetet e fazës 1.

DETYRA 4: PUNIME INSPEKTIMI DHE STUDIME

Palët e treta do të kryejnë inspektime dhe studime për të mundësuar projektimin, zbatimin dhe aktivitetet e VNMS-së. Studimet do të bazohen në analizimin e informacionit të disponueshëm, në vlerësimet ndërdisiplinore në terren dhe në takimet me grupet e interesit.

a) Studimi hidrologjik:

1. Shqyrtohen dhe dakordësohen të gjitha produktet e nevojshme për të mbështetur studimin hidrologjik;

b) Inspektimi gjeoteknik (shpimet):

1. Raporti i studimit dokumentar gjeologjik dhe gjeoteknik;

2. Palët do të bashkëpunojnë për të identifikuar token që nevojitet për rrugët lidhëse për studimet gjeoteknike;

3. Prova të porosisë së bërë për sondë shpimi;

4. Ofrimi i kampionëve ndërkohë që punët po përfundohen.

Palët e treta do të kryejnë inspektimet inxhinierike të mëposhtme:

a) inspektimin gjeoteknik të aksit të digës, rrugëve dhe punimeve të karrierës;

b) inspektimin gjeologjik të aksit të digës, rrugëve dhe punimeve të karrierës;

c) inspektimin e materialit ndërtimor;

d) studimet hidrologjike, hidraulike dhe batimetrike;

e) rilevimin topografik dhe LIDAR për digën, zonën e rezervuarit dhe linjat e transmetimit;

f) vlerësimin e riskut klimaterik;

g) karakterizimi i burimit sizmik (SSC) bazuar në raportet gjeologjike dhe tektonike të disponueshme për rajonin e vendit të projektit, projektimi sizmik i vibrimit të truallit (horizontal dhe vertikal) dhe karakterizimi i vibrimit të truallit (GMC), vlerësimi i sizmicitetit të induktuar në rezervuar dhe i aktivitetit sizmik të shkaktuar nga krijimi i rezervuarit në afërsi të vendit të projektit të projektit, si dhe analiza sizmike e digës dhe e strukturave të saj mbështetëse për të përcaktuar kriteret e ngarkesës sizmike, kriteret e projektimit sizmik dhe kodet standarde përkatëse për vendin e projektit;

h) një katalog i karakteristikave gjeologjike përkatëse, ku përfshihet një përshkrim i përbërjes së tokës dhe i shkëmbit përgjatë zonës, për të hetuar ndikimin e këtyre faktorëve në projektim. Do të bëhet shqyrtimi i të dhënave përkatëse ekzistuese, i cili do të ndiqet më pas nga një studim i përgjithshëm i përbërjes së tokës dhe materialeve; dhe

i) studimet hidrologjike për të gjitha strukturat e drenazimit, duke përdorur hartat e disponueshme dhe hetimet në terren. Palët e treta do të përcaktojnë zonat e ujëmbledhësve, koeficientet e prurjeve, skarpatën për mbrojtjen hidraulike ndaj erozionit, dhe do të projektojnë shkarkimin e prurjeve për periudhën e përshtatshme të kthimit për çdo strukturë drenazimi, si dhe do të përcaktojnë nivelin përkatës të ujit.

Palët e treta do të hetojnë tiparet hidrologjike, duke përfshirë informacionin rreth përbërjes së



tokës dhe specifike të drenazhimit, si dhe kushtet klimatike, duke përfshirë:

- intensiteti i reshjeve (shpërndarja dhe intensiteti mujor, duke përfshirë ditët me shi për çdo muaj);
- të dhënat meteorologjike.

Hetimet e detajuara do të përfshihen në raporte.

DETYRA 5: VLERËSIMI I NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Palët e treta do të përgatisin VNMS-në ku përcaktohen kushtet bazë sociale dhe ekonomike ekzistuese, bëhen parashikime dhe vlerësime të ndikimeve të mundshme mjedisore dhe sociale të HEC-it Skavica, vlerësohen alternativat dhe propozohen masat e përshtatshme për zbutjen, menaxhimin dhe monitorimin. VNMS-ja përfshin aktivitetet e mëposhtme:

a) Planifikimi dhe fillimi i projektit:

1. Shkëmbim informacioni dhe diskutimi i metodologjisë;

b) Ekzaminimi (*scoping*), termat e referencës së VNMS-së dhe plani paraprak i përfshirjes së grupeve të interesit;

1. Raporti i *scoping*;

2. Termat e referencës;

3. Plan i përfshirjes së grupeve të interesit;

c) Studimet bazë të VNMS-së dhe konsultimet e VNMS-së;

d) Paketa e VNMS-së (raporti, të dhënat mbështetëse, përmbledhja joteknike, materialet e konsultimit me publikun, Plan i menaxhimit mjedisor dhe social, plani i veprimit mjedisor dhe social sipas nevojës);

e) Gjurmuesi i lejeve që përcakton lejet e nevojshme për aktivitetet e projektit, autoritetin që ka juridiksion, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatet;

f) Matrica e pajtueshmërisë mjedisore

Përveç shërbimeve të përshkruara më sipër, kërkohet, gjithashtu që plani i veprimit për zhvendosjen të përmbushë standardet e IFC-së dhe të institucioneve financiare për sa i përket zhvendosjes dhe shpronësimit të tokës dhe të individëve të prekur nga Projekti në përputhje me legjislacionin shqiptar për shpronësimet.

DETYRA 6: PROJEKTIMI

Palët e treta të kualifikuara për projektimin e digës në Shqipëri do të përgatisin konceptidenë e projektit, në përputhje me kodet dhe standardet shqiptare dhe ndërkombëtare, nëse nuk bihet

dakord ndryshe, dhe do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

a) është miratuar Kontrata dhe shqyrtimi i raportit të fillimit;

b) modelimi i sistemit të informacionit gjeografik;

c) shqyrtimi i opsionit të preferuar:

1. Raporti paraprak;

2. Raporti përfundimtar i opsioneve;

d) Baza e raportit të projektimit;

1. Raporti paraprak;

2. Raporti përfundimtar, që përfshin:

- përshkrimin e përgjithshëm të objekteve, qëllimin e projektit, parametrat operacionale;

- përshkrimi i materialeve të nënsipërfaqes dhe rreziqet shoqëruese;

- krahasimi i opsionit të projektimit dhe arsyet për opsionin e vendndodhjeve të aksit dhe të nënobjekteve;

- aksi i digës dhe nënobjektet e saj;

- parimet kryesore të metodave të llogaritjes së digës dhe nënobjekteve;

- sistemet e telekomunikacionit dhe sisteme të tjera të nevojshme për komunikimin mes objekteve dhe institucioneve përkatëse;

- identifikimi dhe specifikimet për pajisjen elektrike të lidhura me projektin;

- identifikimi dhe specifikimet për sistemet e pajisjeve të matjeve dhe të kontrollit të disponueshme në digë dhe në nënobjekte;

- raporti hidrologjik që përcakton lëvizjet hidrologjike të ujit në digë, në rast shkarkimi maksimal, shkarkimi e detyruar dhe çarjen e mundshme të digës;

- planet dhe skicat për ndërtimin e digës dhe nënobjekteve;

- llogaritjet e volumeve dhe të zonës së ujëmbledhësit dhe volumni total i ujit brenda ujëmbledhësit;

- specifikimet e parametrave të rregullores operacionale.

- I gjithë raporti teknik i përgatitur gjatë fazës 1, duke përfshirë raportet gjeologjike, gjeoteknike, sizmike, hidrologjike, topografike, të zonave të ujëmbledhësit dhe të tokave të prekura, VNMS-në, gjeodinamike dhe raporte të tjera të përcaktuara në këtë shtojcë.

e) ndërtimi i modelit BIM 3D (Modelimi i informacionit të ndërtesës) për zbatimin;

f) libri i punimeve (*Scope Book*) për fazën 2;



g) ndërveprimet e pronarit me detaje të përcaktuara të koordinatave dhe lidhjeve;

h) kërkesat e Centralit për Komponentë dhe Struktura Mbështetëse Shtesë;

i) kërkesat e kolaudit dhe çdo kërkesë tjetër lidhur me komisionimin;

j) raporti gjeoteknik bazë;

k) projekti paraprak duke përfshirë optimizimin e projektit për të zbutur rreziqet gjatë zbatimit për sa më poshtë:

1. Skema paraprake e procesit dhe instrumenteve;

2. Diga dhe strukturat e lidhura;

3. Vija ujore;

4. Centrali, nënstacioni dhe tuneli i shkarkimit;

5. Linjat e transmetimit;

6. Rrugët lidhëse dhe urat, punimet civile;

7. Sistemet elektrike/të procesit dhe projektimi fizik;

8. Përcaktimi i sasive kryesore të mallrave;

9. Përcaktimi i strategjisë së komisionimit dhe i arkitekturës së sistemeve dhe kufijve;

10. Plani i zbatimit inxhinierik, duke përfshirë grafikun e orëve të punëve inxhinierike.

DETYRA 7: PLANI I ZBATIMIT TË PROJEKTIT

Bechtel do të përgatisë Planin e Zbatimit të Projektit, që përfshin:

a) ndërlidhjet, sekuencat dhe kufizimet për ndërtimin;

b) planin e trajnimit të forcës punëtore;

c) materialet e ndërtimit dhe planin total të burimeve;

1. Materialet e ndërtimit;

2. Plani i përgjithshëm i prokurimit;

3. Strategjia e përgjithshme e furnizimit;

d) planin e objekteve të përkohshme, duke përfshirë kampin, zyrat, kantierin, zonat e prodhimit dhe të verifikimit të cilësisë;

e) plani i ngritjes së ngarkesave të rënda;

f) plani dhe masat e mbushjes.

DETYRA 8: ZHVILLIMI I VENDIT TË PROJEKTIT

Palët e treta do të shqyrtojnë dhe kryejnë një vlerësim të thelluar për sa më poshtë:

a) përmirësimin e tokës;

b) profilimin dhe drenazhimin;

c) rregullimin e peizazhit.

DETYRA 9: PLANI I IMPLEMENTIMIT DHE I ZBATIMIT

Palët e treta do të asistojnë Klientin në përgatitjen e një skice që më vonë do të përbëjë bazën e planit të zbatimit:

a) programi i projektimit dhe ndërtimit;

b) plani i dorëzimit të Projektit; duke përfshirë;

- qasjen e propozuar për kryerjen e ndërtimit;

- studimet e kryera për vendndodhjen e materialeve të ndërtimit dhe të karrierve që do të shfrytëzohen për fazën 2;

- vendndodhjet e zonave të identifikuar ujore për fazën 2;

- skicat dhe specifikimet e ndërtimit të rrjetit rrugor dhe të objektit;

- objektet e shërbimit dhe të magazinimit për të mbështetur zbatimin e punimeve;

- identifikimin dhe specifikimet e pajisjeve të nevojshme dhe zonave për të mbështetur zbatimin e punimeve;

- vendndodhjen e aksesit për ujë, puse, rërë dhe materiale të tjera në zonë dhe rreth zonës, të nevojshme për të mbështetur zbatimin e punimeve në fazën 2;

c) strategjia e ndarjes së përgjegjësi për zbatimin e projektit;

d) struktura e ndarë sipas zërave të punimeve të Projektit.

DETYRA 10: OPSIONET E FINAN-CIMIT

Bechtel-i do të ndihmojë Klientin me identifikimin, gjetjen dhe sigurimin e mbështetjes financiare nga institucionet financiare që kanë shprehur interes për të mbështetur projektin.

Pavarësisht nga sa më sipër, presim që Klienti të kontrakttojë shërbimet e një këshilltari financiar (FA), pasi është e qartë që roli i *Bechtel*-it nuk e përfshin atë shërbim. FA do të shqyrtojë të gjitha aspektet financiare që nuk janë përgjegjësi e Klienti dhe do të garantojë përcaktimin dhe përmbushjen e etapave të arritshme. Si pjesë e mbështetjes sonë të vazhdueshme për Projektin, *Bechtel*-i do të mbështesë Klientin (dhe FA-në e emëruar prej tij) me sa më poshtë:

a) asistimi i Klientit për të përgatitur objektin e punës për FA-në;

b) diskutimet me huadhënës të mundshëm për të marrë paraprakisht kushtet e përgjithshme për huat;



c) marrja e shprehjeve të interesit nga ECA-të dhe DFI-të përkatëse, sipas rastit dhe kur është e mundur;

d) asistimi i FA-së gjatë përgatitjes së planit financiar dhe materialeve financiare, për të mundësuar diskutimet mes Klientit dhe huadhënësve;

e) shqyrtimi i strategjisë së prokurimit që do t'i shërbejë planit të financimit;

f) mbështetja në koordinimin me palët kryesore për rakordimin e kërkesave të dokumentacionit të huadhënësve dhe, sipas rastit, të ECA-ve dhe DFI-ve; dhe

g) koordinimi i takimeve mes ekipit ES&H të *Bechtel*-it, Klientit dhe ECA-ve për të ndihmuar me rakordimin e kërkesave të VNMS-së.

DETYRA 11: PREVENTIVI PARAPRAK I SASIVE/KOSTOVE

Bazuar në analizat dhe gjetjet e mësipërme, përgatitet:

a) preventivi paraparak i sasive për Projektin hidroenergetik të Skavicës;

b) preventivi paraparak i kostove për Projektin e HEC Skavica për të mbështetur një preventim të klasës 5 të standardeve Ndërkombëtare të AACE-së (Shoqata për Avancimin e Inxhinierisë së Kostos).

RAPORTET

a) Raportprogreset mujore

Bechtel-i dorëzon raportprogrese mujore mbi konstatimet, shërbimet e kryera dhe hetimet, sipas rastit, në zbatim të kërkesave të përcaktuara në këtë shtojcë 1. Raportet identifikojnë, sipas rastit, vështirësitë reale dhe të parashikuara dhe vonesat në kryerjen e punimeve, shkaqet e tyre dhe mënyrat e propozuara për zgjidhjen e tyre;

b) drafraporti i dërguar për miratim të Klientit;

a) produktet e Raportit përfundimtar;

b) përmbledhje e të gjitha gjetjeve;

c) diskutimi i opsioneve të ndryshme;

d) rekomandime;

e) përfshirja e të dhënave historike në shtojcë; dhe

f) kopjet fizike dhe elektronike të raportit.

Bechtel-i nuk garanton se supozimet e përcaktuara në raportet e tij do të realizohen në të vërtetë. Shërbimet nuk përfshijnë realizimin, mbikëqyrjen ose administrimin e punimeve fizike në lidhje me Projektin për fazën e dytë. Programi dhe kalendar për përfundimin e shërbimeve

aktualisht parashikohet të jetë 18 muaj nga data e hyrjes në fuqi, që do të konfirmohet në Programin dhe kalendarin e Projektit.

TË NDRYSHME

1. Klienti miraton dhe dërgon njoftimet me shkrim për të gjitha projektimet, skicimet dhe përshkrimet e detajuara të përgatitura nga palët e treta dhe të dorëzuara nga *Bechtel*-i, të cilat do të trajtohen si “Specifikime”.

2. Klienti do t'i japë *Bechtel*-it dokumentacionin ekzistues në kopje fizike, për investigimet gjeoteknike, gjeologjike, hidraulike, hidrologjike, matjet topografike, studimin për matjen e sedimenteve, normat ditore të rrjedhjes në dalje të digave të tjera të Drinit, informacionin meteorologjik vendës dhe studime të tjera përkatëse që do të mbështesin kryerjen e shërbimeve.

3. Klienti do të mbështesë *Bechtel*-in, kur është e arsyeshme, për të marrë të drejtat e aksesit të tokës për të gjitha studimet që do të ndërmerren (“Vendi i Projektit”), për digën, rezervuarin dhe zarfin/et e linjës së Transmetimit. Mbështetje në menaxhimin e bashkëveprimit me banorët dhe Bashkitë, sipas kërkesës.

4. Klienti do të ndihmojë *Bechtel*-in, duke i dhënë të gjithë informacionin për lidhjet e synuara me rrjetin e transmetimit.

5. Klienti rimbursen dhe mban të padëmtuar *Bechtel*-in dhe Grupin e tij në lidhje me të gjitha pretendimet, dëmet, detyrimet, humbjet dhe shpenzimet e pësuar ose të kryera nga *Bechtel*-i si rezultat i gabimeve dhe mangësive në specifikime.

6. Klienti miraton Programin e Projektit, i cili bazohet mbi aktivitetet e kryera dhe ka kohëzgjatje të përcaktuar për çdo aktivitet.

ANEKSI 1

MENAXHIMI I TË TRETËVE

Për të shmangur dyshimet, termi “Të tretë” i përdorur në këtë shtojcë përfshin çdo person ose subjekt i emëruar nga *Bechtel*-i për të kryer shërbimet e menaxhimit të projektit, shërbimet e vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social (“VNMS”) dhe shërbime menaxhimi, si dhe punime dhe shërbime të tjera të dakordësuara mes Palëve në lidhje me shërbimet.

**I. Përgatitja dhe prokurimi**

a) Klienti miraton dhënien e kontratës të tretëve.

II. Kushtet e Kontratës

a) Palët synojnë që kushtet e kontratave të të tretëve të jenë në përputhje me paragrafët më poshtë, por pranojnë se duhen rishikuar për të reflektuar komentet e të tretëve.

b) Kontratat e të tretëve lidhen mes palës së tretë dhe *Bechtel*-i. (Gjithsesi, kjo nuk kufizon apo përjashton përgjegjësinë e Klientit, për: i. aspektet e VNMS-së; ose ii. projektidenë siç përcaktohet në Kontratë; ose iii. për çdo çështje tjetër për të cilën Klienti është përgjegjës sipas Kontratës ose ligjit të zbatueshëm, duke përfshirë miratimin e VNMS-së dhe/ose të projektit nga autoritetet përkatëse.)

c) Afati i kontratës për të tretët rregullohet nga ligjet e Anglisë dhe Uellsit.

d) Klienti mund të ngrejë pretendime ndaj të tretëve përmes: i. të drejtave të ekzekutimit të kushteve të kontratës ndaj të tretëve, sipas ligjit për Kontratat (Të drejtat e të tretëve) të vitit 1999 dhe/ose ii. të drejtave të transferimit të benefiteve të kontratës; dhe/ose iii. të drejtave për të marrë garanci kolaterali (kryesisht në formën e përcaktuar në këtë shtojcë, me ndryshimet që mund të bihen dakord, në mënyrë të arsyeshme, mes palëve) dhe/ose iv. të drejtave për të transferuar kontratën (kryesisht në formën e përcaktuar në këtë shtojcë, me ndryshimet që mund të bihen dakord, në mënyrë të arsyeshme, mes palëve).

III. Administrimi dhe menaxhimi i Kontratës

Pas nënshkrimit të kontratës me të tretët, *Bechtel*-i:

a) administron kushtet e kontratave të të tretëve, duke vepruar me paanësi dhe me drejtësi, dhe duke konsideruar të drejtat e *Bechtel*-it, të të tretëve dhe të Klientit;

b) monitoron dhe mat ecurinë e punimeve të palës së tretë, sipas rastit, duke përdorur mjete të tilla si procedura *Primavera* dhe procedura “Raporti i ecurisë dhe performancës inxhinierike” (EPPR) që përdoren nga *Bechtel*-i;

c) vazhdon të menaxhojë, sipas rastit, programin kryesor të projektimit;

d) përgatit dhe menaxhon me palën e tretë një nënprogram të punës së tyre të ndërlidhur me programin kryesor të projektimit ose me programe të tjera përkatëse;

e) dërgon raporte mujore lidhur me ecurinë e shërbimeve, duke theksuar çdo vonesë ose çështje të tjera që duhen trajtuar, si dhe zgjidhjet e propozuara nga pala e tretë për problemet teknike, bazuar në të dhënat e ofruara nga vet pala e tretë.

IV. Baza e shërbimeve të menaxhimit të të tretëve

a) *Bechtel*-i i kryen shërbimet e menaxhimit të të tretëve, duke ushtruar atë shkallë kujdesi, aftësish dhe vigilance, që pritet normalisht nga një konsulent i kualifikuar dhe kompetent, me përvojë në realizimin e shërbimeve me natyrë të ngjashme.

b) Përgjegjësia e *Bechtel*-it për mosrealizimin e shërbimeve të menaxhimit të të tretëve në përputhje me këtë shtojcë ose me këtë Kontratë kufizohet në rikryerjen nga e para të shërbimeve të menaxhimit të të tretëve me kostot dhe shpenzimet e *Bechtel*-i.

c) Përveç nga sa parashikohet në paragrafin “b” më sipër, në masën maksimale të lejuar me ligj, *Bechtel*-i nuk ka asnjë detyrim ndaj Klientit ose ndaj të tretëve, qoftë sipas kontratës apo sipas ligjit (përfshirë pakujdesinë) apo çdo akti tjetër, në lidhje me projektimin e Projektit ose me veprime apo mosveprime të të tretëve, dhe Klienti çliron, mbron, dëmshpërblen dhe mban të padëmtuar *Bechtel*-in dhe grupin e tij nga dhe kundrejt çdo pretendimi, humbjeje, përgjegjësie, kërkesë, vendimi, dëmi, kostoja ose shpenzimi që i shkaktohet dhe/ose kryhet nga *Bechtel*-i (duke përfshirë ato që lindin nga fatalitetet ose lëndimet personale dhe/ose dëmtimi i pronës), në lidhje me to.

d) *Bechtel*-i paguhet në përputhje me shtojcën 2 për kryerjen e shërbimeve të menaxhimit të të tretëve.

Forma e garancisë së kolateralit

Datë 20[••]

[VENDOS EMRIN]

dhe

KORPORATA

ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE
SHA

**GARANCIA E KOLATERALIT, NË
LIDHJE ME PROJEKTIN E SKAVICËS**



KJO MARRËVESHJE LIDHET NË DATËN 20[XX]

NDËRMJET:

1. [Vendos emrin] e [XXX] (“Konsulenti”); dhe

2. **KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SHA** një shoqëri aksionare shqiptare me pronësi publike, e themeluar dhe që vepron në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë me seli në adresën [•] e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), me numër unik të identifikimit të shoqërisë – NUIS J61817005F (“Klienti”).

MEQENËSE:

A. **Bechtel Limited – Dega në Shqipëri**, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri, me numër unik identifikimi të shoqërisë, dhe e regjistruar në adresën *Sky Tower*, kati 5, suite 2, Tiranë, Shqipëri, (“**Bechtel**”) Konsulenti i emëruar sipas kontratës (“**Emërimi**”) për të ofruar shërbimet [projektimin][VNMS][të tjera] (“**Shërbimet**”) në lidhje me projektin e Skavicës (“**Projekti**”).

B. Konsulenti njeh dhe pranon se Klienti ka interes për shërbimet e ofruara, sipas Marrëveshjes dhe ka rënë dakord të hyjë në një marrëdhënie kontraktuale të drejtpërdrejtë me Klientin sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

TANI PËR RRJEDHOJË duke qenë se Klienti ka emëruar *Bechtel*-in për të kryer shërbime të caktuara në lidhje me Projektin dhe *Bechtel*-i ka emëruar Konsulentin për të kryer shërbime të caktuara, dhe pa cenuar të drejtat dhe detyrimet e Konsulentit për ushtrimin e emërimit të tij, **LIDHET KJO MARRËVESHJE** si më poshtë:

1 Konsulenti i deklaron dhe garanton Klientit se:

1.1 Në lidhje me shërbimet e kryera dhe që do të kryhen nga Konsulenti në kuadër të emërimit të tij, ka ushtruar dhe do të vazhdojë të ushtrojë kujdesin, vigjilencën dhe aftësitë e arsyeshme që priten nga një konsulent profesionist i kujdesshëm, kompetent dhe me kualifikimin e duhur, i angazhuar dhe me përvojë në aktivitetin e ofrimit të shërbimeve [projektim][VNMS][të tjera] për projekte me përmasa, objekt, natyrë dhe kompleksitet të ngjashëm dhe në vendndodhje të ngjashme me Projektin; dhe

1.2 Ka kryer dhe do të vazhdojë të kryejë shërbimet, dhe ka përmbytur dhe do të vazhdojë të përmbyshë detyrimet

dhe detyrat e tjera të tij në kuadër të emërimit, në përputhje me emërimin dhe në respektim të ligjeve të zbatueshme.

2. Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligjet e Anglisë dhe të Uellsit.

3. Mosmarrëveshjet ose divergjencat që lindin nga ose në lidhje me hartimin, interpretimin, vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje dhe të gjitha çështjet apo problematikat e tjera të çarëdolloj natyre që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, do të zgjidhen përfundimisht nga arbitrazhi ndërkombëtar, në përputhje me Rregullat e Pajtimit dhe të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Numri i arbitrave do të jetë tre. Secila Palë cakton nga një arbitër dhe më pas këta arbitra bien dakord për të caktuar arbitrin e tretë. Kur arbitrat e caktuar nga Palët nuk mund të bien dakord për arbitrin e tretë, atëherë arbitri i tretë zgjidhet nga Presidenti i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Procedura e arbitrazhit bazohet në ligjin material të Anglisë dhe Uellsit. Gjuba e përdorur për procesin e arbitrazhit është gjuba angleze. Vendi i arbitrazhit është Londra, Angli.

NË DËSHMI TË SA MË LARTË

Konsulenti dhe Klienti nënshkruajnë këtë Marrëveshje në datën e shënuar më sipër në hyrje të saj.

Nënshkruar nga _____)
për [KONSULENTIN]

Nënshkruar nga _____)
për **KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SHA**

Formulari i Kontratës së Transferimit

Datë 20[.]

**KORPORATA
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE
SHA
DHE
BECHTEL LIMITED
DHE
[VENDOS EMRIN]**

**TRANSFERIMI I EMËRIMIT NË
LIDHJE ME PROJEKTIN E SKAVICËS**

**KJO KONTRATË TRANSFERIMI
LIDHET MË 20[XX]**

**NDËRMJET:**

1. **KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SHA**, një shoqëri aksionare shqiptare me pronësi publike, e themeluar dhe që vepron në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë me seli në adresën [•] e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), me numër unik të identifikimit të shoqërisë – NUIS J61817005F (“**Klienti**”);

2. **Bechtel Limited – Dega në Shqipëri**, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit të Shqipërisë, me numër unik identifikimi të shoqërisë....., dhe me adresë të regjistruar Sky Tower, kati 5, suita 2, Tiranë, Shqipëri (“**Bechtel**”).

3. [**Konsulent**] i [XXX] (“**Konsulent**”), secili prej tyre individualisht referuar si “**Pala**” dhe bashkërisht si “**Palët**”.

MEQENËSE:

A. *Bechtel*-i ka lidhur një marrëveshje emërimi me Konsulentin [vendos datën] (“**Emërimi i Konsulentit**”), sipas së cilës Konsulentit bie dakord të kryejë shërbimet [projektim][VNMS][të tjera] në lidhje me projektin e Skavicës, përkundrejt shumave të përcaktuara në Marrëveshjen e Emërimit të Konsulentit.

B. Palët dëshirojnë që të gjitha të drejtat dhe përfitimet e *Bechtel*-it, sipas Marrëveshjes së Emërimit të Konsulentit t’i transferohen Klientit, sipas përcaktimeve, kushteve dhe afateve të parashikuara më poshtë.

C. Palët, gjithashtu, dëshirojnë që detyrat, detyrimet dhe përgjegjësitë e *Bechtel*-it sipas Marrëveshjes së Emërimit të Konsulentit t’i transferohen Klientit dhe të merren përsipër nga Klienti, sipas përcaktimeve, kushteve dhe afateve të parashikuara më poshtë.

PËR RRJEDHOJË, LIDHET KJO KONTRATË, si më poshtë:**1. Interpretimi**

1.1 Termat me gërmë të madhe që përdoren por nuk përkufizohen në këtë Marrëveshje (përfshirë pjesën hyrëse të saj) kanë të njëjtin kuptim që u jepet atyre në Marrëveshjen e Emërimit të Konsulentit.

2. Transferim

2.1 *Bechtel*-i i transferon plotësisht Klientit të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij ndaj Konsulentit, sipas Marrëveshjes për Emërimin e Konsulentit, duke përfshirë të gjitha të drejtat, përfitimet dhe detyrimet në të gjitha

pretendimet, kërkesat, angazhimet, detyrimet dhe përgjegjësitë në favor dhe në dobi të Bechtel-it.

2.2 *Bechtel*-i jep kështu njoftimin e transferimit të të drejtave dhe detyrimeve të përmendura në nenin 2.1 më sipër dhe Klienti konfirmon marrjen e këtij njoftimi transferimi.

3. Çlirimi dhe shkarkimi i Konsulentit nga përgjegjësia

3.1 *Bechtel*-i çliron dhe shkarkon Konsulentin nga përgjegjësia për të gjitha detyrat, angazhimet dhe detyrimet e çfarëdolloj natyre ndaj *Bechtel*-it, të cilat rrjedhin nga Marrëveshja e Emërimit të Konsulentit, qoftë të lindura para apo pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

4. Përbushja dhe marrja përsipër e përgjegjësisë

4.1 Konsulentit bie dakord të përbushë dhe kryejë të gjitha detyrat dhe detyrimet dhe të mbajë e marrë përsipër përgjegjësitë që rrjedhin nga Marrëveshja e Emërimit të Konsulentit për dobi të Klientit dhe pranon përgjegjësinë e Klientit ndaj Konsulentit sipas Marrëveshjes për Emërimin e Klientit njësoj sikur Klienti të ishte Palë në Marrëveshjen e Emërimit të Konsulentit që prej datës së nënshkrimit të saj, në vend të *Bechtel*-i.

5. Çlirimi, shkarkimi nga përgjegjësia, përbushja dhe marrja përsipër e përgjegjësisë nga Klienti**5.1 Klienti:**

a) çliron dhe shkarkon nga përgjegjësia *Bechtel*-in për të gjitha detyrat, angazhimet, detyrimet dhe përgjegjësitë e çfarëdolloj natyre, që rrjedhin nga dhe parashikohen në Marrëveshjen e Emërimit të Konsulentit; dhe

b) pranon përgjegjësinë e Konsulentit sipas Marrëveshjes së Emërimit të Konsulentit; dhe

c) bie dakord të përbushë dhe kryejë të gjitha detyrat dhe detyrimet dhe merr përsipër përgjegjësitë e *Bechtel*-it, që rrjedhin nga Marrëveshja e Emërimit të Konsulentit në favor të Konsulentit njësoj sikur Klienti të ishte Palë në Marrëveshjen e Emërimit të Konsulentit që prej datës së nënshkrimit të saj, në vend të *Bechtel*-i.

6. Palët e treta

6.1 Asgjë në këtë Marrëveshje nuk u jep dhe as nuk synon tu japë të tretëve përfitime apo të drejta për të ekzekutuar kushtet e kësaj Marrëveshjeje, sipas ligjit për kontratat të vitit 1999 (Të drejtat e palëve të treta).

7. Të përgjithshme

7.1 Secila Palë herë pas here dhe sa herë që i kërkohet nga Pala tjetër do të kryejë me kostot dhe



shpenzimet e veta ose do të sigurojë kryerjen e të gjitha akteve dhe/ose do të nënshkruajë ose sigurojë nënshkrimin e të gjitha dokumenteve, sipas formës që konsiderohet e nevojshme në mënyrë të arsyeshme nga Pala që e ka kërkuar këtë gjë, me qëllim zbatimin e plotë të kësaj Kontrate dhe me qëllimin për t'i siguruar saj Pale përfitimin e plotë të të drejtave, kompetencave dhe mjeteve ligjore që i janë akorduar asaj Pale sipas kësaj Marrëveshjeje.

7.2 Kjo Kontratë mund të nënshkruhet në disa kopje nga Palët. Secila prej kopjeve përbën këtë Kontratë origjinale, por të gjitha kopjet së bashku përbëjnë një dhe të vetmen Kontratë dhe secila Palë mund ta ekzekutojë këtë Kontratë, duke nënshkruar cilëndo apo më shumë kopje të saj.

7.3 Asnjë ndryshim i kësaj Kontrate nuk është i detyrueshëm për Palët nëse nuk bëhet me dokument me shkrim të nënshkruar nga Palët.

8. Ligji rregullues dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

8.1 Kjo Kontratë rregullohet nga ligjet e Anglisë dhe të Uellsit.

8.2 Çdo mosmarrëveshje ose divergjencë që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë zgjidhet

përfundimisht nga arbitrazhi ndërkombëtar në përputhje me Rregullat e Pajimit dhe të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Numri i arbitrave do të jetë tre. Secila Palë emëron nga një arbitër. Procedura e arbitrazhit bazohet në ligjin material të Anglisë dhe Uellsit. Gjuha e përdorur për procesin e arbitrazhit është gjuha angleze. Vendi i arbitrazhit është Londra, Angli.

NË DËSHMI TË SA MË LART, Palët në këtë Kontratë e nënshkruajnë këtë Kontratë në ditën, muajin dhe vitin e shënuar më sipër.

Nënshkruar nga _____)
për **KORPORATA ELEKTROENER-
GJETIKE SHQIPTARE SHA**

Nënshkruar nga _____)
për **BECHTEL LIMITED – Dega në
Shqipëri**

Nënshkruar nga _____)
për **[KONSULENTIN]**

SHTOJCA 2 KOMPENSIMI

1. Kompensimi

1.1 Kompensimi nënkupton shumat që duhet t'i paguhet *Bechtel*-it sipas tarifave për orë për çdo anëtar të stafit në bazë të vendndodhjes ku ata punojnë (pa taksat e aplikueshme) ("Tarifat e Stafit") dhe rimbursimet e përcaktuara më poshtë, për kryerjen e shërbimeve:

Tabela 1. Tarifat e stafit në euro

Pozicioni vendndodhja e punës	Mbësh-tetje dhe administrim	Teknik	Teknik i lartë	Inxhinier	Kryeinxhinier	Menaxher/ supervizor	Menaxher	Menaxheri inxhinierik	Menaxher projekti/ drejtor
Dubai							180		
Hjuston			109	124	143	153	168		
Londër			97	110	117	125	145		300
New Delhi	41	47	52	58	68	78	84		
Projekti				110					
Reston	88		113	128	140	153	165	290	
San Francisco					158				



Tabela 2. Dietat për biletat e udhëtimit, akomodimin dhe shpenzimet ditore për udhëtimet e punës

Dietat për biletat e udhëtimit për udhëtime pune në euro		Dietat për akomodimin dhe shpenzimet ditore për udhëtime pune në euro	
MB - Shqipëri	300	Në Shqipëri	100
SHBA - Shqipëri	3.000	Në MB	300
Indi - Shqipëri	1.000	Në Indi	100
Emiratet e Bashkuara Arabe - Shqipëri	1.000		
SHBA - MB	3.000		
SHBA - Indi	5.000		
MB - Indi	3.000		

Tabela 3. Totali i kostos

Kostot për tarifatat e stafit	6 000 000,00 €
Specialist teknik tjetër	1 000 000,00 €
Kostot e udhëtimit dhe dietave për tabelën 2	135 000,00 €
Palët e treta	
Fizibiliteti dhe projektimi	2 800 000,00 €
Turbinat dhe pajisjet	300 000,00 €
VNMS	650 000,00 €
Akresi për studimet gjeoteknike	1 900 000,00 €
Inspektimet gjeoteknike	1 500 000,00 €
Studimet - LIDAR, lumi dhe hidrologjia	500 000,00 €
Tarifa e menaxhimit të të tretëve	612 000,00 €
Kontigjenca	450 000,00 €
Alokimi buxhetor për Planin e Veprimit të Zhvendosjes/planin e risistemimit*	200 000,00 €
Totali i kostos (pa TVSH)	16 047 000,00 €

*Buxheti për Planin e Veprimit të Zhvendosjes dhe planin e risistemimit është një vlerë e parashikuar e rumbullakosur, vlera reale do të përcaktohet gjatë fillimit të Fazës 1. Plani i Veprimit për Zhvendosjen, konkretisht prokurimi, struktura tregtare dhe finalizimi i objektit të kësaj pune do të dakordësohen gjatë fillimit të Fazës 1. Klienti do të jetë përgjegjës për të gjitha aspektet e analizës financiare, për procesin e shpronësimit të tokës, për risistemimin e personave të prekur dhe për kërkesa të tjera në kuadër të Planit të miratuar të Zhvendosjes

Plani i pagesës së parashikuar të etapave

Detyrimi i Klientit për pagesën e parë që nuk është pasqyruar në planin e pagesës së parashikuar të etapave është pagesa paradhënie prej tre milionë eurosh (€3,000,000.00), që përbën kusht paraprak në përputhje me nenin 11.1 të Kontratës. Me marrjen e pagesës së paradhënies, *Bechtel*-i do të nisë realizimin e etapave të përcaktuara në tabelën më poshtë. Në përputhje me këtë Kontratë, pagesa paradhënie do t'i ripaguhet Klientit përkundrejt faturave të fundit që në mënyrë kumulative përbëjnë totalin e balancës së pagesës paradhënie.

Ripagimi i pagesës paradhënie është parashikuar të fillojë gjatë muajit të 12-të të shërbimeve, por data e saktë e fillimit të ripagimit do të bazohet në projeksionet e fluksit të parasë, të përditësuara rregullisht dhe të pasqyruara në raportin mujor. Për të shmangur çdo dyshim, Klienti nuk do t'i paguajë *Bechtel*-it një vlerë kumulative më të madhe se totali i kostos, përveçse nëse bihet dakord ndryshe mes Palëve në përputhje me këtë Kontratë.



Numri i Etapës	Etapa	Përshkrimi i etapave	Shuma e Parashikuar e Etapës (pa TVSH)	Muaji i parashikuar, i llogaritur nga Data Efektive ku <i>Bechtel</i> parashikon të lëshojë faturën për Klientin
M 1	Vlerësimi paraprak, Mbledhja fillestare e të dhënave dhe finalizimi i rakordimit të objektit	Raporti – Përgatitja, rakordimi dhe vendimet kryesore	€ 50,000	1
M 2.1	Finalizimi i Kontratës për të tretët	Nënshkrimi i kontratave me të tretët për Projektimin dhe VNMS-në	€ 100,000	1
M 2.2		Nënshkrimi i kontratave me të tretët për studimet gjeoteknike, rilevimet dhe turbinën	€ 50,000	1
M 3.1	Matjet topografike	Konfirmimi i pikave/hartës së kontrollit të fluturimit	€ 50,000	1
M 3.2		Përfundimi i fluturimit për LIDAR	€ 150,000	2
M 3.3		Dorëzimi i raportit përfundimtar	€ 100,000	3
M 4.1	Studimi batimetrik	Sondimi dhe mbledhja e të dhënave hidrometeorologjike	€ 100,000	2
M 4.2		Dopler Profili 1 dhe mbledhja e të dhënave hidrometeorologjike	€ 50,000	3
M 4.3		Dorëzimi i raportit përfundimtar	€ 100,000	3
M 5.1	Rrugët lidhëse	Finalizimi i planit për rrugën lidhëse	€ 100,000	1
M 5.2		Rruga lidhëse nr. 1 - Përfunduar	€ 350,000	2
M 5.3		Rruga lidhëse nr. 2 - Përfunduar	€ 350,000	3
M 5.4		Rruga lidhëse nr. 3 - Përfunduar	€ 350,000	4
M 5.5		Rruga lidhëse nr. 4 - Përfunduar	€ 350,000	5
M 5.6		Rruga lidhëse nr. 5 - Përfunduar	€ 500,000	6
M 6.1	Inspektimet gjeoteknike	Raporti i studimit dokumentar gjeologjik dhe gjeoteknik	€ 50,000	2
M 6.2		Mobilizimi i sondës së shpimit	€ 350,000	3
M 6.3		Përfundimi i shpimit të rrugëve lidhëse	€ 500,000	4
M 6.4		Dorëzimi i raportit zyrtar nr. 1	€ 175,000	5
M 6.5		Dorëzimi i raportit zyrtar nr. 2	€ 175,000	6
M 6.6		Raporti përfundimtar për inspektimet gjeoteknike	€ 500,000	7
M 7.1	Analiza dhe raporte të tjera të Projektit	Raporti i projektit - Studimi sizmik dokumentar - Raporti paraprak	€ 50,000	2



M 7.2		Raporti i projektit - Studimi sizmik dokumentar - Raporti përfundimtar	€ 50,000	3
M 7.3		Raporti i Projektit - Modelimi hidrologjik - Raporti paraprak	€ 50,000	3
M 7.4		Raporti i Projektit - Modelimi hidrologjik - Raporti përfundimtar	€ 50,000	5
M 7.5		Raporti i Projektit - Modelimi i përmbytjes - Raporti paraprak	€ 75,000	3
M 7.6		Raporti i projektit - Modelimi i përmbytjes - Raporti përfundimtar	€ 50,000	5
M 7.7		Raporti i projektit - Studimi ndryshimeve klimatike - Raporti Paraprak	€ 130,000	5
M 7.8		Raporti i Projektit - Studimi ndryshimeve klimatike - Raporti përfundimtar	€ 130,000	8
M 7.9		Raporti i Projektit - Analiza e çarjes së digës - Raporti paraprak	€ 150,000	9
M 7.10		Raporti i Projektit - Analiza e çarjes së digës - Raporti përfundimtar	€ 250,000	11
M 7.11		Raporti i Projektit - Studimi ose monitorimi i kreshtës së rezervuarit - Raporti paraprak	€ 150,000	5
M 7.12		Raporti i Projektit - Studimi ose monitorimi i kreshtës së rezervuarit - Raporti përfundimtar	€ 150,000	7
M 7.13		Raporti i Projektit - Modelimi i detajuar i fuqisë dhe energjisë - Raporti paraprak	€ 100,000	5
M 7.14		Raporti i Projektit - Modelimi i detajuar i fuqisë dhe energjisë - Raporti përfundimtar	€ 100,000	6
M 8.1	Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social	Studimi në Pranverë për VNMS - përfunduar	€ 17,500	1
M 8.2		Studimi në verë për VNMS - përfunduar	€ 35,000	4
M 8.3		Studimi në vjeshtë për VNMS - përfunduar	€ 35,000	8
M 8.4		Studimi në dimër për VNMS - përfunduar	€ 35,000	10
M 8.5		Raporti i planit të angazhimit për VNMS-në	€ 50,000	2
M 8.6		Raporti i <i>scoping</i> për VNMS-në	€ 50,000	3
M 8.7		Studimet bazë për VNMS - Plani fillestar	€ 50,000	3
M 8.8		Studimet bazë për VNMS - Raporti paraprak i	€ 200,000	4



		përditësuar nr. 1		
M 8.9		Studimet bazë për VNMS - Raporti paraprak i përditësuar nr. 2	€ 200,000	5
M 8.10		VNMS Vlerësimi i ndikimit dhe plani i menaxhimit - Raporti i planit fillestar	€ 20,000	2
M 8.11		VNMS Vlerësimi i ndikimit dhe plani i menaxhimit - Raporti paraprak i përditësuar nr. 1	€ 50,000	5
M 8.12		VNMS Vlerësimi i ndikimit dhe plani i menaxhimit - Raporti paraprak i përditësuar nr. 2	€ 50,000	8
M 8.13		VNMS Vlerësimi i ndikimit dhe plani i menaxhimit - Raporti paraprak i përditësuar nr. 3	€ 50,000	10
M 8.14		VNMS Vlerësimi i ndikimit dhe plani i menaxhimit - Draftraporti përfundimtar	€ 30,000	11
M 8.15		VNMS Vlerësimi i ndikimit dhe plani i menaxhimit - Raporti përfundimtar	€ 250,000	14
M 8.16		VNMS Matrica e lejeve - Plani paraprak	€ 50,000	3
M 8.17		VNMS Matrica e lejeve - Plani përfundimtar	€ 150,000	4
M 8.18		Konsultimet publike - Fillestare	€ 100,000	3
M 8.19		Konsultimet publike - Konsultimi për draft-VNMS-në	€ 150,000	11
M 9.1	Produktet e Projektimit	Krijimi i modelit BIM - Paraprak	€ 100,000	3
M 9.2		Krijimi i modelit BIM - Përfundimtar	€ 150,000	5
M 9.3		Raporti i opsioneve/Konfirmimi i vendndodhjes së digës - Paraprak	€ 100,000	4
M 9.4		Raporti i opsioneve/Konfirmimi i vendndodhjes së digës - Përfundimtar	€ 250,000	8
M 9.5		Raporti i bazës së projektimit - Paraprak	€ 50,000	2
M 9.6		Raporti i bazës së projektimit - përfundimtar	€ 250,000	8
M 9.7		Modelimi GIS	€ 100,000	5
M 9.8		Plani i mbushjes së rezervuarit	€ 250,000	10
M 9.9		Skicat e Projektit - Diga - konceptuale	€ 250,000	8
M 9.10		Skicat e Projektit - Diga - paraprake	€ 250,000	11
M 9.11		Skicat e Projektit - Vija ujore (vepra e marrjes dhe tunelet	€ 200,000	9



		e shkarkimit) - Konceptuale		
M 9.12		Skicat e Projektit - Vija ujore (vepra e marrjes dhe tunelet e shkarkimit) - Paraprake	€ 250,000	11
M 9.13		Skicat e Projektit - Centrali, tuneli i shkarkimit (Civil, E&M) - Konceptuale	€ 200,000	9
M 9.14		Skicat e Projektit - Centrali, tuneli i shkarkimit (Civil, E&M) - Paraprake	€ 250,000	11
M 9.15		Skicat e Projektit - Nënstacioni i Skavicës - Konceptuale	€ 200,000	9
M 9.16		Skicat e Projektit - Nënstacioni i Skavicës - Paraprake	€ 250,000	11
M 9.17		Skicat e Projektit - Rrugët lidhëse dhe urat - Konceptuale	€ 150,000	6
M 9.18		Skicat e Projektit - Rrugët lidhëse dhe urat - Paraprake	€ 250,000	10
M 9.19		Skicat e Projektit - Linjat e transmetimit - Konceptuale	€ 150,000	7
M 9.20		Skicat e Projektit - Linjat e transmetimit - Paraprake	€ 250,000	10
M 9.21		Dorëzuar sasitë e Projektit Konceptual	€ 300,000	9
M 9.22		Dorëzuar sasitë e Projektit Paraprak	€ 500,000	13
M 10.1	Planifikimi i ndërtimit	Plani i zbatimit të ndërtimit (DoR Matrix)	€ 100,000	3
M 10.2		Programi i fazës 2, niveli 3 (Programi paraprak i zhvillimit)	€ 250,000	8
M 10.3		Plani i Projektit për zbatim	€ 100,000	4
M 10.4		Plani i përgjithshëm i prokurimit	€ 250,000	7
M 10.5		Janë zhvilluar metodologjitë fillestare	€ 200,000	9
M 10.6		Janë identifikuar ndërveprimet/kufizimet kryesore	€ 250,000	10
M 10.7		Strategjia e përgjithshme e furnizimit	€ 200,000	11
M 10.8		Plani i masave të mbushjes së rezervuarit	€ 250,000	12
M 10.9		Plani i ngritjes së ngarkesave me vinç	€ 75,000	12
M 10.10		Strategjia e forcës punëtore, Plani i pajisjeve ndërtimit	€ 200,000	13
M 10.11		Plani përfundimtar i zbatimit të ndërtimit	€ 350,000	15
M 11.1	Raporti i Planit të Zbatimit të Projektit	Plani i Zbatimit të Projektit - Paraprak	€ 350,000	8
M 11.2		Programi faza 2, niveli 3	€ 250,000	12
M 11.3		Plani i Zbatimit të Projektit - Përfundimtar	€ 235,000	14
520	334	S01EB01	Pilocarpine hydrochloride	2 % - 10 ml	flakon	60
521	335	S01EC01	Acetazolamide*	250 mg	tablet	60
522	604	S01EC03	Dorzolamide	2%-5 ml	flakon	60
523	385	S01EC04	Brinzolamide	10mg/ml-5ml	flakon	60
524	337	S01ED01	Timolol	0.5% -5ml	flakon	60
525	528	S01ED51	Latanoprost+Timolol Maleate	50mcg+5mg-2.5 ml	flakon	60
526	527	S01EE01	Latanoprost	0.005% - 2.5ml	flakon	60
527	386	S01EE04	Travoprost	40mcg/ml-2.5 ml	flakon	60
528	485	S01AD51	Travoprost +Timolol	40mcg+5mg/ml -2.5 ml	flakon	60
529	338	S01FA01	Atropine sulphate	1%-10ml	flakon	60
530	606	S01LA04	Ranibizumab	10mg/ml	ampul	60
531	608	S01LA05	Aflibercept 40 mg/ml	40 mg/ml	ampul	60

V**V03 60% - 85% - 100%****TË GJITHA PRODUKTET E TJERA TERAPEUTIKE**

532	339	V03AC01	Deferoxamine	500 mg	pluhur per inj.	100
533	418	V03AC03	Deferasirox	250 mg	tablet	100
534	531	V03AC02	Deferiprone*	500 mg	tablet	100
535	605	V03AE02	Sevelamer Carbonate	800 mg	tablet	85
536	716	V03AC03	Deferasirox	125 mg	tab. shpr.	100
537	717	V03AC03	Deferasirox	500 mg	tabl. shpr.	100
538	735	V03AB21	Potassium iodide	200 mcg	tablet	60
539	762	V03AC03	Deferasirox	90mg	f.c.tabl.	100
540	763	V03AC03	Deferasirox	180 mg	f.c.tabl.	100
541	764	V03AC03	Deferasirox	360 mg	f.c.tabl.	100

V06 85% - 100 %**SHITESA USHQIMORE TË PËRGJITHSHME**

542	406	V06DD	L-Leucine +L-Valine +L-Lysine ...etj	0,0994g + 0,0895g + 0,815g	tablete	85
543	551	V06DE	Aminoacide pa lysine, tryptophan etj... (mixture) Ga 1*	400 gr	paket	100
544	552	V06DE	Aminoacide pa lysine, tryptophan etj... (mixture) Ga 2*	500 gr	paket	100



V07 50 %

TË GJITHA PRODUKTET E TJERA JOTERAPEUTIKE

545	342	V07AB	Aqua bidestillata	2 ml	flakon	50
546	343	V07AB	Aqua bidestillata	5ml	flakon	50
547	344	V07AB	Aqua bidestillata	10ml	flakon	50

PASQYRA II

LISTA E BARNAVE ME MARZHE TË DIFERENCUAR 2021

Marzhi i grosistit 5.5% (barna që tregëtohen në farmacitë e spitaleve)

Kod Bari	Kodi ATC	Principi aktiv	Doza	Forma
55	B03XA01	Epoetin alfa	2000 Nj.N	pre-filled syringe
346	B03XA01	Epoetin beta	2000 Nj. N	pre-filled syringe
544	B03XA01	Epoetin zeta	2000 Nj. N	pre-filled syringe
684	B03XA01	Epoetin alfa	30 000 Nj.N	pre-filled syringe
633	B03XA01	Epoetin zeta	30 000 Nj. N	pre-filled syringe
468	B03XA03	Methoxy Polyethylene Glycol - epoetin beta	50 mcg/0.3 ml	pre-filled syringe
469	B03XA03	Methoxy Polyethylene Glycol - epoetin beta	75 mcg/0.3 ml	pre-filled syringe
470	B03XA03	Methoxy Polyethylene Glycol - epoetin beta	100 mcg/0.3 ml	pre-filled syringe
457	B03XA03	Methoxy Polyethylene Glycol - epoetin beta	120mcg/0.3 ml	pre-filled syringe
458	B03XA03	Methoxy Polyethylene Glycol - epoetin beta	150mcg/0.3 ml	pre-filled syringe
460	B03XA03	Methoxy Polyethylene Glycol - epoetin beta	200mcg/0.3 ml	pre-filled syringe
504	H01AC01	Somatropine	12 mg (36 Nj.N)	pre-filled pen.
503	H01AC01	Somatropine	8 mg	fl.injec.
123	H01AC01	Somatropine	5 mg (15 Nj.N)	pre-filled pen.
770	H01AC01	Somatropin	10 mg	pre-filled pen.
618	H01CB02	Octreotide	30mg/2ml	pluhur për inj.
779	H05BX02	Paricalcitol 5	5 mcg/ml-1 ml	sol. per inh.
486	J05AB14	Valganciclovir Hydrochloride	450 mg	f.c.tabl.
576	J05AF07	Tenofovir	245 mg	f.c.tabl.
748	J05AP55	Sofosbuvir + Velpatasvir	400mg +100mg	f.c.tabl.
749	J05AP57	Glecaprevir + Pibprentasvir	100mg+40mg	f.c.tabl.
665	J05AX65	Ledipasvir + Sofosbuvir	90+400 mg	f.c.tabl.
728	J05AX68	Elbasvir + Grazoprevir 50mg + 100mg	50mg + 100mg	f.c.tabl.
639	L01AD02	Lomustine	40 mg	capsul
707	L01AX03	Temozolomide	100 mg	capsul
708	L01AX03	Temozolomide	250 mg	capsul
577	L01BC06	Capecitabine	150 mg	f.c.tabl.
578	L01BC06	Capecitabine	500 mg	f.c.tabl.
769	L01ED03	Alectinib Hydrochloride	150 mg	hard cap.
778	L01XE25	Trametinib	2 mg	f.c.tabl.
750	L01XC02	Rituximab	1400mg/vial	solu. per inj.
739	L01XC03	Trastuzumab	600 mg / 5 ml	fl.injec.
751	L01XC18	Pembrolizumab	25mg/ml - 4ml	flakon
756	L01XE04	Sunitinib	12.5 mg	hard capsul
757	L01XE04	Sunitinib	25 mg	hard capsul
673	L01XE04	Sunitinib	50 mg	hard cap.
682	L01XE05	Sorafenib	200 mg	f.c.tabl.
705	L01XE08	Dabrafenib	75 mg	hard cap.
539	L01XE08	Nilotinib	150 mg	hard cap.
703	L01XE11	Pazopanib	400 mg	f.c.tabl.
635	L01XE15	Vemurafenib	240 mg	f.c.tabl.
632	L01XE18	Ruxolitinib	20 mg	tablet
736	L01XE27	Ibrutinib	140 mg	hard cap.
715	L01XE33	Palbociclib	100 mg	caps.
710	L01XE33	Palbociclib	125 mg	capsul
714	L01XE33	Palbociclib	75 mg	caps.
723	L01XE42	Ribociclib	200 mg	tablet
487	L01XX28	Imatinib	100 mg	hard cap.
583	L02AE04	Triptorelin	3.75mg	syringe
776	L02BB04	Enzalutamide	40 mg	soft capsul
636	L02BX03	Abiraterone acetate	250 mg	tablet
771	L02BX03	Abiraterone Acetate	500 mg	f.c.tabl.
586	L03AB04	Peginterferon alfa-2a	180mcg/0.5ml	pen
442	L03AB07	Interferon beta - 1a	22 mcg (6 MIU)	pre-filled syringe
443	L03AB07	Interferon Beta - 1a	44 mcg (12 MIU)	pre-filled syringe
425	L03AB08	Interferon Beta -1b	250 mcg/ml (8.000.000 Nj.N)	tret.per inj.



216	L04AA06	Mycophenolate Mofetil	250 mg	capsul
462	L04AA06	Mycophenolate Mofetil	500 mg	tablet
437	L04AA06	Mycophenolic Acid	180 mg	f.c.tabl.
438	L04AA06	Mycophenolic Acid	360 mg	f.c.tabl.
582	L04AA18	Everolimus	0.25mg	table shpr.
581	L04AA18	Everolimus	0.5 mg	tablet
641	L04AA18	Everolimus	10 mg	tablet
584	L04AA27	Fingolimod	0.5 mg	hard caps.
685	L04AA29	Tofacitinib	5 mg	f.c.tabl.
662	L04AB01	Etanercept	25 mg	pre-filled syringe
663	L04AB01	Etanercept	50 mg	pre-filled syringe
631	L04AB02	Infliximab	100 mg	pluhur për inj.
664	L04AB04	Adalimumab	40mg/0,8ml	pre-filled syringe
760	L04AB06	Golimumab	50 mg	pre-filled pen.
215	L04AD01	Ciclosporin	100 mg	capsul
214	L04AD01	Ciclosporin	25 mg	capsul
452	L04AD02	Tacrolimus	0.5 mg	prlg.cap.
453	L04AD02	Tacrolimus	1 mg	prlg.cap.
752	L04AC07	Tocilizumab	162mg/0.9ml	pre-filled syringe
758	L04AC10	Secukinumab	150 mg	sol. per inj.
628	N04BA02	Levodopa + Carbidopa	(2g + 0.5g)/100 ml	gel.int
726	N04BC07	Apomorphine Hydrochloride	10mg/ml	fl.injec.
727	N04BC07	Apomorphine Hydrochloride	5 mg/ml	pre-filled syringe
593	N05AX08	Risperidone	25mg	tret.per inj.
594	N05AX08	Risperidone	37.5mg	tret.per inj.
595	N05AX08	Risperidone	50mg	tret.per inj.
743	N05AX13	Paliperidone	100 mg	pre-filled syringe
742	N05AX13	Paliperidone	75 mg	pre-filled syringe
744	N05AX13	Paliperidone	150 mg	pre-filled syringe
753	N05AX13	Paliperidone	263 mg	pre-filled syringe
754	N05AX13	Paliperidone	350 mg	pre-filled syringe
755	N05AX13	Paliperidone	525 mg	pre-filled syringe
602	R03DX05	Omalizumab	150mg/2ml	tret.per inj.
606	S01LA04	Ranibizumab	10mg/ml	tret.per inj.
608	S01LA05	Aflibercept	40mg/ml	tret.per inj.
531	V03AC02	Deferiprone	500 mg	f.c.tabl.
716	V03AC03	Deferasirox	125 mg	tab. shpr.
418	V03AC03	Deferasirox	250 mg	tab. shpr.
717	V03AC03	Deferasirox	500 mg	tabl. shpr.
762	V03AC03	Deferasirox	90 mg	f.c.tabl.
763	V03AC03	Deferasirox	180 mg	f.c.tabl.
764	V03AC03	Deferasirox	360 mg	f.c.tabl.
605	V03AE02	Sevelamer Carbonate	800mg	f.c.tabl.
406	V06DD	L-Leucine 0,0994g, L-Valine 0,0895g, L-Lysine 0,815g...etj		tablet
552	V06DE	Aminoacide pa Lysine,Tryptophan etj.(mixture)	500g	paket
551	V06DE	Aminoacide pa Lysine,Tryptophan etj.(mixture)	400g	paket

Marzhi i grosistit 5.5%, i farmacistë 10%

1

Kod Bari	Kodi ATC	Principi aktiv	Doza	Forma
379	A16AA	Phenil Keton Urea	500g	pak.
553	B01AB05	Enoxaparin Sodium	40mg-0.4ml	pre-filled syringe
554	B01AB05	Enoxaparin Sodium	60mg-0.6ml	pre-filled syringe
413	L01BB05	Fludarabine	10 mg	f.c.tabl.
588	N01AH01	Fentanyl	25mcg/h	Pach
589	N01AH01	Fentanyl	50 mcg/h	Pach
339	V03AC01	Deferoxamine	500 mg	pluhur për inj.

Marzhi i grosistit 5.5%, i farmacistë 13%

2

Kod Bari	Kodi ATC	Principi aktiv	Doza	Forma
433	A07EC02	Mesalazine	500 mg	f.c.tabl.
421	A09AA02	Multienzymes (L+A+P) Pancreatin	10.000 Nj.N	capsul
455	A09AA02	Multienzymes (L+A+P) Pancreatin	25.000 Nj.N	capsul
489	A10AB06	Insuline Glulisine	100 Nj.Nj - 3 ml	pre-filled pen.
692	A10AE04	Insulin Glargine	300 Nj.N./ml	pre-filled pen.
448	A10AE04	Insuline Glargine solution	100 Nj.N/ml - 3 ml	pre-filled pen.
449	A10AE05	Insuline Detemir solution	100 Nj.N/ ml - 3 ml	pre-filled pen.
529	A10BD08	Vildagliptin+Metformine	50mg + 500mg	f.c.tabl.
530	A10BD08	Vildagliptin+Metformine	50mg + 850mg	f.c.tabl.



617	A10BF01	Acarbose	100 mg	tablet
616	A10BF01	Acarbose	50 mg	tablet
767	A10BH01	Sitagliptin	100 mg	f.c.tabl.
624	B03AC	Iron(III) Hydroxide Dextran Complex	100mg/2ml	tret.per inj.
713	B03AC	Iron(III) Hydroxide Dextran Complex	100mg/5ml	tret.per inj.
724	C01EB17	Ivabradine	5 mg	f.c.tabl.
725	C01EB17	Ivabradine	7.5 mg	f.c.tabl.
558	C01EB18	Ranolazine	375 mg	prlg.tab.
559	C01EB18	Ranolazine	500 mg	prlg.tab.
683	C01EB18	Ranolazine	750 mg	prlg.tab.
733	C01EB22	Meldonium	250 mg	caps.
734	C01EB22	Meldonium	500 mg	caps.
561	C02AC05	Moxonidine	0.4 mg	f.c.tabl.
564	C09BB02	Enalapril+Lercanidipine	20+10mg	f.c.tabl.
565	C09CA07	Telmisartan	40mg	f.c.tabl.
622	C09CA07	Telmisartan	80 mg	f.c.tabl.
112	G03HA01	Cyproterone Acetate	50 mg	tablet
574	G04CB02	Dutasteride	0.5mg	capsul
198	J05AF05	Lamivudine	100 mg	f.c.tabl.
579	L01XX05	Hydroxyurea	500mg	capsul
580	L02BB03	Bicalutamide	50mg	f.c.tabl.
444	L02BG03	Anastrozole	1 mg	f.c.tabl.
212	L02BG04	Letrozole	2.5 mg	f.c.tabl.
548	L04AA13	Leflunomide	20 mg	f.c.tabl.
231	M05BA02	Disodium Clodronate	400 mg	hard caps.
492	M05BA06	Acid Ibandronic	50 mg	f.c.tabl.
277	N05AX08	Risperidone	1mg/1ml - 30 ml	syrop
596	N05AX13	Paliperidone	6mg	prlg.tab.
597	N05AX13	Paliperidone	9mg	prlg.tab.
598	N06BA04	Methylphenidate Hydrochloride	18 mg	prlg.tab.
599	N06BA04	Methylphenidate Hydrochloride	36 mg	prlg.tab.
514	R03AK06	Salmeterol Xinafoate + Fluticasone Propionate	50 mcg + 100 mcg	pompe
515	R03AK06	Salmeterol Xinafoate + Fluticasone Propionate	50 mcg + 250 mcg	pompe
516	R03AK06	Salmeterol Xinafoate + Fluticasone Propionate	50 mcg + 500 mcg	pompe
603	R06AX29	Bilastine	20mg	tablet

Marzhi i grosistit 6%, i farmacisë 18%

3

Kod Bari	Kodi ATC	Principi aktiv	Doza	Forma
10	A05AA02	Acid Ursodeoxycholic	150 mg	hard caps.
15	A07EC01	Sulfasalazine	500 mg	tablet
19	A10AB01	Insuline Humane Biosintetike Neutrale	100 Nj.N. / ml - 3 ml	pre-filled pen.
446	A10AB05	Insuline Aspart solution	100 Nj.N./ml - 3 ml	pre-filled pen.
20	A10AC01	Insuline Humane Biosintetike Izofane	100 Nj.N. / ml - 3 ml	pre-filled pen.
27	A10AD01	Insuline Humane Biosintetike Bifazike Izofane	100 Nj.N./ ml - 3 ml 25/75	pre-filled pen.
447	A10AD05	Insuline Aspartan + Protamine Crystallised Ins Aspart	100 Nj.N./ml - 3 ml 30/70	pre-filled pen.
745	A10BX07	Liraglutide	6 mg/ml	pre-filled pen.
623	A10BX10	Lixisenatide	20mcg/0.2ml	pre-filled pen.
412	A12BA51	Potassium Chloride combinations		pak.
410	B01AC04	Clopidogrel	75 mg	f.c.tabl.
675	B01AC23	Cilostazol	100 mg	tablet
693	B01AF01	Rivaroxaban	10 mg	f.c.tabl.
694	B01AF01	Rivaroxaban	15 mg	f.c.tabl.
695	B01AF01	Rivaroxaban	20 mg	f.c.tabl.
729	B01AF02	Apixaban	2.5 mg	f.c.tabl.
730	B01AF02	Apixaban	5 mg	f.c.tabl.
774	B01AF03	Edoxaban	30 mg	f.c.tabl.
775	B01AF03	Edoxaban	60 mg	f.c.tabl.
780	C07BB12	Nebivolol +Hydrochlorothiazide	5 mg + 12.5 mg	f.c.tabl.
781	C07BB12	Nebivolol + Hydrochlorothiazide	5 mg + 25 mg	f.c.tabl.
380	C08CA13	Lercanidipine	10 mg	f.c.tabl.
619	C08CA13	Lercanidipine	20 mg	f.c.tabl.
696	C08DA51	Verapamil + Trandonapril	180 + 2 mg	tab. shpr.
697	C08DA51	Verapamil + Trandonapril	240 + 4 mg	tab. shpr.
732	C09AA05	Ramipril	10 mg	tablet
731	C09AA05	Ramipril	5 mg	tablet
741	C09AA15	Zofenopril	30 mg	f.c.tabl.
388	C09CA03	Valsartan	160mg	f.c.tabl.
88	C09CA03	Valsartan	80 mg	f.c.tabl.
366	C09CA04	Irbesartan	150 mg	f.c.tabl.



367	C09CA04	Irbesartan	300 mg	f.c.tabl.
402	C09CA08	Olmesartan	20 mg	f.c.tabl.
403	C09CA08	Olmesartan	40mg	f.c.tabl.
414	C09DA03	Valsartan + Hydrochlorthiazide	160 + 12.5 mg	f.c.tabl.
389	C09DA03	Valsartan + Hydrochlorthiazide	80 + 12.5 mg	f.c.tabl.
390	C09DA03	Valsartan+Hydrochlorthiazide	160 + 25 mg	f.c.tabl.
566	C09DA04	Irbesartan + Hydrochlorthiazide	150 + 12.5 mg	f.c.tabl.
567	C09DA04	Irbesartan + Hydrochlorthiazide	300 + 12.5 mg	f.c.tabl.
568	C09DA04	Irbesartan + Hydrochlorthiazide	300 + 25 mg	f.c.tabl.
475	C09DA08	Olmesartan Medoxomil + Hydrochlorthiazide	20 + 12.5 mg	f.c.tabl.
537	C09DB01	Amlodipine + Valsartan	10 +160 mg	f.c.tabl.
451	C09DB01	Amlodipine + Valsartan	5 +160 mg	f.c.tabl.
450	C09DB01	Amlodipine + Valsartan	5 +80 mg	f.c.tabl.
654	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine + Hydrochlorothiazide	20 + 5 + 12,5 mg	f.c.tabl.
719	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine + Hydrochlorothiazide	40 + 10 + 25 mg	tablet
655	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine + Hydrochlorothiazide	40 + 5 + 25 mg	f.c.tabl.
653	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine	20 + 5 mg	f.c.tabl.
652	C09DB02	Olmesartan + Amlodipine	40 + 5 mg	f.c.tabl.
761	C09DB05	Irbesartan + Amlodipine	150 mg + 5 mg	f.c.tabl.
765	C09DB05	Irbesartan + Amlodipine	150 mg + 10 mg	f.c.tabl.
766	C09DB05	Irbesartan + Amlodipine	300 mg + 10 mg	f.c.tabl.
772	C09DB07	Candesartan + Amlodipine	8 mg + 5 mg	hard cap.
773	C09DB07	Candesartan + Amlodipine	16 mg + 5 mg	hard cap.
490	C09DX01	Amlodipine + Valsartan + Hydrochlorthiazide	10 + 160 + 12.5 mg	f.c.tabl.
474	C09DX01	Amlodipine + Valsartan + Hydrochlorthiazide	5 + 160 + 12.5 mg	f.c.tabl.
491	C09DX01	Amlodipine + Valsartan + Hydrochlorthiazide	5 + 160 + 25 mg	f.c.tabl.
538	C09DX01	Amlodipine + Valsartan +Hydrochlorthiazide	10 + 160 + 25 mg	f.c.tabl.
698	C09DX04	Sacubitril + Valsartan	24 + 26 mg	f.c.tabl.
699	C09DX04	Sacubitril + Valsartan	49 + 51 mg	f.c.tabl.
700	C09DX04	Sacubitril + Valsartan	97 + 103 mg	f.c.tabl.
570	C10BX03	Amlodipine + Atorvastatin	10 + 10 mg	f.c.tabl.
569	C10BX03	Amlodipine + Atorvastatin	5 + 10 mg	f.c.tabl.
417	H01BA02	Desmopressin	0.01 mg/ml	nasal spray
400	J02AC01	Fluconazole	100mg	hard caps.
192	J02AC01	Fluconazole	150 mg	caps.
228	M01CC01	Penicillamine	150 mg	f.c.tabl.
587	M05BA06	Acid Ibandronic 150 mg	151 mg	f.c.tabl.
610	M05BB03	Acid Alendronic + Colecalciferol	70 mg	tablet
746	M05BB03	Acid Alendronic + Colecalciferol	70 mg 56000 UI	tablet
236	N02AA01	Morphine Hydrochloride	10mg/ml	tret.per inj.
661	N02AA01	Morphine sulfate	20 mg/ml	pika nga goja
747	N02AA01	Morphine Sulphate	10 mg	tablet
235	N02AA01	Morphine Sulphate	100 mg	tablet
234	N02AA01	Morphine Sulphate	60 mg	tablet
670	N02AA05	Oxycodone	10 mg	tablet
592	N02AX02	Tramadol Hydrochloride	100mg/ml-10ml	pika nga goja
591	N02AX02	Tramadol Hydrochloride	50mg	hard caps.
495	N03AX09	Lamotrigine	100 mg	tablet
496	N03AX09	Lamotrigine	200 mg	tablet
493	N03AX09	Lamotrigine	25 mg	tablet
494	N03AX09	Lamotrigine	50 mg	tablet
259	N03AX11	Topiramate	100 mg	f.c.tabl.
256	N03AX11	Topiramate	25 mg	sprinkles
257	N03AX11	Topiramate	25 mg	f.c.tabl.
258	N03AX11	Topiramate	50 mg	f.c.tabl.
497	N03AX12	Gabapentin	100 mg	caps.
498	N03AX12	Gabapentin	300 mg	hard cap.
499	N03AX12	Gabapentin	400 mg	hard cap.
611	N03AX14	Levetiracetam	500 mg	tabl.retard
500	N03AX14	Levetiracetam	100 mg/ml - 300 ml	syrup
501	N03AX14	Levetiracetam	500 mg	f.c.tabl.
542	N03AX16	Pregabalin	150mg	hard caps.
541	N03AX16	Pregabalin	75mg	capsul
265	N05AA01	Chlorpromazine	50 mg - 2 ml	tret.per inj.
273	N05AH02	Clozapine	100 mg	tablet
274	N05AH03	Olanzapine	10 mg	f.c.tabl.
738	N06DA02	Donepezil hydrochloride	10 mg	f.c.tabl.
737	N06DA02	Donepezil hydrochloride	5 mg	tab. shpr.
759	N06BX18	Vinpocetine	10 mg	tablet
777	R01AD58	Azelastine + Fluticasone	137 mcg + 50 mcg	nasal spray
426	R03AC12	Salmeterol Xinafoate	25 mcg/doze - 120 doza inh.	pompe



520	R03AC18	Indacaterol Maleate	150 mcg	caps.per inhal.
521	R03AC18	Indacaterol Maleate	300 mcg	caps.per inhal.
511	R03AK07	Budesonide + Formoterol Fumarate Dihidrate	80/4.5 mcg/doze - 60 doza	pluhur për inh.
512	R03AK07	Budesonide + Formoterol Fumarate Dihidrate	160/4.5 mcg/doze - 60 doza	pluhur për inh.
722	R03AL04	Indacaterol + Glycopyrronium	110mcg + 50mcg	hard cap.
768	R03AL09	Beclomethasone + Formoterol + Glycopyrronium	87 mcg + 5 mcg + 9 mcg-120 doza	pompe
476	R03BA02	Budesonide	200 mcg	pompe
477	R03BA02	Budesonide	400 mcg	pompe
522	R03BA03	Beclomethasone + Formoterol	100/6 mcg - 120 doza	pompe
408	R03BA05	Fluticasone Propionate	125mcg-120 doza	pompe
513	R03BA05	Fluticasone Propionate 2	50 mcg/doze - 120 doza	pompe
377	R03BA05	Fluticasone Propionate	250 mcg-60 doza	pompe
720	R03BA05	Fluticasone Propionate	500mcg-60 doza	pompe

UDHËZIM

Nr. 21, datë 14.7.2021

PËR OPERACIONET E VEÇANTA HIDROKARBURE DHE PARASHIKIMET FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës 6, të nenit 8 dhe pikës 7, të nenit 26, të ligjit nr. 153, datë 17.11.2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZOJNË:

1. Qëllimi i udhëzimit

Qëllimi i këtij udhëzimi është të miratojë:

a) dispozita të mëtëjshme për përcaktimin e operacioneve të veçanta hidrokarbure;

b) dispozita për trajtimin e të drejtave të ngjashme hidrokarbure dhe bashkimin e të drejtave hidrokarbure.

c) dispozita në lidhje me parashikimet financiare në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur.”

2. Operacionet e veçanta hidrokarbure

“E drejtë hidrokarbure” është e drejta e një personi për të kryer operacione hidrokarbure, duke përfshirë të drejtën e një personi sipas një marrëveshjeje hidrokarbure dhe të drejtën e nënkontraktorit për të cilën zbatohet ligji nr. 153/2020, sipas nenit 2, për të kryer operacione hidrokarbure në emër të një personi tjetër.

Në nenin 8, të ligjit nr. 153/2020, përcaktohen rastet kur një operacion hidrokarbur konsiderohet një operacion i veçantë hidrokarbur. Operacionet hidrokarbure, që i përkasin çdo të drejtë

hidrokarbure, përbëjnë një operacion të veçantë hidrokarbur. Në përgjithësi operacione të veçanta hidrokarbure janë ato që kryhen nën një dhe vetëm një marrëveshje hidrokarbure dhe në rastet kur brenda kësaj marrëveshjeje hidrokarbure ka më shumë se një zonë zhvillimi të miratuar nga plane të veçanta zhvillimi, operacionet hidrokarbure, që kryhen në çdo zonë zhvillimi, janë operacione të veçanta hidrokarbure.

Ky përcaktim ka si qëllim krijimin e një sistemi rrethues për të mbrojtur tatimin mbi fitimin në operacionet hidrokarbure dhe për të krijuar mundësi të barabarta kur është fjala për investimet në operacionet e reja hidrokarbure. Qëllimi i sistemit rrethues është të sigurojë që shpenzimet dhe humbjet nga një operacion i veçantë hidrokarbur nuk kompensojnë të ardhurat nga një operacion tjetër i veçantë hidrokarbur ose jo.

Personat që kryejnë operacione hidrokarbure llogarisin dhe paguajnë detyrimin e tatimit mbi fitimin të ndarë për secilin nga “operacionet e veçanta hidrokarbure”. Në mënyrë tipike, kjo është në bazë të kontratës hidrokarbure, si dhe çdo zonë zhvillimore në veçanti, pavarësisht se këto të fundit janë tërësisht ose pjesërisht zonë e kontratës. Pra, në rastet kur në një kontratë është miratuar më shumë se një zonë zhvillimi, secila zonë zhvillimi do të konsiderohet një e drejtë hidrokarbure më vete, pra një operacion i veçantë hidrokarbur.

Duke qenë se, çdo zonë zhvillimi brenda një zone kontrate trajtohet si operacion i veçantë hidrokarbur, atëherë edhe detyrimet fiskale llogariten respektivisht për secilën nga zonat e zhvillimit/prodhimit. Subjektet juridike që gëzojnë të drejtën për të kryer operacione hidrokarbure për efekt të llogaritjes së detyrimit të tatimit mbi fitimin për çdo zonë të vetme zhvillimore, pjesë e zonës së kontratës, duhet të krijojnë një shoqëri të re, pasi të kenë marrë miratimin nga autoriteti të plan zbulimit



dhe zhvillimit për një zonë të kontratës që rezulton me zbulim.

Deklarimi i fitimit të tatueshëm bëhet nga shoqëria e re e krijuar për çdo operacion të veçantë hidrokarbur për fazën e zhvillimit. prodhimit tregtar etj. Subjekti juridik, që gëzon të drejtën për të kryer operacione hidrokarbure, me miratimin nga autoriteti të planzhvillimit për një zonë/bllok të vetme, krijon shoqërinë e re (me pjesëmarrje 100% në kapitalin e kësaj shoqërie të re). Për efekt të deklarimit të fitimit të tatueshëm, subjekti juridik, krijues i shoqërisë së re, transferon nëpërmjet shitjes edhe kostot e operacioneve të fazës së kërkim-zbulimit për zonën/bllokun e vetëm zhvillimor, kjo e fundit objekt i veprimtarisë së tatueshme të shoqërisë së re.

Në rastet kur i kemi të miratuara si zonën e zhvillimit dhe prodhimit brenda zonës së kontratës, atëherë operacionet hidrokarbure që kryhen në zonën e kontratës deri në datën e miratimit dhe të gjitha operacionet e tjera hidrokarbure, pas kësaj date që kryhen në zonën e zhvillimit do të trajtohen si operacione hidrokarbure të kryera në lidhje me të njëjtin operacion të veçantë hidrokarbur.

Nëse jemi në të njëjtën situatë, pra zona e zhvillimit dhe e prodhimit është miratuar brenda zonës së kontratës, por operacionet hidrokarbure që kryhen në zonën e kontratës pas datës së miratimit, kryhen jashtë kësaj zone të zhvillimit dhe prodhimit do të trajtohen si një operacion i ri i veçantë hidrokarbur.

3. Bashkimi i të drejtave hidrokarbure

Kur një rezervuar hidrokarburesh ndodhet pjesërisht në një zonë kontrate dhe pjesërisht në një zonë tjetër kontrate dhe kur ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet i duket se mund të arrihet rritje e efektivitetit përmes zhvillimit dhe operimit të përbashkët në atë rezervuar, Ministria ka të drejtën t'i urdhërojë kontraktorët të zhvillojnë dhe operojnë së bashku rezervuarin sipas një marrëveshjeje të lidhur prej tyre për këtë qëllim. Në këto raste operacion hidrokarbur do të konsiderohet një operacion i veçantë hidrokarbur, për të cilin do të përdoret një sistem rrethues për trajtimin e shpenzimeve, të ardhurave dhe deklarimit të tatim-fitimit.

Ky njehsim/bashkim i të drejtave të ngjashme mund të realizohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose ndërmjet Shqipërisë me shtetin/tet që kanë të përbashkët një kufi tokësor.

Njehsimi i dy licencave apo zonave kontraktuale, që tejkalojnë kufirin e dy shteteve, njihet me termin njehsim ndërkombëtar. Këto janë shumë herë më komplekse sesa njehsimi kombëtar i përmendur më lart, për arsye sepse ato bashkojnë disa marrëveshje hidrokarbure të drejtuar nga legjislacione të ndryshme. Kështu ato kërkojnë nënshkrimin e një marrëveshjeje nga shtetet pjesëmarrëse, ku midis të tjerave përcaktohen edhe kushtet e njehsimit të licencave.

Kur vendndodhja e një rezervuari hidrokarbur përkon me një kufi ndërkombëtar, cilido nga shtetet mund të kërkojë njehsim, duke qenë se parimi i një sovraniteti të përhershëm ndaj burimeve natyrore do të thotë që shtetet kanë të drejta eksplorimi brenda territoreve të tyre.

4. Parashikimet financiare

Në nenin 26 parashikohet detyrimi i mbajtësit të së drejtës hidrokarbure për të përgatitur parashikime financiare, periudha e raportimit, afatet e raportimit sipas këtij udhëzimi, si dhe penalitetet në rastin e moszbatimit të parashikimeve ligjore dhe nënligjore.

Mbajtësi i së drejtës hidrokarbure duhet që të përgatisë dy herë në vit, parashikimet, për:

i. shumat, burimet, metodat, afatet dhe kushtet e financimit të operacioneve hidrokarbure sipas së drejtës së dhënë me marrëveshjet hidrokarbure;

ii. kostot e kërkimit, vlerësimit, zhvillimit dhe prodhimit;

iii. sasitë e prodhimit dhe kushtet e pritshme të shitjes, veçanërisht në lidhje me çmimin;

iv. marrëveshjet e prodhimit ose të ndarjes së fitimit, duke përfshirë shpërndarjet e pritshme, politikat në të cilat do të bazohen shpërndarjet dhe rendin e përparësisë ndërmjet shpërndarjeve dhe pagesave të tjera (veçanërisht interesi dhe shlyerja e borxhit);

v. tatimet, taksat dhe të ardhurat e tjera që duhet t'i paguhen shtetit shqiptar dhe mënyrën e llogaritjes së këtyre shumave; dhe

vi. çdo informacion tjetër që mund të jetë i nevojshëm.

Këto parashikime duhet të kryhen sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 1 të udhëzimit dhe mbajtësi i së drejtës hidrokarbure duhet të caktojë një punonjës në mënyrë të përhershme, i cili të njoftojë me shkrim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë Kombëtare së Burimeve Natyrore, me vjetërsi të



mjaftueshme pune për të pasur mundësi për akses në informacionin e kërkuar për t'u plotësuar në shtojcën 1 dhe që do t'i duhet të kontaktojë me DPT-në dhe AKBN-në për çështjet e parashikuara nga ky nen.

Afatet për dërgimin pranë DPT-së dhe AKBN-së të modelit të shtojcës 1 të plotësuar me të dhënat, janë brenda datës 30 qershor për parashikimin e parë dhe brenda datës 31 dhjetor për parashikimin e dytë.

DPT-ja dhe AKBN-ja, pasi të kenë marrë modelin e plotësuar me parashikimet e periudhës, me njoftim me shkrim, nëse e gjykojnë të nevojshme mund të kërkojnë nga mbajtësi i së drejtës të japë të dhëna të mëtejshme dhe më të hollësishme të parashikimeve. Mbjtësi i së drejtës duhet t'i depozitojë këto të dhëna brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit.

Në rastet kur një mbajtës i së drejtës hidrokarbure vihet në dijeni të fakteve që bëjnë materialisht të pasakta parashikimet më të fundit të përmendura më lart, atëherë mbajtësi i së drejtës

duhet të njoftojë menjëherë DPT-në dhe AKBN-në dhe të japë informacion të përditësuar në lidhje me parashikimet që do të ndryshojnë.

Nëse një mbajtës i së drejtës hidrokarbure, nuk jep informacionin në lidhje me parashikimet, detajet ose përditësimet e mëtejshme, dënohet me gjobë sipas përcaktimit në nenin 26 të ligjit nr. 153/2020.

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

SHTOJCË 1 TË DHËNAT E MBAJTËSIT TË SË DREJTËS HIDROKARBURE

- | | | |
|---|--|-------|
| 1 | Kontraktori mbajtës i së drejtës hidrokarbure në zonën e kontratës
Titulli i kontratës për hidrokarbure (kërkim-vlerësim, prodhim-zhvillim) | _____ |
| 2 | Zona/t për zhvillim-prodhim të miratuara brenda zonës së kontratës | _____ |
| | a) Operacionet hidrokarbure zhvillohen para/pas datës efektive sipas PoD të miratuar | _____ |
| | b) Operacionet hidrokarbure zhvillohen pas datës efektive si shtojcë në PoD e miratuar | _____ |
| | c) Rezervuari/rezervat hidrokarbure ndodhen brenda zonës së kontratës | _____ |
| | d) Rezervuari/rezervat hidrokarbure ndodhen pjesërisht brenda zonës së kontratës
dhe pjesërisht brenda një zone tjetër kontrate | _____ |
| | e) Rezervuari/rezervat hidrokarbure ndodhen pjesërisht brenda zonës së kontratës
dhe pjesërisht brenda një zone tjetër në/jashtë kufirit tokësor të RSH | _____ |
| 3 | Nënkontraktori mbajtës i së drejtës hidrokarbure sipas një marrëveshje me Kontraktorin | _____ |
| | a) kryen operacionet hidrokarbure që zhvillohen para/pas datës efektive sipas PoD të miratuar | _____ |
| | b) kryen operacionet hidrokarbure që zhvillohen pas datës efektive si shtojcë në PoD e miratuar | _____ |
| 4 | Parashikimi i aktivitetit hidrokarbur 6-mujor në zonën e kontratës sipas titullit, për: | _____ |
| | a) Buxhetin dhe burimet, afatet dhe kushtet e financimit të operacioneve hidrokarbure | _____ |
| | b) Kostot preventive sipas titullit (në kërkim, vlerësim, prodhim, zhvillim) | _____ |
| | c) Kostot kapitale shtesë (në zonën e kontratës, në zonën e zhvillimit, nga ndryshimi i titullit etj.) | _____ |
| | d) Sasitë e prodhimit të fluideve hidrokarbure, shitjet brenda/jashtë, çmimet | _____ |
| | e) Detyrimet sovraane, Albpetrol, AKBN, kontraktuale | _____ |
| | f) Detyrimet për interesa, shlyerje borxhi | _____ |
| | g) Rendi i shpërndarjes dhe kryerjes së pagesave | _____ |
| | h) Llogaritja, mënyra e llogaritjes së detyrimeve fiskale dhe të ardhurave të tjera ndaj shtetit shqiptar | _____ |

**URDHËR****Nr. 289, datë 29.7.2021****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Brendshëm, z. Andi Mahila, nga data 2.8.2021 deri më datë 20.8.2021.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet, zëvendësministri i Brendshëm, z. Andi Mahila.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM**Bledar Çuçi****URDHËR****Nr. 220, datë 4.8.2021****PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 1 e nenit 12 dhe pikës “b”, të nenit 13, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të germës “c”, pika 2 e nenit 7, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e pjesshëm të kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjyqtarit më të vjetër në moshë, z. Ardian Hajdari, për periudhën 5 gusht 2021 deri më 16 gusht 2021.

2. Gjyqtari z. Ardian Hajdari për periudhën sipërcituar do të nënshkruajë në emër të kryetarit në mungesë të tij;

- Shkresat që dalin nga institucioni drejtuar Komisionerit Publik, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, si dhe denoncuesve, lidhur me denoncimet e paraqitura prej tyre pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të cilat janë brenda afatit të ankimit.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, z. Ardian Hajdari.

4. Gjyqtari z. Ardian Hajdari nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE**Albana Shtylla****VENDIM****Nr. 1215, datë 15.7.2021****NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	kryesues;
Sokol Binaj	anëtar;
Ilir Panda	anëtar;
Klodian Kurushi	anëtar;
Ervin Pupe	anëtar;

në datën 15.7.2021, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr. 31003-1562-2018 akti, që iu përket palëve:

PADITËS: Leonard Ndreka

I PADITUR: Drejtoria e Policisë së Shtetit

OBJEKTI: Detyrimin e palës së paditur t'i njohë paditësit gradën “kryekomisar”.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, nenet 51 e vijuese, VKM-në nr. 892, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit”.



KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi, në seancë gjyqësore, çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi Leonard Ndreka, me urdhrin nr. 900/1, datë 31.12.2001, është bërë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit, duke ushtruar detyra të ndryshme përgjatë periudhës 2001–2010, përkatësisht nën gradat “nëntoger”, “nëninspektor”, “nënkomisar”.

2. Me urdhrin nr. 3052/1, datë 2.11.2010, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, paditësit rezulton t'i jetë njohur grada “Komisar”. Me urdhrin nr. 2304 prot., datë 15.10.2015, të Drejtorit të Policisë së Shtetit, paditësi është transferuar përkohësisht në detyrën e shefit të komisarariatit, në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër. Në vijim, drejtori i Policisë Vendore Shkodër ka disponuar me urdhrin nr. 1364 prot., datë 15.10.2015, përmes së cilit është konfirmuar fillimi i të drejtave administrative dhe financiare të paditësit, përkatësisht në datë 16.10.2015.

3. Me urdhrin nr. 452, datë 8.2.2016, të drejtorit të Policisë së Shtetit, është ndërprerë transferimi i përkohshëm i paditësit Leonard Ndreka, duke e transferuar dhe emëruar paditësin në detyrën e shefit të komisarariatit, në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër. Drejtori i Policisë Vendore Shkodër ka disponuar përmes urdhrit nr. 140, datë 9.2.2016, konfirmimin për fillimin e të drejtave administrative dhe financiare të paditësit, përkatësisht në datë 10.2.2016.

4. Në muajin janar të vitit 2017, paditësi i është drejtuar palës së paditur me kërkesën për njohjen e gradës policore “kryekomisar”. Në këtë kërkesë paditësi ka pretenduar se ka kaluar afati trevjeçar i qëndrimit në gradën policore “Komisar” dhe se aktualisht ushtron një funksion të cilit i takon grada “kryekomisar”. Pala e paditur përmes shkresës nr. 159/1-2 prot., datë 9.2.2017 me lëndë: “Kthim përgjigje”, i ka komunikuar paditësit se në mbështetje të ligjit nr. 108/2014 nuk parashikohet

marrja e gradës sipas pozicionit të punës dhe se fitimi i gradës së radhës bëhet përmes vlerësimit konkurrues nga Komisioni i Gradimit. Në këtë shkresë pala e paditur fton paditësin të marrë pjesë në konkurrimin e radhës në rast se plotëson kriteret ligjore.

5. Për shkak të mosnjohjes nga pala e paditur të gradës korresponduese “kryekomisar”, paditësi Leonard Ndreka i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë në datë 15.3.2017, duke pretenduar nëpërmjet kërkesëpadisë objekt gjykimi, detyrimin e palës së paditur t'i njohë gradën “kryekomisar”.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me vendimin nr. 202, datë 5.4.2017, ka vendosur: “1. Pranimin e kërkesëpadisë; 2. Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Policisë së Shtetit t'i njohë paditësit Leonard Ndreka gradën policore ‘Kryekomisar’...”.

7. Në marrjen e këtij vendimi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, ka vlerësuar: “Nga mosveprimi i palës së paditur në hapjen e procedurave të konkurrimit për gradën policore ‘kryekomisar’, paditësit i është mohuar një e drejtë e fituar me ligj, e drejta e mbajtjes së gradës sipas vjetërsisë dhe funksionit që kryen, dhe për këtë fakt çështja objekt shqyrtimi bën pjesë në juridiksionin gjyqësor ... Kërkimet e paditësit janë të mbështetura në ligj e në prova për faktin se nga ana e palës së paditur i mohohet e drejta për të përfutur nga benifitet që i nje ligji. Gjykata në këtë konkluzion arriti duke pasur parasysh se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës ... Në seancë u provua se paditësi plotëson kriteret e mësipërme pasi ai nga data e gradimit ‘komisar’ ka mbi 3 vite që i ka lindur e drejta për t'u graduar ‘kryekomisar’, që prej datës 2.11.2013. Sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 108/2014, ‘Për Policinë e Shtetit’: ‘Çdo funksioni i caktobet grada korresponduese’, e miratuar kjo në tabelën e funksioneve korresponduese për çdo gradë nga Këshilli i Ministrave ... Paditësi plotëson kushtin për vjetërsi shërbimi në detyrë dhe duke qenë se edhe detyra që ai ushtron aktualisht i korrespondon grada ‘kryekomisar’ ... Gjykata çmon se paditësit Leonard Ndreka i takon grada policore ‘kryekomisar’.

8. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur Drejtoria e Policisë së Shtetit, duke parashtruar këto shkaqe:



“ - Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër ka zbatuar keq ligjin.

- Gjykata e ka mbështetur vendimin e saj kryesisht në pretendimet e paditëses dhe në kundërshtim me nenin 309 të Kodit të Procedurës Civile, sepse nuk ka marrë parasysh faktet e përmendura nga ana jonë.

- Pretendimi i paditësit, për të fituar gradën “kryekomisar”, nuk qëndron, pasi po të analizojmë historikun e periudhës së punës së paditësit rezultojnë se ai ka një karrierë shumëvjeçare në strukturat policore, duke pranuar njëkohësisht se gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore, ka fituar gradën sipas ligjit.

- Kërkesëpadia dubet rrëzuar nga gjykata për arsye se është e parashkruar.

- Nuk ndodhemi përpara asnjë rasti të parashikuar nga neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative, lidhur me pavlefshmërinë e akteve.

- Pretendimi i paditësit se nuk i jepet grada “kryekomisar” nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, nuk qëndron pasi referuar ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, nenet 50–60, si dhe në zbatim të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM-në nr. 750, datë 16.9.2015, fitimi i gradës “nënkomisar” deri në “Drejtues i parë” bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues nga një komision gradimi”.

- Në referim të VKM-së nr. 917, datë 4.10.2013, nuk rezultojnë që në rastin konkret të vërtetohen rrethanat që dhënia e gradës të jetë kryer në kundërshtim me ligjin.”.

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1812, datë 28.4.2018 ka vendosur: “Lënia në fuqi të vendimit nr. 202, datë 5.4.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër ...”.

10. Në marrjen e këtij vendimi gjykata ka vlerësuar: “Gjykata e Apelit Administrativ tërheq vëmendjen e palës së paditur mbi faktin se, përparimi në gradë nëpërmjet procesit të konkurrimit, brenda periudhës 1-vjeçare, përbën kusht ligjor vetëm për ata punonjës të Policisë së Shtetit, “të emëruar në bazë të vendimit nr. 917, datë 4.10.2013, të Këshillit të Ministrave, Për dëna ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 803, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, Për përvaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, të ndryshuar, çka nuk përkon me situatën faktike të paditësit Leonard Ndreka, emëruar me ligjin e ri. Në kohën e shqyrtimit administrativisht të ankesës së paditësit pala e paditur do të duhej të kishte proceduar me disponimin e aktit që i njëjti ankesuesit gradën “kryekomisar”, në zbatim të kuadrit ligjor ekzistues në fuqi, në momentin e shqyrtimit/refuzimit, çka do të kishte

shmangur investimin e mëtejshëm të gjykatës në funksion të zgjidhjes së kësaj çështjeje.”.

11. Kundër vendimit nr. 1812, datë 26.4.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur brenda afatit ligjor, e cila përfundimisht ka kërkuar prishjen e vendimit nr. 1812, datë 26.4.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe kalimin e çështjes për shqyrtim gjykatës kompetente. Pala e paditur në rekurs ka parashtruar këto pretendime:

“ - Gjykata Administrative e Apelit nuk ka hetuar nëse Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër ka qenë kompetente nga pikëpamja territoriale për të shqyrtuar këtë padi.

- Ngritja në gradë bëhet pasi plotësohen dy kushte kumulative, vjetërsia në gradën pasuese dhe ekzistenca e vendeve të lira për konkurrim në gradën pasuese. Përvaktimi i numrit të mbajtësve të një grade bëhet në përputhje me politikat e rendit dhe të sigurisë.

- Kërkesëpadia është parashkruar.

- Nuk ndodhemi përpara asnjë rasti të parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative lidhur me pavlefshmërinë e akteve.

- Pretendimi i paditësit, se nuk i jepet grada “kryekomisar” nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, nuk qëndron, pasi referuar ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, nenet 50–60, si dhe në zbatim të rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM-në nr. 750, datë 16.9.2015, përvaktobet se fitimi i gradës “nënkomisar” deri në “drejtues i parë” bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues nga një komision gradimi”.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

I. Në lidhje me shqyrtimin me përparësi të rekursit

12. Përmes shkresës nr. 1600 prot., datë 18.5.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka paraqitur kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të një sërë çështjesh gjyqësore me objekt “Njohje grade”, duke parashtruar shqetësimin lidhur me promovimin në gradë policore të punonjësve të Policisë së Shtetit, përmes vendimeve gjyqësore të gjykatave administrative.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim “Kolegji”) vlerëson se akordimi i gradës policore, në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 108/2014, si dhe në ligjin tashmë të shfuqizuar nr. 9749/2007, nga i cili varen ende çështje për gjykim, nga njëra anë, ka një impakt të gjerë në zhvillimin dhe promovimin e karrierës së punonjësve të Policisë së Shtetit dhe, nga ana tjetër reflekton drejtpërdrejt në efekte të



konsiderueshme financiare dhe administrative për Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

14. Pa lënë mënjane rëndësinë që ka çdo çështje e depozituar në Gjykatën e Lartë, vlerësohet se çështje të tilla paraqesin në vetvete një nevojë publike për shpejtësi gjykimi. Në këto kushte Kolegji ka vlerësuar se mosmarrëveshja objekt gjykimi të shqyrtohet me përparësi.

II. Për njësimin e praktikës gjyqësore lidhur me sistemin e fitimit të gradave policore të punonjësve të Policisë në Republikën e Shqipërisë

15. Pikësëpari, Kolegji sjell në vëmendje se nga vëzhgimi i praktikës gjyqësore që lidhet me shqyrtimin e mosmarrëveshjeve me objekt njohjen e gradës policore, është konstatuar se praktika gjyqësore e gjykatave administrative për çështje të ngjashme është e ndryshme.

16. Pas shqyrtimit të akteve të fashikullit gjyqësor dhe arsytimit të gjykatave për çështjen konkrete, pas kryerjes së një analize të plotë të kuadrit ligjor, por edhe të qasjes së praktikës gjyqësore të gjykatave administrative të shkallës së parë, si dhe të Gjykatës Administrative të Apelit, në lidhje me çështje të ngjashme me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, Kolegji vlerëson se shkaqet ligjore të ngritura në rekurs për shkelje të ligjit material e procedural nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit në vendimin nr. 1812, datë 26.4.2018, dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër, në vendimin nr. 202, datë 5.4.2017, janë të një rëndësie themelore, të cilat në mbështetje të nenit 58, shkronja “a”, të ligjit nr. 49/2012 (pas ndryshimeve me ligjin nr. 39/2017) përligjin nisjen e procedurës gjykmore për njësimin e praktikës gjyqësore.

17. Për shkak të paqartësisë që është hasur në praktikën gjyqësore lidhur me kufijtë e shqyrtimit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative të organit publik në procesin e dhënies së gradave policore, duke marrë në konsideratë faktin se në vendimin unifikues nr. 1, datë 29.2.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk u arrit të njësohej praktika gjyqësore, në lidhje me pyetjen e shtruar për unifikim, mbi kriteret ligjore që duhet të merren parasysh për caktimin e gradës së re, në rastin e ekuivalentimit të gradave policore, por edhe duke konstatuar se praktika e mbajtur në ndonjë rast nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, nuk ka gjetur pasqyrim në praktikën gjyqësore të gjykatave administrative të të gjitha niveleve,

Kolegji vlerëson të domosdoshme që të shtrohet për diskutim interpretimi përfundimtar i dispozitave të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, konkretisht nenet 50–60 të tij, lidhur me plotësimin e kushteve dhe kriterëve që nevojiten për fitimin e gradave policore për punonjësit e Policisë së Shtetit, me synim për të konkluduar me një qëndrim njësoje, për këtë çështje.

18. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vlerëson të shtrojë për njësim këtë çështje:

- A mund të fitohet gjyqësisht grada policore, për shkak të plotësimit të kriterit të vjetërsisë në gradë dhe/ose ushtrimit të funksionit përkatës për gradën e pretenduar, pa iu nënshtruar procedurës së vlerësimit konkurrues nga një komision gradimi?

Analizë mbi kuadrin ligjor

19. Në përputhje me statusin institucional, që u është njohur punonjësve të Policisë së Shtetit me ligjin nr. 8553, datë 25.11.1999, “Për Policinë e Shtetit” (në vijim “ligji nr. 8553/1999”), u miratua ligji nr. 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit” (në vijim “ligji nr. 8643/2000”), në të cilin u konfiguruan rishtazi gradat policore, si shprehje e hierarkisë së punonjësve të policisë. Ligji nr. 8643/2000 parashikonte se gradat policore fitohen sipas arsimit dhe kualifikimit profesional, vjetërsisë në shërbim, duke përfshirë edhe periudhën e mëparshme të shërbimit ushtarak të kohës (sipas parashikimeve të ligjit nr. 8553/1999) dhe karrierës në strukturat policore. Ligji nr. 8553/1999 dhe ligji nr. 8643/2000 u shfuqizuan përmes ligjit nr. 9749/2007, “Për Policinë e Shtetit” (në vijim “ligji nr. 9749/2007”) dhe ky i fundit rezulton të jetë shfuqizuar përmes nenit 144, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” (në vijim “ligji nr. 108/2014”), që aktualisht është në fuqi.

20. Në pasqyrim të ndryshimeve ligjore, si më sipër, ka evoluar edhe qasja e legjislatorit lidhur me njohjen dhe fitimin e gradës policore. Ligji nr. 9749/2007 shënoi kalimin në një sistem të ri gradash policore, duke detajuar ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë në raport me ushtrimin e gradës. Neni 36 i ligjit nr. 9749/2007 gruponte gradat në nivel zbatues, drejtues të ulët, të mesëm dhe të lartë, duke njohur si grada funksionale, të cilat merren *ex lege*, për shkak të emërimit në funksion, atë të drejtorit/zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Sipas nenit 39 të



ligjit nr. 9749/2007, përcaktimi i funksionit korrespondues për secilën prej gradave realizohet me akte normative nënligjore. Në mbështetje të nenit 39 dhe 126, të ligjit nr. 9749/2007, kalimi nga sistemi i vjetër i gradave, parashikuar në ligjin nr. 8643/2000, në gradat sipas ligjit nr. 9749/2007, u realizua përmes vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”.

21. Ligji nr. 9749/2007 përcaktonte rregullat dhe parimet përmes të cilave fitohen gradat policore. Neni 41/1, i ligjit nr. 9749/2007, parashikonte: *“Ngritjet në gradë nga ‘inspektor’ deri në ‘drejtues i parë’ bëhen nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues, që përfshin raportet e vlerësimit të punës dhe një provimi, i cili teston aftësitë e aplikantëve për të marrë gradën pasardhëse. E drejta për të marrë pjesë në këtë proces përcaktohet në pikën 4 të këtij neni.”*

22. Neni 41/5, shkronja “a”, i ligjit nr. 9749/2007, parashikonte se punonjësve të Policisë u lind e drejta për të konkurruar në procesin e përzgjedhjes pas plotësimit të kohës së qëndrimit në gradë, duke përcaktuar afatet e nevojshme të vjetërsisë për secilën prej gradave. Në nenin 42, të këtij ligji, parashikoheshin kushtet për fitimin e gradës si vijon: *“1. a) ngritja në gradë e punonjësit të policisë nënkupton ngritjen e tij në detyrë, sipas tabelës së funksioneve korresponduese për çdo gradë, sipas nenit 39 të këtij ligji. Ngritjet në gradë bëhen vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë. Në urdhrin për ngritjen në gradë, autoriteti përgjegjës përcakton, gjithashtu, funksionin përkatës të punonjësit të Policisë; b) punonjësit e Policisë mund të ngrihen në gradë vetëm pasi të kenë përfunduar me sukses kursin e trajnimit përkatës për atë gradë; c) punonjësit e Policisë zgjidhen për të ndjekur kursin e trajnimit duke u bazuar në listat emërore të së drejtës për gradët hartuar pas procesit konkurrues; ç) pas përfundimit me sukses të trajnimit përzgjedhja për ngritje në gradë bëhet sipas listës emërore të së drejtës për gradë, të përcaktuar në pikën 1 shkronja “c” të këtij neni.”*. Gjithashtu, neni 3.1, i VKM-së nr. 803, datë 21.11.2007, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre” parashikonte se pas kalimit në sistemin e ri të gradave ngritja në gradë do të realizohet, sipas parashikimeve të nenit 41, të ligjit nr. 9747/2007.

23. Në analizë të dispozitave ligjore dhe nënligjore të mësipërme Kolegji vlerëson se procedura e fitimit të gradës policore, sipas ligjit nr.

9749/2007, pas kalimit në sistemin e ri të gradave, realizohet ekskluzivisht përmes procesit të fitimit të gradës me konkurrim. Sipas kërkesave të ligjit, punonjësi i policisë do të duhet t’i nënshtrohet më parë procesit kualifikues dhe testimit, në mënyrë që të realizohet efektivisht e drejta e ngritjes në gradë dhe vetëm në përfundim të kësaj procedure, organi kompetent do të mund të merrte vendim për fitimin ose jo të gradës.

24. Sipas ligjit nr. 9747/2007, ngritja në gradë nënkuptonte ngritjen në detyrë dhe jo të anasjellën. Ngritja në detyrë nuk prezumon vetiu përfitimin e gradës, vetëm për shkak të ushtrimit të funksionit. Në vështirim të dispozitave të mësipërme çmohet se ligjvënësi qartësisht ka sanksionuar se fitimi i gradës policore realizohet përmes një procedure administrative, e cila, *së pari*, kërkon kalimin me sukses të procedurës konkurruese dhe, *së dyti*, ndjekjen e trajnimit korrespondues për secilën gradë policore. Në këtë kuptim, ngritja në gradë sipas ligjit nr. 4979/2007, pas sistemit të ri të gradave, kërkon plotësimin kumulativ të kushteve vijuese:

1. Punonjësi i policisë duhet të plotësojë kushtin e vjetërsisë në gradë, sipas nenit 41/5, të ligjit nr. 4979/2007;

2. Ngritja në gradë realizohet vetëm për të plotësuar vendet e lira që ka sistemi i policisë për çdo gradë dhe, për këtë arsye, ngritja në gradë sjell ngritjen në detyrë;

3. Ngritja në gradë kërkon kalimin me sukses të procesit të vlerësimit konkurrues;

4. Në vijim, punonjësit duhet të ndjekin kursin e trajnimit përkatës për gradë.

25. Një ndër risitë e ligjit nr. 9747/2007 ishte përcaktimi i një sistemi të ri gradash policore. Në këtë kontekst lindi nevoja për ekuivalentimin e gradave, të fituara sipas ligjit të mëparshëm nr. 8643/2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”. Sipas nenit 126, të ligjit nr. 9749/2007, kalimi në sistemin e ri të gradave realizohet përmes procesit të ekuivalentimit të tyre në mbështetje të VKM-së nr. 803, datë 21.11.2007, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”.

26. Neni 126/2, i ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, parashikonte: *“Punonjësi merr gradën që i korrespondon funksionit që kryen vetëm nëse ka minimalisht 2/3 e vjetërsisë së shërbimit, llogaritur sipas afateve të përcaktuara në nenin 41, shkronja “a”, të këtij ligji. a) Punonjësit të*



policisë që nuk plotëson vjetërsinë për gradën që i korrespondon funksionit, që kryen në çastin e kalimit i jepet grada më e lartë për të cilën plotëson minimumi 2/3 e vjetërsisë së shërbimit, duke e emëruar në një funksion që i korrespondon gradës që merr.”.

27. VKM-ja nr. 803, date 21.11.2007 përcaktonte funksionin korrespondues për çdo gradë, në përputhje me parashikimet e ligjit të ri, si dhe ekuivalentimin e gradave të reja me ato të vjetra. Në këtë akt nënligjor parashikohej: *“Punonjësi personeli i policisë merr gradën, që i korrespondon funksionit që kryen, vetëm nëse në çastin e kalimit në këtë sistem gradash, ka vjetërsi shërbimi, jo më pak se: a) 1 vit e 4 muaj për gradën ‘inspektor’, përfshirë edhe periudhën e shkollimit policor, me përjashtim të punonjësve të policisë, që janë në periudhën e provës; b) 2 vjet e 8 muaj për gradën ‘kryeinspektor’; c) 4 vjet për gradën ‘nënkomisar’, përfshirë edhe periudhën e shkollimit policor. Specialistëve të lartë të policisë në detyrë, u jepet grada ‘nënkomisar’ edhe, nëse nga përlllogaritja nuk plotësojnë vjetërsinë e shërbimit, përcaktuar në këtë shkronjë; ç) 6 vjet për gradën ‘komisar’; d) 8 vjet për gradën ‘kryekomisar’; dh) 10 vjet për gradën ‘drejtues’; e) 12 vjet e 8 muaj për gradën ‘drejtues i parë’; 15 vjet e 4 muaj për gradën ‘zëvendësdrejtor i përgjithshëm’.* 3. Pas kalimit në sistemin e ri të gradave, ngritja në gradë bëhet sipas afateve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 41, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, *‘Për Policinë e Shtetit’ ...*”. Punonjësit e policisë përmes ekuivalentimit të gradës përfitonin gradën, në përputhje me funksionin vetëm nëse plotësohej kushti i vjetërsisë në gradën që i korrespondonte funksionit, në të kundërt punonjësi përfitonte gradën më të lartë sipas vjetërsisë përkatëse në gradë.

28. Sipas akteve ligjore dhe nënligjore të mësipërme, ndryshe nga rregulla e përgjithshme e parashikuara në nenet 41 dhe 42, të ligjit nr. 9749/2007, për fitimin e gradës policore, në procesin e ekuivalentimit të gradave të vjetra me ato të reja, u ndoq parimi “funksioni përcakton gradën”. Kolegji vlerëson se kjo qasje e ligjvënësit, në vështrim të situatës ligjore dhe faktike të kohës ka qenë e drejtë dhe ka ardhur natyrshëm në kushtet ku ekuivalentimi i gradës nuk përbënte fitim të një grade të re dhe as përparim në karrierë, por vetëm barasvlerësim të sistemit të gradave, për shkak të ndryshimeve ligjore.

29. Për sa më sipër, Kolegji çmon të sjell në vëmendje se ngritja ose ulja në gradë, për shkak të ekuivalentimit të gradave, ndjek një regjim juridik të

ndryshëm nga fitimi i gradës policore, për shkak të përparimit në karrierën policore.

30. I njëjti regjim juridik gradimi është ruajtur edhe për punonjësit e policisë, të cilët u rripranuan në Policinë e Shtetit, pasi kanë ndërprerë marrëdhënien e punës, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9749/2007, në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 917, datë 4.10.2013, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 803 datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre’”.*

31. Nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se në kuptim të ligjit nr. 9479/2007, pas sistemit të ri të gradave, për fitimin e gradës policore nga niveli “inspektor” deri në nivelin “drejtues i parë”, punonjësit e policisë duhet t’i nënshtroheshin procedurës konkurruese, në përputhje me parashikimet e neneve 41 dhe 42 të ligjit.

32. Kolegji vlerëson se të njëjtën qasje për mënyrën e fitimit të gradave policore, ka edhe ligji i ri, aktualisht në fuqi, nr. 108/2014, *“Për Policinë e Shtetit”.* Në kreun VIII të këtij ligji titulluar *“Gradat”*, rregullohet sistemi, hierarkia dhe llojet e gradave në Policinë e Shtetit, gjithashtu, kriteret për dhënien dhe trajnimin përkatës për fitimin e gradës, përcaktimin e funksioneve takuese për gradë, si dhe procedura administrative e ankimit për të gjitha fazat e procesit të fitimit të gradës policore. Në dispozitat përkufizuese të ligjit nr. 108/2014, grada policore është konceptuar, si: *“shprehje e hierarkisë policore, emërtimi i çdo shkalle dhe shenja dalluese, shprehje e cilësive individuale, eksperiencës dhe përgjegjësisë në ushtrimin e funksioneve në Policinë e Shtetit, që fitohet nga punonjësi i policisë nëpërmjet një procesi konkurrues.”* (neni 6).

33. Ligji nr. 108/2014 përcakton se ecuria në karrierë e punonjësve të Policisë së Shtetit, bazohet në avancimin gradual dhe meritokratik në gradë policore, sipas konfigurimit të përgjithshëm të sistemit të gradave të parashikuara në të. Përmes ligjit nr. 108/2014, legjislatori synon rishikimin e rolit të gradave në Policinë e Shtetit, duke ribashkuar gradën me funksionin, e më pas funksionin me trajtimin financiar.

34. Legjislatori e ka konceptuar gradën policore si një e drejtë që fitohet nëpërmjet procesit vlerësues e konkurrues, duke i njohur kompetencën ekskluzive autoritetit përkatës, komisionit të



gradimit, për zhvillimin e karrierës policore të punonjësve të policisë, përmes ecurisë në gradë.

35. Neni 51, i ligjit nr. 108/2014, parashikon sistemin e gradave policore në rend hierarkik: *“1. Gradat në Policinë e Shtetit, sipas rendit hierarkik rritës, emërtohen, si më poshtë: a) inspektor; b) nënkomisar; c) komisar; ç) kryekomisar; d) drejtues; dh) drejtues i parë; e) drejtues i lartë; ë) drejtues madhor. 2. Autoriteti përgjegjës për vlerësimin e përparimit të punonjësve të policisë në karrierë janë komisionet e gradimit. Përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit të tyre përcaktohet në rregulloren e Policisë.”*

36. Në nenet 53 dhe 54, të ligjit nr. 108/2014, parashikohet procedura për fitimin e gradës, autoriteti përgjegjës për dhënien e gradës përkatëse dhe parimet e përgjithshme për fitimin e gradave policore. Në nenin 53, pika 2 të ligjit parashikohet se grada “nënkomisar” deri “drejtues i parë” jepet nga drejtori i Policisë së Shtetit për punonjësit, të cilët fitojnë gradën përmes procesit të konkurrimit sipas ligjit. Në nenin 54 të ligjit sanksionohet: *“1. Fitimi i gradës “nënkomisar” deri në “Drejtues i parë” bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues nga një komision gradimi. 2. Çdo vit evidentohen nevojat për çdo gradë për vitin pasardhës. Drejtori i Policisë së Shtetit, në varësi të nevojave dhe prioritetëve, miraton urdhrin për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës respektive. 3. Fitimi i gradës bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë dhe vetëm për gradën pasardhëse. 4. Të drejtën për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit e kanë të gjithë punonjësit e policisë që plotësojnë kriteret e vendosura në këtë ligj.”*

37. Ligjvënësi, në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë, në frymë të ligjit dhe *ad litteram* ka përcaktuar se procedura e fitimit të gradës policore për punonjësit e Policisë së Shtetit kalon nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësues dhe konkurrues, i cili administrohet nga komisioni i gradimit. Ligji nr. 108/2014 njihet kompetencën ekskluzive dhe diskrecionare të komisionit të gradimit për vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në procesin konkurrues për fitimin e gradës, duke përcaktuar parimet, kriteret, fazat e testimit të kandidatëve dhe ankimin për procesin administrativ të fitimit të gradës policore. Gjithashtu, ligji i njihet autoritetit përgjegjës, drejtorit të Policisë së Shtetit, kompetencën diskrecionare për të vlerësuar nevojat e sistemit dhe në varësi të prioritetëve të çelë procedurat për fitimin e gradës. Ligji nr. 108/2014 synon që çdo pozicion brenda

strukturave të Policisë së Shtetit të ushtrohet nga mbajtësi i gradës takuese dhe, për këtë qëllim, dispozitat ligjore i kushtojnë një vëmendje të veçantë procedurës së fitimit të gradës, avancimit meritokratik dhe gradual në gradë të punonjësve të Policisë së Shtetit. Në këtë mënyrë, ligjvënësi garanton plotësimin e nevojave të sistemit policor me punonjës të kualifikuar, duke synuar shkrirjen e gradës me funksionin e ushtruar efektivisht.

38. Përcaktimi i funksionit korrespondues për secilën prej gradave policore ka gjetur rregullim të detajuar në VKM-në nr. 892, datë 21.12.2016. Pika 3 e këtij akti normativ nënligjor nxjerr në pah nevojën e bashkimit përfundimtar të gradës me funksionin, duke parashikuar edhe zgjidhjen për rregullimin përfundimtar të situatës kur pozicioni i punës, pra funksioni që ushtron efektivisht një punonjës policie, nuk përputhet me gradën e caktuar sipas ligjit. Në këtë dispozitë parashikohet: *“Punonjësit e Policisë së Shtetit, të emëruar në bazë të vendimit nr. 917, datë 4.10.2013, të Këshillit të Ministrave, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 803, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, të ndryshuar, në funksione të njëjta apo të barasvlershme me ato të parashikuara në këtë vendim, vazhdojnë të qëndrojnë në këto detyra, duke mbajtur gradën ekzistuese për një periudhë deri në 1 vit. Nëse gjatë kësaj periudhe këta punonjës nuk fitojnë gradën korresponduese të funksionit që mbajnë, emërohen në një funksion tjetër, në përputhje me gradën që kanë.”*

39. Neni 55, i ligjit nr. 108/2014, rendit kriteret që duhet të përmbushin punonjësit e policisë për fitimin e gradës nga niveli “nënkomisar” në nivelin “drejtuesi i parë”, konkretisht: *“a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës jo më të ulët se 70 për qind të vlerësimit të përgjithshëm; b) të përmbushë kriteret për pozicionin e punës; c) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rënda, sipas afatit të përcaktuar në këtë ligj; ç) të ketë përfunduar ciklin e parë të studimeve në arsimin e lartë; d) të ketë përfunduar trajnimin e detyrueshëm për gradë; dh) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal; e) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë; ë) të plotësojë kohën e qëndrimit në gradë, sipas afatëve të mëposhtme: i. nga “inspektor” në “nënkomisar”, 5 vite; ii. nga “nënkomisar” në “komisar”, 3 vite; iii. nga “komisar” në “kryekomisar”, 3 vite; iv. nga “kryekomisar” në “drejtues”, 5 vite; v. nga “drejtues” në “drejtues i parë”, 3*



vite; vi. nga “drejtues i parë” në “drejtues i lartë” ose “drejtues madhor”, 2 vite.”.

40. Plotësimi i kriterëve formale për fitimin e gradës, të parashikuara në nenin 55 të ligjit, nuk përbën kushtin e vetëm për përfitimin e gradës policore. Ligji nr. 108/2014, në nenet 55–59 ka parashikuar të gjitha hallkat e procedurës administrative për fitimin e gradave policore. Kriteret e parashikuara në nenin 55 të ligjit kanë natyrë objektive formale, plotësimi i të cilave verifikohet nga strukturat qendrore të burimeve njerëzore gjatë fazës së aplikimit, testimit, trajnimit, deri në momentin e fitimit të gradës. Këto kriterë përbëjnë vetëm kushtet formale që shoqërojnë aplikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë procedurave vlerësuese dhe konkurruese.

41. Për fitimin e gradës policore punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të kalojnë me sukses fazën e testimit me shkrim, intervistës me gojë dhe specifikisht për përfitimin e gradës “kryekomisar” deri në “drejtues i parë” parashikohet edhe kryerja e ushtrimeve vlerësuese. Kufiri minimal për kalimin e testimit përkatës përcaktohet nga drejtori i Policisë së Shtetit dhe nuk mund të jetë më i ulët se 70%. Numri i personave të shpallur fitues për përfitimin e gradës nuk mund të jenë më shumë se 30% mbi numrin e vendeve të lira të shpallura për gradën përkatëse.

42. Konkurrentët e shpallur fitues për gradat “nënkomisar” dhe “drejtues” përfundojnë programin e arsimit përkatës, ndërsa për gradat e tjera duhet të kenë përfunduar programin e trajnimit përkatës sipas gradës. Në vijim të procedurës administrative hartohet lista emërore e së drejtës për gradë policore, duke filluar nga punonjësi me vlerësimin më të lartë në rend zbritës, duke u mundësuar të drejtën e përzgjedhjes së pozicionit të lirë për emërim. Në përfundim të procedurës sa më sipër, dhënia e gradës policore realizohet përmes urdhrit të drejtorit të Policisë së Shtetit, bazuar në aktin e vlerësimit të komisionit të gradës. Në këtë urdhër përcaktohet edhe funksioni që do të kryejë punonjësi.

43. Nisur nga analiza e mësipërme e kuadrit ligjor mbi fitimin e gradave policore, Kolegji vlerëson se në mbështetje të ligjit nr. 108/2014, fitimi i gradës policore realizohet përmes një procedure administrative që kalon nëpër disa faza dhe kuadrohet nga detyrimi i kandidatëve për plotësimin e një sërë kriteresh formale. Kolegji

konkludon se procesi i dhënies së gradave policore, në mbështetje të ligjit nr. 108/2014, kushtëzohet, *së pari*, me plotësimin e kriterëve objektive për konkurrim, të cilat listohen në nenin 55, të ligjit dhe, *së dyti*, me kalimin me sukses të procedurës konkurruese të testimit dhe të kryerjes së trajnimeve përkatëse. Gjithashtu, vlerësohet se këto faza duhet të paraprihen nga ekzistenca e vendeve vakante për funksionet takuese, të cilat i korrespondojnë gradës, për të cilën zhvillohet konkurrimi. Ky proces formësohet nëpërmjet ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të organit publik, në drejtim të çeljes dhe administrimit tërësor të procedurave konkurruese.

B. Parimet kushtetuese dhe procesi i fitimit të gradave policore

44. Kolegji, nisur nga autoriteti kushtetues që gëzon në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit përfundimtar dhe të drejtë të ligjit, në përputhje me parimet koventore dhe kushtetuese, në vështrim të problematikave që parashtron interpretimi i hasur gjerësisht nga ana e gjykatave të faktit për procesin e fitimit të gradave policore dhe në mbështetje të analizës ligjore të parashtruar sa më sipër, vlerëson se në rastin konkret implikohet zbatueshmëria e parimeve kushtetuese të ndarjes dhe e balancimit të pushteteve, të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit dhe të parimit të shanseve të barabarta.

45. Parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve sanksionohet në nenin 7 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet: “*Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore*”. Kolegji vlerëson se ky parim synon të garantojë që të gjitha pushtetet janë të kufizuara dhe i nënshtrohen një kontrolli të balancuar. Parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve përbën thelbin e shtetit të së drejtës.

46. Pavarësia funksionale e organeve dhe institucioneve kushtetuese është e lidhur ngushtësisht me përmbajtjen e veprimtarisë që këto realizojnë, e cila rregullohet drejtpërsëdrejti dhe e ka themelin e vet në dispozitat përkatëse kushtetuese. Në përputhje me detyrat që i ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve qendrore, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që,



sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese. (*Shih vendimi nr. 19, datë 27.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese.*)

47. Kolegji vlerëson se asnjë institucion pushteti nuk mund të marrë përsipër kompetenca nga një institucion tjetër e as mund të transferojë ose të heqë dorë prej tyre. Kolegji çmon se çdo vendimmarrje gjyqësore që detyron organin publik të njohë gradën policore punonjësve të policisë, pa lejuar zhvillimin sipas ligjit të një procedure administrative vlerësimi nga komisioni përkatës i gradimit, duke ushtruar në mënyrë të paligjshme kompetenca ekskluzive dhe ekzekutive të organit publik, në cenim të pushtetit të tij diskrecionar për të vlerësuar përmbushjen e të gjitha kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligj për fitimin e gradës, në thelb ka zëvendësuar funksionin që ka organi publik në këtë proces ligjor të rëndësishëm. Një qëndrim i tillë cenon rëndë parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe parimin e ligjshmërisë.

48. Shtrirja e kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative përfshin kontrollin e ligjshmërisë së veprimit administrativ dhe veprimtarisë administrative në tërësi, në drejtim të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të organit publik, i cili garantohet përmes parimit kushtetues të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve. Funksioni thelbësor i kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative, kryesisht synon të garantojë mungesën e arbitraritetit në ushtrimin e kompetencave administrative të organit publik. Në këtë drejtim, gjykata duhet të jetë e kujdesshme për të mos vepruar vetë si një organ administrativ, përveç rasteve kur një gjë e tillë parashikohet shprehimisht nga ligji.

49. Autoriteti publik i organeve administrative ushtrohet përmes kompetencave urdhëruese ligjzbatuese, si edhe nëpërmjet kompetencave diskrecionare. Diskrecioni konsiderohet i pashmangshëm dhe i lidhur në mënyrë të natyrshme me vetë karakterin e veprimtarisë administrative, madje i konsideruar se përbën vetë “thelbin e veprimit administrativ”.

50. Kolegji vlerëson se kompetencat diskrecionare gëzojnë legjitimitet kushtetues dhe janë të pajtueshme me shtetin e së drejtës, nëse ato i janë dhënë administratës publike me ligj. Pushteti diskrecional është pushteti që i jep një autoriteti administrativ një shkallë të caktuar lirie për të marrë

vendime, duke i mundësuar që të zgjedhë mes disa vendimeve të pranueshme ligjore atë që është më i përshtatshëm. Ushtrimi diskrecionar i kompetencave është antiteza e veprimtarisë së ngushtë ligjzbatuese të organit publik, në zbatim të normave urdhëruese të së drejtës. Hapësira e vlerësimit të organit publik mbi zgjedhje të caktuara përbën thelbin praktik të kompetencës diskrecionare. Parimi i ligjshmërisë, vendos kufijtë negativë të sjelljes së organit publik, duke e detyruar atë të veprojë në zbatim të kërkesave urdhëruese të ligjit. Nga ana tjetër, kompetenca diskrecionare e organit duhet të jetë e parashikuar në ligj, duke deleguar gjykimin autonom për kryerjen e zgjedhjeve alternative të caktuara, për të qenë në përputhje me parimin e ligjshmërisë. Në këtë kuptim, diskrecioni është ushtrimi i pushtetit të autorizuar nga ligji, por i kufizuar nga e drejta.

51. Ligji nr. 108/2014 ka parashikuar një sërë kompetencash diskrecionare të organit publik në procesin administrativ për fitimin e gradës si: evidentimi i nevojave për çdo gradë sipas prioriteteve dhe miratimi i urdhrit për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës (neni 54, pika 1), verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kritereve për konkurrim gjatë fazës së aplikimit, testimi, trajnimit deri në momentin e fitimit të gradës (neni 56, pikat 1 dhe 2), përcaktimi i nivelit minimal për kalimin me sukses të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë (neni 57, pika 3), si dhe dhënien e gradës përmes vlerësimit në tërësi nga ana e komisionit të gradimit (neni 59).

52. Kolegji vlerëson se ligji nr. 108/2014 ka autorizuar në mënyrë të shprehur hapësirën diskrecionare për vlerësim të organit publik, përkatësisht Drejtorit të Policisë së Shtetit lidhur me vlerësimin e nevojave dhe prioriteteve për çeljen e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës, sikurse ka autorizuar komisionin e gradimit për vlerësimin dhe përparimin e punonjësve të Policisë së Shtetit në karrierë, në të cilin përfshihet edhe pjesëmarrja në procesin konkurrues për fitimin e gradës. Kolegji çmon se ka rëndësi të veçantë të sjellë në vëmendje, se këto kompetenca diskrecionare nuk janë të pakufizuara, sepse përndryshe do të cenohej thelbi i shtetit të së drejtës. Kolegji vlerëson se sistemi procedural i drejtësisë administrative synon vendosjen e një balance ndërmjet respektimit të kërkesave të



veprimtarisë administrative, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave të individit, nga ana tjetër.

53. Qëllimi i një koncepti kushtetues të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve siguron të parandalojë çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrollat dhe ekuilibrat që njih Kushtetuta i japin secilës degë pushtet që të kompensojnë apo të zbusë ato të degëve të tjera. Ekzistojnë mjete apo mekanizma që balancojnë pushtetet, sepse në analizën e fundit asnjë pushtet më vete nuk është në gjendje të përmbushë misionin, nëse veprimtaria e tij nuk harmonizohet me veprimtarinë e pushteteve të tjera dhe nëse nuk sigurohet një ekuilibër, bashkërendim dhe kontroll reciprok, që, natyrisht, nuk ndërhyr në atë masë sa të dëmtojë misionet e tyre kushtetuese (*shih vendimin nr. 11, datë 6.3.2004, të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Kolegji vlerëson se misioni i mbrojtjes së të drejtave dhe i lirive themelore që i është ngarkuar pushtetit gjyqësor mund të realizohet vetëm atëherë kur zbatimi i normës nga pushteti ekzekutiv, i cili ka ndërhyrë në sferën e të drejtave të qytetarëve, bëhet i kontrollueshëm nga gjykatat administrative. Për aq sa administratës i është lejuar hapësirë vlerësimi diskrecionar, ajo duhet të veprojë në përputhje me detyrat e veta funksionale dhe të shfrytëzojë mundësitë që i janë dhënë në përputhje me ligjin. Ky zbatim i së drejtës kryhet nën urdhërimet e parimit të shtetit të së drejtës e, sidomos, të parimit të barazisë. Ushtrimi i gabuar i vlerësimit diskrecionar nga ana e autoriteteve publike i nënshtrohet kontrollit të gjykatave administrative. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes mund të garantohet vetëm nëpërmjet sistemit të kontroleve dhe të ekuilibrave.

55. Në këtë kuptim, shtrirja e juridiksionit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative të organeve publike ka për qëllim të garantojë parimin e ligjshmërisë dhe kontrollin gjyqësor mbi veprimtarinë diskrecionare të organit publik, por pa dubluar ose zëvendësuar kompetenca të cilat ekskluzivisht i janë njohur organit publik, sipas ligjit. Kolegji vlerëson se ky është një qëndrim i konsoliduar që pasqyrohet gjerësisht edhe në praktikën e gjykatave supreme evropiane. Në rastin kur organi publik ka një pushtet diskrecionar ndërmjet disa zgjidhjeve, ligjshmëria e vendimmarrjes së tij mund të kontrollohet në gjykatë, por në rast se gjykata konkludon se vendimi është i paligjshëm nuk mund të vendosë

vetë për thelbin. Gjykata ka të drejtën të rikthejë çështjen edhe njëherë para organit administrativ kompetent, në mënyrë që ky i fundit të marrë një vendim të ri, brenda pushtetit të tij diskrecionar (*shih vendimi nr. 207, datë 21.12.2004, i Gjykatës Kushtetuese Belge*).

56. Kolegji çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në këtë drejtim, kur në rastin *Meltex Sh.p.k. dhe Mesrop Movsesyan kundër Armenisë* (*shih prg. 81, 2008*), mbi konstatimin e shkeljes së nenit 10 të Konventës, për shkak të ushtrimit të diskrecionit, në lidhje me refuzimin për dhënien e licencës, Gjykata ka arsyetuar, se, me qëllim që ligji i brendshëm të përmbushë kërkesat cilësore, ai duhet të sigurojë mjete ligjore, mbrojtje kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike lidhur me të drejtat e garantuara nga Konventa. Në çështje që ndikojnë të drejtat themelore do të ishte në kundërshtim me shtetin e së drejtës një diskrecion ligjor që i është njohur ekzekutivit të shfaqet në formën e një pushteti të pakontrolluar. Rrjedhimisht, ligji duhet të parashikojë mjaftueshëm qartë edhe shtrirjen e çdo diskrecioni të tillë që u është dhënë autoriteteve kompetente, si edhe mënyrën se si ushtrohet ky diskrecion (*Navalnyy kundër Rusisë 2018, prg. 113*), duke pasur parasysh synimin legjitim të masës përkatëse, me qëllim që t'i japë individit mbrojtjen e duhur ndaj ndërhyrjeve arbitrare (*Maestri kundër Italisë 2004, prg. 30*).

57. Kolegji vlerëson se në këndvështrim të standardeve konventore, gjykatat administrative gëzojnë pushtetin e kontrollit të kufijve ligjorë të vendimmarrjes së autoriteteve publike. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vlerëson se juridiksioni gjyqësor në kontrollin e veprimtarisë administrative të organit publik, në procesin e dhënies së gradave, mund të shtrihet në drejtim të vlerësimit të gabuar të ligjit, konstatimit të rrethanave të pasakta ose kryerjes së gabimeve procedurale, të tilla që kanë ndikuar në vlerësimin e gabuar të përmbushjes së kriterëve formale për aplikimin në fazën e konkurrimit, duke përfshirë kundërshtimin e secilës prej fazave administrative për fitimin e gradës, të cilat, sipas nenit 60 të ligjit nr. 108/2014, i nënshtrohen paraprakisht edhe procesit të ankimit administrativ dhe veçanërisht kontrollit mbi rastet e ushtrimit *ultra vires* të pushtetit diskrecionar të organit publik lidhur me



administrimin tërësor të procesit të konkurrimit për fitimin e gradës. Kolegji vlerëson se juridiksioni gjyqësor që gëzojnë gjykatat administrative në këtë proces duhet të ketë për qëllim mbrojtjen e meritokracisë për avancimin në gradë në kuadër të lirisë së ushtrimit të profesionit dhe nuk mund të zëvendësojë organin publik, konkretisht komisionin e gradimit, duke dhënë gjyqësisht gradën policore, në kushtet ku aplikanti nuk i është nënshtruar konkurrimit për fitimin e gradës.

58. Kolegji vlerëson se nënshtrimi i punonjësve të policisë në procedurën konkurruese për fitimin e gradës është në përputhje me parimet kushtetuese të sigurisë juridike, stabilitetit ligjor dhe pritshmërive legjitime, në kushtet ku legjislacioni mbi fitimin e gradave policore, që në vitin 2007, ka ofruar qartësi dhe qëndrueshmëri, në drejtim të përcaktimit të mënyrës së fitimit të gradës përmes procedurave konkurruese. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se fitimi i gradave policore gjyqësisht, pa iu nënshtruar më parë punonjësit e policisë procedurës konkurruese, cenon rëndë edhe parimin e shanseve të barabarta.

1.59. Jurisprudenca kushtetuese ka elaboruar në vijimësi parimin e barazisë, duke vlerësuar se ky parim synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. (*Shih vendimet nr. 34, datë 10.4.2017, nr. 10, datë 29.2.2016; nr. 71, datë 27.11.201, nr. 20, datë 20.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën autoritative të Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane, në të cilën është trajtuar e drejta e shanseve të barabarta në fushën e vlerësimeve konkurruese. Sipas parimit të shanseve të barabarta, e cila mbizotëron në të drejtën mbi provimet për ata që merren në provime të ngjashme, duhet të vlejë me sa të jetë e mundur, kushte të ngjashme të marrjes në provim dhe kriteret të ngjashme vlerësimi. Do të ishte e papajtueshme nëse kandidatëve të veçantë, të cilët fillojnë një proces gjyqësor administrativ, do t'u jepej shansi i një vlerësimi të pavarur e pa kuadrin e krahasimeve. Do të cenohej rëndë gjykimi i barabartë i të gjithë kandidatëve të ngjashëm. Ai është i mundur vetëm kur komisioneve të provimeve u lihet një hapësirë veprimi në vlerësimet për provime specifike dhe nëse kufizohet kontrolli gjyqësor. Provimet e shtetit, të

cilat kufizojnë pranimin për profesione akademike, kërkojnë vlerësime të vështira, të cilat duhet të merren duke marrë parasysh shanset e barabarta për të gjithë kandidatët në një kontekst të përgjithshëm të procedurës së provimit dhe të mos kryhen menjëherë në mënyrë të izoluar në proceset administrative të kandidatëve të veçantë. Vetëm vlerësime për provime specifike, shpeshherë të gërshetuara në mënyrë të pandashme me gjykime profesionale, mbeten në kompetencën e fundit vendimmarrëse të komisioneve të provimit. Por as përgjigjja për çështje të tilla vlerësimi nuk i shpëton çdo kontrolli. Hapësira e lirë e vlerësimit ka kufij, respektimi i të cilëve duhet verifikuar me rrugë gjyqësore (*shih vendimin e Gjykatës Federale Gjermane 1 BvR 419/81 dhe 21 3/83, i Senatit të Parë, datë 17.4.1991*).

60. Së fundmi, Kolegji çmon të theksojë, se procesi konkurrues synon të rrisë profesionalizmin⁵ në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, të garantojë meritokracinë, në kuadër të zhvillimit të tyre profesional, në përputhje me parashikimet e nenit 49 të Kushtetutës, ku sanksionohet: *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.”*

61. Nisur nga kjo analizë e hollësishme që i bëhet çështjes në shqyrtim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konkludon në sentencën unifikuese:

Procesi i fitimit të gradave policore nga niveli “nënkomisar” deri në nivelin “drejtues i parë”, duhet t’i nënshtrohet domosdoshmërisht procedurës së vlerësimit konkurrues, sipas parashikimeve të neneve 50–60 të ligjit

⁵ Në vendimin nr. 55/1999, Gjykata Kushtetuese e RSH-së ka marrë në vlerësim kushtetutshmërinë e nenit 48, të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ku, ndër të tjera, ka theksuar se: *“Format për kualifikimin profesional janë nga më të larmishmet dhe një prej tyre është edhe organizimi i provimit, i cili shërben si nxitje për gjyqtarët për studim, por në të njëjtën kohë shërben edhe si një mjet për të vlerësuar shkallën e dijeve të gjithsecilit, në kuadrin e përgjithshëm të vlerësimit profesional. Në këtë aspekt, pjesëmarrja në provim përbën një detyrë ligjore, që secili gjyqtar, sipas kriterëve të përcaktuara nga ligji, duhet t’i nënshtrohet këtij provimi. Nëse duhet zbatuar ose jo ky detyrim nuk është lënë në vlerësimin e gjyqtarëve, ndërsa përgjegjësia për mospërmbytjen e këtij detyrimi është individuale dhe çmohet në çdo rast konkret në varësi të shkaqeve që pretendon gjithsecili.”*



nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”. Plotësimi i kriterëve formale për fitimin e gradës, si vjetërsia në gradën pararendëse dhe/ose ushtrimi efektiv i funksionit, në përputhje me gradën e pretenduar, nuk mund të sjellin fitimin gjyqësisht të gradës policore, pa iu nënshtruar më parë punonjësit e Policisë së Shtetit një procesi vlerësimi konkurrues nga komisioni i gradimit.

III. Në lidhje me shqyrtimin e rekursit të palës së paditur

62. Rekursi plotëson kushtet formale të pranueshmërisë dhe është ushtruar brenda afatit 30-ditor për paraqitjen e tij. Vendimi nr. 1812, datë 26.4.2018, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, përmes të cilit është lënë në fuqi vendimi nr. 202, datë 5.4.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër është marrë në zbatim të gabuar të ligjit.

63. Paditësi i është njohur grada “komisar” me urdhrin nr. 3052/1, datë 2.11.2010, të drejtorit të Policisë së Shtetit. Me urdhrin nr. 2304 prot., datë 15.10.2015, të drejtorit të Policisë së Shtetit, paditësi rezulton të jetë transferuar përkohësisht në detyrën shëf komisarati, pranë Komisarit të Policisë Malësi e Madhe, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër e, më pas, me urdhrin nr. 452, datë 8.2.2016, të drejtorit të Policisë së Shtetit, paditësi është transferuar dhe emëruar në detyrën shëf komisarati, në Komisaratin e Policisë Malësi e Madhe, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër.

64. Paditësi ka pretenduar, se, për shkak të funksionit që ushtron dhe plotësimit të viteve në vjetërsi në gradë dhe pasi pala e paditur nuk ka zhvilluar konkurrenca për fitimin e gradave policore, duhet t'i njihet grada “kryekomisar”. Pala e paditur përmes shkresës nr. 159/1 prot, datë 9.2.2017 ka refuzuar kërkesën e paditësit për njohjen e gradës “kryekomisar”, për shkak se ligji nr. 108/2014 nuk parashikon marrjen e gradës, sipas pozicionit të punës dhe se fitimi i gradës mundësohet vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në proces konkurrimi, pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara në ligj.

65. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër me vendimin nr. 202, datë 5.4.2017, ka pranuar padinë, duke vlerësuar se paditësi i takon përfitimi i gradës, për shkak se plotëson kushtin e vjetërsisë në detyrë dhe efektivisht ushtron funksionin, në përputhje me gradën e pretenduar “kryekomisar”. Gjykata ka vlerësuar, se, në kuadër të parimit të sigurisë juridike dhe të drejtave të

fituara, padia është e mbështetur në ligj. Vendimi nr. 202, datë 5.4.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër është lënë në fuqi me vendimin nr. 1812, datë 26.4.2018, të Gjykatës Administrative e Apelit.

66. Në vijim të përfundimit njëses, Kolegji vlerëson se plotësimi i kriterit të ushtrimit të funksionit të kërkuar për gradën e pretenduar dhe vjetërsisë në gradë, nuk mund të sjellë përfitimin gjyqësisht të gradës policore të pretenduar, pa iu nënshtruar procedurës së konkurrimit vlerësues nga komisioni i gradimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 108/2014.

67. Në vështrim të analizës së mësipërme, Kolegji vlerëson, se pretendimet e paditësit se plotëson kushtet për fitimin e gradës dhe duhet ta fitoj atë gjyqësisht, pasi organi nuk ka hapur procedurën e konkurrimit vlerësohet i pabazuar në ligj. Në këtë aspekt, Kolegji çmon të theksojë se paditësi do mund të kishte orientuar gjykimin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi në një tjetër drejtim, duke vlerësuar gjyqësisht ushtrimin e diskrecionit nga ana e palës së paditur në administrimin dhe në` çeljen e procesit të konkurrimit dhe jo duke pretenduar dhënien e menjëhershme të gradës nga gjykatat, në kushtet ku nuk është ndjekur procedura ligjore konkurruese për fitimin e gradës policore.

68. Sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në rekurs, Kolegji vlerëson se ato nuk janë të bazuara në ligj. Kolegji çmon të ndalet në pretendimin për mungesën e kompetencës tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër. Kolegji sjell në vëmendje se në mbështetje të nenit 13, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, moskompetenca tokësore mund të ngrihet ose të kundërshtohet nga palët vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave. Në këtë drejtim, pala e paditur ka pasur mundësinë të parashtrojë gjatë gjykimit në shkallë të parë çështjen e moskompetencës tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër. Nga aktet bashkëlidhur dosjes gjyqësore nuk rezulton të ketë pasur kërkesa procedurale të kësaj natyre nga pala e paditur. Kolegji vlerëson se çështja e kompetencës tokësore ka rënë në dekadencë dhe nuk mund të merret në shqyrtim gjatë gjykimit pranë Gjykatës së Lartë.

69. Në vështrim të analizës së mësipërme, Kolegji konkludon se vendimet e gjykatave të faktit



janë dhënë në zbatim të gabuar të ligjit dhe se çështja që shtrohet për zgjidhje në mosmarrëveshjen objekt gjykimit është ekskluzivisht çështje ligji, për të cilën nuk është e nevojshme të kryhet rivlerësimi i provave apo i fakteve të vëna në themel të mosmarrëveshjes. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 63, shkronja “dh”, të ligjit nr. 49/2012, pas ndryshimeve me ligjin nr. 49/2021, Kolegji nuk pengohet të zgjidhë në themel mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 63, shkronja “dh”, të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, pas ndryshimeve me ligjin nr. 49/2021, si dhe në nenin 35, pika 4, të ligjit nr. 98, datë 6.10.2016, “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 1812, datë 26.4.2018, të Gjykatës Administrative e Apelit dhe vendimit nr. 202, datë 5.4.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe rrëzimin e padisë së paditësit Leonard Ndreka.

2. Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore publikohet në Fletoren Zyrtare të radhës.

Tiranë, më 15.7.2021

Anëtarë: Sokol Sadushi (Kryesues), Sokol Binaj, Klodian Kurushi, Ilir Panda, Ervin Pupe

VENDIM

Nr. 316, datë 21.7.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS (Për korrigjimin dhe plotësimin e vendimit)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër e përbërë nga:
GJYQTAR: ARDIT KUKA

Asistuar nga sekretarja Teuta Iskurti në Peshkopi, sot më datë 21.7.2021, në seancë gjyqësore publike, përfundoi së shqyrtuari çështjen civile, që i përket:

KËRKUES: Shoqëria tregtare “NEKU” sh.p.k., regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NUIS: L01405006G, me seli në adresën: Rruga Faqe|13132

Pazari, Terminali Bulqizë, me administratore falimentimi znj. Shpresa Breçani.

OBJEKTI: Korrigjimin e gabimit material dhe plotësimin e vendimit datë 16.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me objekt fillimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Neni 312 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, pasi administroi provat, shqyrtoi çështjen në tërësi dhe dëgjoi pretendimet përfundimtare të palëve, përfaqësueses së shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k., administratoren e falimentimit,

VËREN:

Kërkuesi shoqëria tregtare “NEKU sh.p.k.” i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me kërkesën me objekt “korrigjimin dhe plotësimin e vendimit të datës 16.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me të cilin është deklaruar hapja e procedurës së falimentimit të kësaj shoqërie. Në kërkesën, e depozituar me shkrim kërkohet korrigjimi dhe plotësimi i këtij vendimi si në vijim: ndreqjen e gabimit material nga “Pezullimin e aktivitetit të shoqërisë tregtare ‘NEKU’ sh.p.k., që është i pasaktë në “Vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë tregtare ‘NEKU’ sh.p.k., nën administrimin e administratores së falimentimit, deri në likuidimin e shoqërisë; plotësimin e vendimit lidhur me lejet dhe licencat e përfituara shoqëria tregtare, të cilat ruajnë fuqinë dhe vlefshmërinë ligjore; ndreqjen e gabimit material në pikën 10 të dispozitivit nga “sh.a.” në “sh.p.k.”; ndreqjen e gabimit material në pikën 14 të dispozitivit nga “Një kopje e vendimit t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në “Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit t’i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme, me qëllim njoftimin e të gjitha drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe kryerjen e veprimeve konform ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

Me vendimin e datës 16.6.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka pranuar kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit dhe ka disponuar:



1. “Pranimin e kërkesës së shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k.,

2. Hapjen në orën 15:59 min., të datës 16.6.2021, të procedurës së falimentimit të shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k., me administrator z. Alfted Kurti/administratore e përkohshme Shpresa Breçani me seli në adresën: Rruga Pazarit, Terminali, Bulqizë.

3. Emërimin si administratore të falimentimit për shoqërinë “NEKU” sh.p.k të znj. Shpresa Breçani, atësia Dem, amësia Hajerie, e datëlindjes 20.3.1964, licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencë nr. 9 dhe NIPT 71529023, me adresë: rruga “Jordan Misja”, pallati Sara-El, ap. 1/1, Tiranë dhe cel: 068 20 94 103.

4. Pezullimin e aktivitetit të shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k.

5. Ndalohet çdo veprim ekzekutimi mbi pasurinë e debitorit shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k.

6. Të gjithë kreditorët e shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k kanë të drejtë të paraqesin pranë administratores së falimentit pretendimet e tyre brenda 45 ditëve nga publikimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

7. Mbledhja mbi raportimin do të zhvillohet pas 90 ditëve, në datën 16.9.2021, ora 12:00.

8. Të gjithë kreditorët e shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k., të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruar mbi pasuritë e debitorit.

9. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k., t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratores së falimentimit znj. Shpresa Breçani.

10. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “NEKU” sh.a., për verifikim të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

11. Urdhërohet publikimi i vendimit të shkurtuar për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “NEKU” sh.p.k. në Fletoren Zyrtare.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “NEKU” sh.p.k., t’i njoftohet administratores së falimentimit të shoqërisë “NEKU” sh.p.k. znj. Shpresa Breçani.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “NEKU” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “NEKU” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “NEKU” sh.p.k., t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë.

16. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “NEKU” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

17. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “NEKU” sh.p.k sh.a., t’i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Falimentimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

18. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “NEKU” sh.p.k., t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

19. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k., në gazetatat “Panorama” dhe gazeta “Shekulli”.

20. Një kopje e këtij vendimi t’u njoftohet 16 kreditorëve sipas listës së paraqitur nga debitori.

21. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit.

22. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve, nga e nesërmeja e njoftimit të tij.”

Në nenin 312 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se gjykata me kërkesën e palëve ose kryesisht, mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra në shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit.

Për sa i përket plotësimit të vendimit, neni 313 i Kodit të Procedurës Civile, përcakton se secila nga palët, brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e vendimit, mund të kërkojë plotësimin e vendimit, në rast se gjykata nuk është shprehur mbi të gjitha kërkesat për të cilat pala ka paraqitur prova. Gjykata e shqyrton kërkesën me të njëjtin trup gjykues, pasi thërret palët dhe jep këtë vendim plotësues. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përgjithshëm.

Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur në emër të shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k. nga administratorja e falimentimit është e drejtë dhe duhet pranuar. Vendimi duhet të korrigjohet në pikat 4, 10 dhe 14 të këtij dispozitivi. Gjykata gabimisht në pikën 4 të dispozitivit të vendimit është shprehur për pezullimin e aktivitetit të shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k., ndërkohë që ka pranuar hapjen e procedurës së falimentimit. Vazhdimi i aktivitetit të shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k., është i nevojshëm, me qëllim që të vijojë procedura për kryerjen e veprimeve



juridike në kuadër të falimentimit. Në pikën 10 të dispozitivit gabimisht është shënuar “NEKU” sh.a., ndërkohë që kjo shoqëri është organizuar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “NEKU” sh.p.k. Më tej në pikën 14 gabimisht është përcaktuar: “Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë tregtare “NEKU” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ndërkohë që duhet të ishte përcaktuar: “Një kopje e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit t’i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme, me qëllim njoftimin e të gjitha drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe kryerjen e veprimeve konform ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, pasi me hyrjen e ligjit nr. 111/2018, “Për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës” janë suprimuar zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Konstatohet se këtë vendim, gjykata nuk është shprehur për ngritjen e komisionit të përkohshëm të kreditorëve, i cili mbikëqyr veprimtarinë e administratorit të falimentimit dhe që është kërkesë e nenit 29, pika “dh”, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”. Prandaj është e nevojshme që vendimi i datës 16.6.2021 të plotësohet dhe pas pikës 6 të shtohet pika 6/1 për caktimin e komitetit të përkohshëm të kreditorëve. Çmohet se ky komitet duhet të përbëhet nga 5 anëtarë, pasi ka një numër të konsiderueshëm kreditorësh. Në bazë të ligjit, duhet të ketë në përbërje kreditorin më të madh të preferuar, por duke qenë se nuk ka të tillë sipas raportit paraprak të administratorit, mbeten të caktohen kreditorët e tjerë. Duke pasur parasysh listën e kreditorëve të depozituar nga kërkuesi dhe shumën e tyre respektive të kredive, vlerësohet se në përbërje të këtij komiteti të përkohshëm duhet të përfshihen: i) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimpaguesve të Mëdhenj, me seli në Tiranë; ii) shoqëria tregtare “Reden” sh.p.k., me kredi në shumën 15,034,456 lekë; iii) shoqëria tregtare “Raiffeisen Leasing”, me kredi në shumën 13,436,012 lekë; dhe iv) Kurti Trans L 82 sh.p.k., që është kreditori më i madh me kredi në shumën 12,634,704 lekë. Duke pasur parasysh detyrimin ligjor për të përfshirë në këtë komision një përfaqësues nga lista e punëmarrësve të debitorit, gjykata vendosi që anëtari i pestë i komitetit të përkohshëm të jetë z. Refik Spahiu, aktualisht i punësuar në pozicionin “drejtues teknik” në

shoqërinë tregtare “NEKU” sh.p.k. Në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 110/2016, pas caktimit të komitetit të përkohshëm të kreditorëve, mbledhja e kreditorëve në çdo moment, mund të zëvendësojë ose të caktojë një komitet të ri kreditorësh. Lidhur me kërkesën për korrigjimin e vendimit datë 16.6.2021 në pjesën hyrëse të tij, respektivisht në citimin si kreditorë të shoqërive tregtare “KEVGER” sh.p.k. dhe “ISAKU” sh.p.k., të cilët nuk rezultojnë kreditorë, por debitorë të shoqërisë, kërkesa është e drejtë dhe duhet pranuar. Përmendja në pjesën hyrëse të këtyre dy subjekteve në cilësinë e kreditorëve, ka mbetur për efekt njoftimi, pasi të tillë janë raportuar nga debitori në kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit. Vetëm me raportin paraprak të administratorit të përkohshëm u sqarua se në fakt këto dy shoqëri tregtare kanë qenë debitorë të kërkuesit “NEKU” sh.p.k. Gjatë kësaj seance u raportua se detyrimet ndaj tyre janë shlyer, por gjithsesi kjo i përket hetimit më të thelluar në raportin, që do të paraqitet për miratim nga administratori i falimentimit. Si përfundim, kërkesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, bazuar në nenin 126, 312 dhe 313, të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Ndreqjen e gabimit material në dispozitivin e vendimit të datës 16.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, pika 4, nga “Pezullimin e aktivitetit të shoqërisë tregtare ‘NEKU’ sh.p.k.”, që është i pasaktë në “Vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë tregtare ‘NEKU’ sh.p.k., nën administrimin e administres së falimentimit znj. Shpresa Breçani” deri në likuidimit të shoqërisë.

2. Plotësimin e vendimit dhe shtimin pas pikës 4 të dispozitivit, të pikës 4/1, si në vijim: “Të gjitha lejet dhe licencat, që ka përfituar shoqëria tregtare ‘NEKU’ sh.p.k., qëndrojnë në fuqi dhe ruajnë vlefshmërinë ligjore. Ato nuk mund të revokohen, ndryshohen apo hiqen pa miratimin e gjykatës së falimentimit.

3. Ndreqjen e gabimit material në pikën 10, të këtij vendimi, nga “sh.a.” në “sh.p.k.”.



4. Plotësimin e vendimit dhe shtimin pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje: “Caktimin e komitetit të përkohshëm të kreditorëve të përbërë nga 5 anëtarë dhe konkretisht: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, “Reden” sh.p.k., “Raiffeisen Leasig”, “Kurti Trans” dhe nga lista e punëmarrësve z. Refik Spahiu për organizimin e takimit me të cilët ngarkohet administratorja e falimentimit Shpresa Breçani.

5. Ndreqjen e gabimit material në pikën 14 të dispozitivit si në vijim: një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “NEKU” sh.p.k., t’i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme, me qëllim njoftimin e të gjitha drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe kryerjen e veprimeve konform ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

6. Një kopje e këtij vendimi t’i bashkohet vendimit të datës 16.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër me objekt “Hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “NEKU” sh.p.k.”.

7. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga e nesërmyja e njoftimit të arsyetuar.

8. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet administratorës së falimentimit znj. Shpresa Breçani dhe debitorit “NEKU” sh.p.k.

9. Një kopje e shkurtimit të këtij vendimi të dërgohet për publikim Qendrës Kombëtare të Biznesit, Qendrës së Botimeve Zyrtare, si dhe të afishohet publikisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, si dhe në faqen e internetit të kësaj gjykate.

10. Në zbatim të nenit 29, parag. 4 administratori ngarkohet me dërgimin e një kopje të përmbledhur të vendimit secilit prej kreditorëve

të njohur të debitorit, pavarësisht nga fakti që kreditorët dhe çdo palë tjetër e interesuar konsiderohen të njoftuar si pasojë e shpalljes publike.

Palët prezente morën dijeni.

U shpall në Peshkopi, më 21.7.2021.

SEKRETARE
Teuta Iskurti

GJYQTAR
Ardit Kuka

KËRKESË

Shtetasi Isuf Kuca, përfaqësuar me prokurë nga avokati Shkëlqim Margjeka, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë shpalljen të vdekur, më datë 3.1.1979, të shtetasit Skender Kuca, i biri i Halilit dhe i Berdies, lindur më datë 2.2.1959.

KËRKUES
Isuf Kuca

NDREQJE GABIMI MATERIAL

Në fjalinë e fundit të pikës 5, të nenit 49, të ligjit nr. 80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, botuar në Fletoren Zyrtare 121/2021, datë 2.8.2021, bëhet ndreqja e gabimit material si më poshtë:

Pas togfjalëshit “sipas përcaktimeve”, fjala “**të neneve**” të zëvendësohet me fjalën “**të pikave**”.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 736 lekë